

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

HYRJE

Projektbuxheti 2020 vijon të mbështesë reformat e ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritit në Bashkimin Europian.

Projektbuxheti 2020 dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal për të vijuar **trajektoren rënëse të raportit të borxhit publik ndaj PBB**. Rritja ekonomike parashikohet të jetë mbi nivelin prej **4%** përgjatë viteve 2020-2022. Më konkretisht, rritja ekonomike parashikohet të jetë në nivelin prej 4.1% në vitin 2020 dhe 4.5% për dy vitet e tjera. Rritja ekonomike dhe punësimi, do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të **investimeve publike prej 4.7% e PBB**.

Deficiti buxhetor për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1.6% të PBB. Ky përbën nivelin më të ulët të targetuar në dy dekadat e fundit. Për të pestin vit rradhazi balanca primare parashikohet të jetë pozitive në nivelin 0.7% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse për të pestin vit rradhazi. Në fund të vitit 2020 borxhi publik pritet të ulet në nivelin e 62.2% të PBB.

Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të forcohet dhe të arrijë nivelin 4.1% në vitin 2020 ndërkohë që norma mesatare e papunësisë parashikohet të bjerë në 10.6% në 2020.

Projektbuxheti 2020, planifikon më shumë burime si rezultat i politikave fiskale të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi. Në tre vitet e fundit, buxhetet e miratuara kanë synuar reduktimin gradual dhe të targetuar të barrës tatimorë nëpërmjet uljes së tarifave të tatimit dhe përjashtimeve të studiuara. Rritja e të ardhurave është synuar kryesisht nga zgjerimi i bazës së tatueshme, lufta ndaj informalitetit dhe përmirësimi i administrimit tatimor. Edhe Projektbuxheti i vitit 2020 synon të shpërndajë në mënyrë më të drejtë barrën fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën 2020-2022 do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike duke u përqendruar në financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë. Rijetëzimi rural do të vazhdojë të jetë fokusi kryesor i mbështetjes së qeverisë për këtë mandat, ku programi *100 Fshatrat* do të ketë rolin kryesor.

Projektbuxheti 2020 garanton vazhdimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të nisura në sektorë kyç të ekonomisë. Reforma në drejtësi, e cila do të marrë një mbështetje të konsiderueshme buxhetore, së bashku me reformën në administratën publike dhe reformën e menaxhimit të financave publike do të jenë instrumente të rëndësishëm të realizimit të prioriteve të programit të Qeverisë në përputhje me interesat e qytetarëve për përmirësimin e nivelit të jetesës së tyre.

Projektbuxheti vendor i vitit 2020 konfirmon vazhdimin e mbështetjes së Reformës Administrativo-Territoriale dhe reformave të tjera të decentralizimit. Në projektbuxhetin e 2020, burimet e financimit të vetëqeverisjes vendore do të **rriten me rreth 5.7 miliard lekë ose 11.2% më shumë** se sa ato të vitit 2019, të cilat do shkojnë për më shumë investime dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Ndër masat e rëndësishme për vitin buxhetor 2020, përmendim zbatimin e ligjit për financat e

vetëqeverisjes vendore; zbatimin e akteve nënligjore për menaxhimin e rasteve të vështirësive financiare të njësisë të vetëqeverisjes vendore, si dhe reformën për taksën e ndërtesave dhe krijimin e kadastrës fiskale. Të gjitha këto dëshmojnë vullnetin dhe seriozitetin e Qeverisë për zbatimin e reformës administrative-territoriale.

Në vijim të reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit, vend të rëndësishëm zë vazhdimi dhe konsolidimi i **reformës së financimit të arsimit parashkollor**. Edhe për vitin 2020, **fondet për pagat e edukatorëve do të rriten me 10%** në krahasim me vitin 2018, si viti para fillimit të kësaj reforme. Në të njëjtën kohë do të **përmirësohet sistemi i ndarjes së fondeve ndërmjet bashkive**. Në ndryshim nga sistemi i mëparshëm, ku fondet ndaheshin sipas numrit të edukatorëve, konform praktikave të mira ndërkombëtare, financimi i këtij funksioni për vitin 2020, do të bazohet kryesisht në numrin e fëmijëve (fëmijë 3-6 vjeç), si një kriter më objektiv për përcaktimin e nevojave për shpenzime. Si rrjedhojë e kësaj reforme, në këtë sistem do të jenë 440 edukatore më shumë se sa në vitin 2018, që janë shpërndarë në 32 bashki të cilat kanë një nevojë më të madhe për shtimin e edukatorëve, e matur nga raporti “fëmijë për edukatore”. Kjo reformë do ketë ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e madhësisë mesatare maksimale të grupeve në kopshte nga **26 në 18 fëmijë për edukatore**, dhe madhësisë mesatare kombëtare nga **18 në 15 fëmijë** për një edukatore, duke krijuar kështu parakushtet për një sistem më efikas. Gjithashtu, në buxhetin e vitit 2020, do të shtohen edhe 32 punonjës ndihmës të arsimit parashkollor. Të gjitha këto masa së bashku do të ndikojnë dukshëm në rritjen e cilësisë së arsimit parashkollor.

1. SITUATA EKONOMIKE

1.1 ZHVILLIMET E FUNDIT DHE PERSPEKTIVA MAKROEKONOMIKE

Pavarësisht një ngadalësimi të rritjes ekonomike në gjysmën e parë të vitit për shkak të disa faktorëve të luhatshëm dhe të përkohshëm, sektorët kryesorë të ekonomisë, si dhe fundamentat makroekonomike, deri më tani, vazhdojnë të jenë mjaft të fortë dhe madje disa prej tyre kanë vijuar të përmirësohen. Rrjedhimisht, edhe perspektiva e ekonomisë për vitin e ardhshëm dhe afatin e mesëm mbeten pozitive, ku parashikohet një rritje mbi nivelin prej 4%.

Ekonomia ka vijuar të regjistrojë rritje pozitive përgjatë gjysmës së parë të vitit 2019, megjithëse ka pësuar një ngadalësim të ritmit të rritjes krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke u rritur me 2.36%. Secili prej tremujorëve, i parë dhe i dytë të vitit 2019, kanë shënuar përkatësisht norma rritjeje prej 2.43% dhe 2.31%. Ky ngadalësim ishte krejtësisht rrjedhojë e disa faktorëve specifik, që karakterizohen nga një luhatshmëri e lartë, siç është prodhimi i energjisë elektrike me një kontribut negativ prej -1.2 pikë përqindje në gjysmën e parë, apo faktorë të përkohshëm, siç ishte mbyllja e aktiviteve të “lojrave të fatit” me një kontribut negativ prej -0.6 pikë përqindje. Gjithashtu, përgjatë tremujorit të dytë të së njëjtës periudhë të këtij viti, projekti TAP, i cili ka qenë në fazën pothuajse përfundimtare të tij, ka dhënë gjithashtu një kontribut negativ në sektorin e ndërtimit.

Pavarësisht ngadalësimit në gjysmën e parë të vitit, të dhënat e derimëtanishme dëshmojnë se sektorët fundamental, struktural, të ekonomisë kanë pasur një performancë të mirë dhe në linjë me pritshmëritë për të mundur një rritje në intervalin 3% – 3.5% për të gjithë vitin 2019, si dhe rikthim mbi nivelin prej 4% në vitin e ardhshëm e në periudhën afat-mesme në vijim.

Në anën e kërkesës agregate, rritja në gjysmën e parë të vitit 2019 është gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme, specifikisht nga konsumi, si dhe gjithashtu në një farë mase edhe nga eksportet neto të

shërbimeve, të cilat reflektojnë një performance mjaft të mirë të turizmit edhe gjatë këtij viti. Në gjysmën e parë të vitit 2019 konsumi final regjistroi një rritje reale prej 2.66% duke vijuar të njëjtin trend të periudhave të mëparshme. Pavarësisht rritjes së lartë prej më shumë se 10% të Investimeve të Huaja Direkte në gjysmën e parë të vitit krahasuar me vitin parardhës, formimi i kapitalit fiks bruto (investimet totale) regjistroi vetëm një rritje të lehtë për gjysmën e parë, duke reflektuar kryesisht zhvillimet me projektin TAP. Eksportet neto të mallrave patën një tkurrje gjatë pjesës së parë të vitit kundrejt një viti më parë, e rrjedhimisht një kontribut negativ në rritjen ekonomike gjatë kësaj pjese të vitit, duke reflektuar sërish në masën më të madhe efektin e energjisë elektrike, si në tkurrjen e eksporteve të mallrave krahasuar me një vit më parë, ashtu edhe në zgjerimin e importeve të tyre.

Në anën e ofertës agregate, kontributin kryesor pozitiv në rritjen e gjysmës së parë të vitit 2019 e dhanë: Tregtia, Transporti, Hotele, etj. me rritje reale 4.86% dhe kontribut 0.7 pikë përqindje; Aktivitete të pasurive të paluajtshme me rritje 8.85% dhe kontribut 0.52 pikë përqindje; Administrata publike dhe mbrojtja, arsimi dhe shëndetësia me rritje 3.51% dhe kontribut 0.39 pikë përqindje; Bujqësia, pyjet dhe peshkimi u rritën me 1.75% dhe kontribut 0.36 pikë përqindje; Aktivitetet financiare dhe të sigurimit me rritje reale prej 11.43% dhe kontribut 0.32 pikë përqindje; Informacioni dhe komunikimi me rritje 10.19% në terma real dhe kontribut prej 0.27 pikë përqindje; Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike me rritje reale 4.07% dhe kontribut 0.23 pikë përqindje dhe Ndërtimi me rritje 1.61% dhe kontribut 0.13 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sektorët që rezultuan me një rritje reale negative gjatë gjysmës së parë të 2019 ishin: Industria me -4.03% e cila reflekton rënien e fortë të vlerës së shtuar të energjisë elektrike dhe Arte, argëtim dhe çlodhje me rënie -19.32% e cila reflekton mbylljen e “lojrave të fatit”, respektivisht më kontribut negativ prej -0.56 dhe -0.47 pikë përqindje në rritjen totale.

Duke konsideruar këta faktorë të përkohshëm dhe të luhatshëm të sipërpërmendur, të cilët janë prezent gjatë këtij viti veçanërisht në kontrast të thellë nga një vit më parë, ky ritëm më i ngadalësuar i rritjes ka gjasa të vijojë edhe në gjysmën e dytë të vitit, megjithëse do të jetë më i zbutur. Duke faktorizuar sa më sipër, për këtë vit parashikohet një rritje reale nga 3% deri në 3.5%.

Nga ana tjetër, duke konsideruar se:

- fondamentet kyç të ekonomisë mbeten mjaft të forta dhe madje me përmirësim të konsiderueshëm në disa prej tyre,
- efekti i këtyre faktorëve të përkohshëm pritet të shuhet pothuajse plotësisht në vitin e ardhshëm,
- si dhe në të njëjtën kohë, duke supozuar se nuk do të ketë ndonjë goditje ekstremisht të fortë nga mjedisi i jashtëm (ndonjë recension të ekonomisë globale apo evropiane),

parashikojmë që rritja ekonomike të rikthehet përsëri në fashën e 4 përqindëshit në vitin e ardhshëm, si dhe të vijojë e tillë në periudhën afatmesme.

Disa nga treguesit kryesorë të cilët dëshmojnë se fondamentet e ekonomisë mbeten mjaft të qëndrueshëm dhe kanë vijuar përmirësim të konsiderueshëm në një pjesë të tyre, janë:

- *Vijueshmëria e performancës pozitive të tregut të punës.* Rritja e qenësishme në sektorët struktural të ekonomisë, pavarësisht zhvillimeve jo të favorshme lidhur me faktorët e përkohshëm të sipërpërmendur, ka vijuar të pasqyrohet qartësisht në dinamikat e tregut të punës. Tregu i punës regjistroi ulje të mëtejshme të shkallës së papunësisë nën nivelin prej 12% në tremujorin e dytë, niveli më i ulët i regjistruar gjatë dy dekadave e fundit, ndërsa punësimi u rrit me 3.3% krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të kaluar, e ushqyer kjo kryesisht nga rritja e shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës. Këto zhvillime në tregun e punës janë jo vetëm tejet esenciale në vetvete përse i takon impaktit të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve, po përbëjnë gjithashtu

një element mjaft të rëndësishëm sa i takon perspektivës, si afatshkurtër ashtu edhe afatmesme të ekonomisë. Rritja e punësimit është kyçe për gjenerimin e të ardhurave të disponueshme të familjeve, e për rrjedhojë për të ushqyer konsumin, kursimet e investimet, dhe rritjen e mëtejshme të ekonomisë.

- *Sentimenti pozitiv mbi perspektivën e ekonomisë të aktorëve ekonomikë.* Indikator i rëndësishëm është perceptimi i përgjithshëm i agjentëve ekonomikë, biznese dhe konsumatorë, sa i takon perspektivës ekonomike. Indeksi tremujor i ndjeshmërisë ekonomike, ka ndjekur përgjithësisht një trend pozitiv gjatë tre tremujorëve të këtij viti kundrejt fund-vitit të kaluar dhe qëndron konsiderueshëm mbi mesataren afatgjatë të tij. Kjo indikon se aktorët ekonomik mbeten në tërësi optimist për të ardhmen, premisë mjaft e rëndësishme kjo për një sjellje dhe vendimarrje aktive për të investuar dhe konsumuar.
- *Stabiliteti financiar dhe përshejtimi i kreditimit të ekonomisë.* Qëndrueshmëria e sektorit financiar, në terma të kapitalizimit, likuiditetit dhe përfitueshmërisë, vazhdon të mbetet një fundament tjetër i fortë dhe vijueshmërisht i përmirësuar i ekonomisë. Kreditë me probleme (NPL) kanë vijuar të ulen, tashmë deri në nivelin rreth 11%, nga 24% që kulmuan rreth dy vite më parë. Gjithashtu, kreditimi i sektorit privat të ekonomisë, ka njohur tashmë për tre tremujorë rresht të këtij viti një zgjerim të qenësishëm, duke regjistruar një rritje prej mbi 7% kundrejt një viti më parë, e cila i atribuohet si kredisë drjet bizneseve ashtu edhe asaj drejt konsumatorëve.
- *Pozicioni i jashtëm i ekonomisë dhe bilanci i pagesave mbetet mjaft i qëndrueshëm.* Ka pasur një zgjerim të defiçitit të llogarisë korente për gjysmën e parë të këtij viti, duke reflektuar kryesisht importe më të larta të mallrave dhe një tkurrje të eksporteve, ku sërish energjia elektrike ka patur impaktin më të madh si tek importet ashtu edhe eksportet krahasuar me një vit më parë. Megjithatë, nga ana tjetër thellimi i defiçitit tregtar gjatë gjysmës së parë të vitit është kompensuar në një masë të konsiderueshme nga rritja e sufiçitit të balancës së shërbimeve, ku reflektohet kryesisht performance e mirë e shërbimeve të turizmit edhe gjatë këtij viti. Në të njëjtën kohë, sufiçiti i llogarisë financiare dhe kapitale u zgjerua me më shumë se dyfishin e zgjerimit të defiçitit të llogarisë korente, kryesisht si pasojë e flukseve të larta të IHD-ve, të cilat gjatë gjysmës së parë shënuan një rritje prej mbi 10% kundrejt një viti më parë. Për rrjedhojë, bilanci i përgjithshëm i pagesave dhe pozicioni i jashtëm i ekonomisë mbetet mjaft i qëndrueshëm, ku stoku i akumuluar i revezervave valutore qëndron në nivel mjaftueshmërisht të lartë, ekuivalent me mbi 6 muaj import mallrash e shërbimesh. Ky pozicion i jashtëm i përmirësuar ka vijuar të reflektohet edhe në një vlerësim të metejshëm që monedha vendase Lek ka patur edhe gjatë këtij viti, veçanërisht kundrejt monedhës Euro.
- *Qëndrueshmëria e financave publike dhe vijimi i konsolidimit fiskal.* Qëndrueshmëria e financave publike përbën një tjetër fundament tejet të rëndësishëm për perspektivën e ekonomisë, ndoshta më të rëndësishmin për tipologjinë e ekonomisë shqiptare, si dhe në kontekstin e një sensitiviteti të lartë lidhur me këtë fundament, sidomos që prej krizës së fundit financiare globale.

Në vitet e fundit financat publike kanë hyrë në një trajektore të sigurtë dhe optimale të konsolidimit fiskal, e materializuar në parametrat më kyç të qëndrueshmërisë. Së pari, kjo është materializuar në uljen e defiçitit të përgjithshëm buxhetor nga 5% të PBB në 2013 në poshtë 2% në vitin e shkuar (2018), dhe po ashtu poshtë 2% e targetuar dhe e pritshme për këtë vit (2019). Viti fiskal 2020 është viti i gjashtë radhazi ku targetohet një defiçit i përgjithshëm buxhetor në raport me PBB në ulje kundrejt vitit pararendës. Niveli i defiçitit buxhetor prej 1.6% e PBB i targetuar për vitin 2020, ekzaktësisht sa targeti i shpallur në Planin e Buxhetit Afatmesëm (PBA)

rreth një viti më parë, është niveli më i ulët i targetuar historikisht. Së dyti, që prej vitit 2016 financat publike kanë targetuar dhe kanë regjistruar balancë primare pozitive (sufiçit primar), i cili është kthyer tashmë në një parametër operacional shumë të rëndësishëm të qëndrueshmërisë së financave publike dhe perceptimit të aktorëve ekonomikë dhe tregut lidhur me shëndetshmërinë e financave publike. Së treti, dhe mbi të gjitha, ky konsolidim fiskal është materializuar në një trajektore qartësisht rënëse të borxhit publik ndaj PBB. Në vitet e fundit borxhi publik neto¹ është reduktuar nga niveli më i lartë prej 71.9% të PBB i regjistruar në vitin 2015 në rreth 64% i pritshëm për vitin 2019.

Një të njëjtën kohë, një parametër tjetër i rëndësishëm i financave publike është dhe balanca korente fiskale, e cila është diferenca midis investimeve publike dhe defiçitit buxhetor. Që prej vitit 2005 kjo balancë ka qenë positive pothuajse çdo vit, veçanërisht e theksuar kjo gjatë katër viteve të fundit, ku niveli i investimeve publike ka qenë mesatarit 3 pikë përqind të PBB më tepër se sa niveli i defiçitit.

Rezultatet paraprake fiskale deri në Shtator-2019 tregojnë se realizimi i përgjithshëm i buxhetit mbetet plotësisht në përputhje me objektivat dhe parametrat kryesorë fiskalë. Ka pasur një mungesë të të ardhurave prej rreth 2.2% në krahasim me planin e periudhës, sidoqoftë, një mungesë e tillë e të ardhurave është absorbuar plotësisht brenda hapësirave “amortizuese” të krijuara që në buxhetin fillestar. Pra, arritja e plotë e objektivave kryesore fiskalë (objektivi fillestar i defiçitit të përgjithshëm prej 1.9% e PBB, një bilancë primare pozitive dhe një ulje të borxhit prej rreth 2 pikë përqindje), deri më tani mbetet mjaft e sigurtë.

Në përputhje të plotë edhe me rregullat fiskalë në ligjin organik të buxhetit, politika fiskale do të vijojë të orientohet qartësisht drejt konsolidimit fiskal. Kjo në mënyrë të qenësishme në terma të reduktimit të borxhit publik, dhe në mënyrë më graduale në terma të reduktimit të defiçitit fiskal. Ky orientim qartësisht konsolidues i politikës fiskale është premisë tejet thelbësore për të siguruar një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme, e konvergim drejt standarteve të mirëqenies të Bashkimit Evropian.

Deri më tani, trajektorja rënëse e borxhit publik qëndron në linjë të plotë me objektivat afatmesëm të politikës fiskale të shpallura që në vitin 2017 për reduktimin e borxhit rreth nivelit prej 60% në fund të vitit 2021. Gjatë vitit 2020 targetohet dhe pritet që borxhi publik neto të reduktohet rreth nivelit prej 62% e PBB nga rreth 64% i pritshëm për vitin 2019. Konsolidimi fiskal do të vijojë i tillë edhe në periudhën afatgjatë, në përputhje me objektivin afatgjatë të stipuluar në ligjin organik të buxhetit për reduktim e borxhit publik poshtë nivelit prej 45% të PBB-së dhe mbajtjen e tij poshtë këtij niveli.

Në të njëjtën kohë, ky konsolidim fiskal në terma të borxhit publik dhe defiçitit do të vijojë të shoqërohet me një kompozim të shëndetshëm midis shpenzimeve korente dhe atyre kapitale (investimve publike). Shpenzimet kapitale të programuara në buxhetin e vitit 2020, si dhe në periudhën afatmesme vijojnë të jenë mbi 4.5% e PBB-së, nivel i cili është mesatarisht rreth 3 pikë përqindje të PBB më tepër se sa defiçiti buxhetor i targetuar. Pra, balanca korente fiskale do të vijojë të mbetet në mënyrë të qartë positive, në përputhje të plotë edhe me rregullin fiskal të posaçëm apo “rregullin e artë” të stipuluar në ligjin organik të buxhetit.

¹ Borxhi publik “neto” në këtë rast përkufizohet si borxhi publik “bruto” minus gjendjen e asetëve likuide të qeverisë në llogarinë unike të thesarit pranë Bankës së Shqipërisë.

Matësi më direkt i këtij fondamenti, pra pozicionit të financave publike, por edhe stabilitetit makroekonomik dhe perspektivës ekonomike në tërësi, është tregtimi i Eurobondit të shtetit shqiptar në bursat (tregjet financiare) ndërkombëtare, po gjithashtu edhe tregtimi (ankandet) i instrumentave të borxhit të brendshëm të emetuara në tregun e brendshëm financiar. Eurobondi i shtetit shqiptar i emtuar në Tetor 2018 (me maturim në 2025), i cili u emetua me një “yield” prej 3.5%, qenësisht më të ulët se sa të dy eurobondet e mëparshme (Eurobondi 2010 dhe 2015), që prej emetimit të tij e deri më tani është tregtuar në bursat e huaja me një “spread”² që ka njohur një trend përgjithësisht rënës. Pas një luhate të lehtë në rritje gjatë muajve Maj-Gusht 2019, gjatë dy-tre muajve të fundit ai është rikthyer sërish në një tred qartësisht rënës. Aktualisht tregtohet me një “spread” rreth 70 pikë bazë ose rreth 23% më pak se sa “spread” që kishte në momentin e emetimit të tij. Gjithashtu edhe instrumentat e borxhit publik të brendshëm të emetuara në tregun e brendshëm financiar kanë vijuar të shiten me “yield-e” në nivelet më të ulëta historike. Edhe në këtë treg, pas një luhate të lehtë në rritje të “yield-eve” gjatë muajve Maj-Gusht, muajtë e fundit kanë regjistruar sërish rënie të tyre. Këto tregues janë indikacione direkte, në këtë rast dukshëm pozitive, sa i takon perceptimit të aktorëve ekonomikë mbi financat publike shqiptare dhe perspektivës makroekonomike afatmesme e afatgjatë të vendit në tërësi.

Rrjedhimisht, bazuar në gjithë sa më sipër, vlerësojmë se ekzistojnë të gjitha premiset për një rritje ekonomike në fashën e 4 përqindëshit, si në vitin 2020, ashtu edhe për periudhën afatmesme në vijim. Më specifikisht, parashikojmë një rritje reale ekonomike prej 4.1% në vitin 2020 dhe një rritje prej 4.5% gjatë dy viteve të tjera në vijim (2021 – 2022).

1.2 KRAHASIMI ME VENDET E RAJONIT

Bazuar në raportet dhe analizat e institucioneve ndërkombëtare, perspektiva afatmesme për vendet e Europës Juglindore dhe Ballkanit, parashikohet të jetë pozitive. Rritja ekonomike në Ballkanin Perëndimor është përshpejtuar në 3.8% në vitin 2018 dhe parashikohet të jetë mesatarisht 3.7% gjatë periudhës 2019-2020. Norma e papunësisë ka qenë në rënie në të gjithë vendet, por nivelet e papunësisë mbeten ende të larta. Inflacioni ka ndjekur një trajektore rënëse në të gjitha vendet e rajonit.

Rritja ekonomike kombinuar me disiplinën fiskale dhe mirë-menaxhimit të borxhit publik gjatë vitit 2018, uli nivelet e borxhit publik përkatësisht në Serbi, Shqipëri dhe Bosnjë Hercegovinë. Megjithatë, nivelet e larta të borxhit publik mbeten burim risku në pjesën më të madhe të vendeve të rajonit.

Rritja ekonomike e Shqipërisë ka ndjekur një trajektore rritëse të qëndrueshme që prej vitit 2013, duke e tejkaluar mesataren e rajonit në tre vitet e fundit.

Tabela 1. Rritja e Produktit të Brendshëm Bruto (në %)

	2014	2015	2016	2017	2018
Shqipëria	1.8	2.2	3.4	3.8	4.1
Bosnia dhe Hercegovina	1.1	3.1	3.1	3.2	3.0
Kosovo	1.2	4.1	4.1	4.2	4.2

² “Spread” është diferenca midis “yield” (normës së interesit) të eurobondit të shtetit shqiptar me një normë referencë (mid-swap) që kalkulohet në bazë të një metodologjie standarte.

Maqedonia	3.6	3.9	2.8	0.2	2.7
Mal i Zi	1.8	3.4	2.9	4.7	4.4
Serbia	-1.6	1.8	3.3	2.0	4.2
Mesatarja e rajonit	0.4	2.6	3.3	2.6	3.8

Burimi: Raporti RER i Bankës Botërore, Pranverë 2019

Rritja ekonomike ka sjellë rritje të mëtjeshme në nivelin e normave të punësimit në vendet e rajonit. Në tremujorin e parë të vitit 2019, rritja vjetore e punësimit u përshpejtua krahasuar me tremujorin e mëparshëm në Shqipëri, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi (ku shkalla e rritjes u dyfishua). Nga ana tjetër, ritmi i rritjes së punësimit u ngadalësua në Mal të Zi, gjithashtu Kosova shënoi rënie në nivelin e punësimit. Në përgjithësi, norma mesatare e rritjes së punësimit në rajon arriti në 3.7% në terma vjetorë nga 2.0% që ishte në tremujorin e mëparshëm. Rritja e punësimit kontribuoi në uljen e normave të papunësisë në të gjitha vendet e rajonit.

Në Shqipëri norma e papunësisë që prej vitit 2013 ka qënë poshtë nivelit të mesatares së rajonit dhe pritet që dhe në periudhën afatmesëm ky trend të vazhdojë të jetë i tillë.

Tabela 2. Norma e papunësisë (në %)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Shqipëria	16.4	17.9	17.5	15.6	14.1	12.3
Bosnia dhe Herzegovina	27.5	27.5	27.7	25.4	20.5	18.4
Kosovo	30.0	35.3	32.9	27.5	30.5	29.6
Maqedonia	29.0	28.0	26.1	23.8	22.4	20.7
Mal i Zi	19.5	18.2	17.8	18.0	16.4	15.5
Serbia	22.1	19.2	17.7	15.3	13.5	12.7
Mesatarja e rajonit	24.1	24.4	23.3	20.9	19.6	18.3

Burimi: ECFIN, Pranverë 2019, MFE

Bazat e ngushta të prodhimit dhe sfidat e konkurrencës kanë sjellë nivele shumë të larta të deficitit të tregtisë së mallrave, në Ballkanin Perëndimor, duke filluar nga rreth 14% të PBB-së në Serbi, në 16% ose më shumë në Maqedoninë e Veriut, Shqipëri dhe Bosnjë e Hercegovinë, dhe deri në 44% ose më shumë për Malin e Zi dhe Kosovën. Deficitet tregtare të mallrave janë kompensuar pjesërisht nga tepricat e llogarisë së shërbimeve dhe transfertat korrente, duke rezultuar në një nevojë të madhe financiare të huaj. Në tremujorin e parë të 2019, deficiti vjetor i llogarisë korrente u zgjerua në të gjitha vendet e rajonit. Në total, në të katërt tremujorët pararendës deri në mars 2019, deficiti i llogarisë korrente në rajon arriti në rreth 6% të PBB-së (një nga nivelet më të ulta gjatë viteve). Deficitet në Ballkanin Perëndimor vazhdojnë të financohen kryesisht nga hyrjet neto të IHD-ve. Një analizë mbi qëndrueshmërinë e llogarisë korrente sugjeron që vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të reduktojnë deficitet e jashtme në periudhën afatmesme.

Tabela 3. Bilanci Tregtar i mallrave (% të PBB)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Shqipëria	-20.4	-22.2	-22.4	-24.2	-24.4	-22.3
Bosnia dhe Herzegovina	-25.0	-27.8	-24.2	-22.7	-22.7	-22.2
Kosovo	-40.5	-39.8	-39.8	-40.9	-42.5	-45.6
Maqedoni	-22.9	-21.7	-20.1	-19.2	-18.0	-16.2
Mal i Zi	-39.5	-39.8	-40.1	-41.9	-43.3	-44.4
Serbia	-13.0	-11.4	-11.3	-9.9	-11.1	-13.2

Mesatarja e rajonit	-26.9	-27.1	-26.3	-26.5	-27.0	-27.3
---------------------	-------	-------	-------	-------	-------	-------

Burimi: ECFIN, Pranverë 2019, MFE

Tabela 4. Balanca Korrente (% të PBB)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Shqipëria	-9.3	-10.8	-8.6	-7.6	-6.5	-6.7
Bosnia dhe Herzegovina	-5.0	-7.1	-5.1	-4.5	-4.5	-4
Kosovo	-3.4	-6.9	-8.6	-7.9	-6.1	-8.3
Maqedoni	-1.6	-0.5	-2	-3.1	-1.3	-0.3
Mal i Zi	-11.4	-12.4	-11	-16.2	-16.1	-17.2
Serbia	-6.1	-5.6	-4.4	-2.9	-5.2	-5.2
Mesatarja e rajonit	-6.1	-7.2	-6.6	-7.0	-6.8	-6.9

Burimi: ECFIN, Pranverë 2019, MFE

Dinamika e rritjes ekonomike mbështeti reduktimin e defiçiteve fiskale në shumicën e vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, me përjashtim të Serbisë, kjo situatë ishte pjesërisht për shkak se vendet e rajonit vazhduan të kishin shpenzime kapitale me performancë të ulët, duke nxjerrë në pah dobësitë e vazhdueshme në planifikimin, përzgjedhjen dhe menaxhimin e investimeve publike.

Tabela 5. Bilanci Fiskal (Deficiti i përgjithshëm në % të PBB)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Shqipëria	-5.0	-5.2	-4.1	-1.8	-2.0	-1.6
Bosnia dhe Herzegovina	-1.8	-2.0	0.6	1.2	2.5	n.a
Kosovo	-3.1	-2.2	-2.0	-1.2	-1.3	-2.8
Maqedoni	-4.0	-4.2	-3.5	-2.7	-2.7	-1.8
Mal i Zi	-4.6	-2.9	-8.3	-3.6	-5.3	-3.8
Serbia	-5.6	-6.2	-3.5	-1.2	1.1	0.6
Mesatarja e rajonit	-4.0	-3.8	-3.5	-1.6	-1.3	n.a

Burimi: ECFIN, Pranverë 2019, MFE

Rritja ekonomike kombinuar me disiplinën fiskale dhe mirë-menaxhimin të borxhit publik gjatë vitit 2018, uli nivelet e borxhit publik përkatësisht në Serbi, Shqipëri dhe Bosnjë Hercegovinë.

Tabela 6. Borxhi publik (% të PBB)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Shqipëria	70.4	72.0	72.7	72.3	70.1	67.2
Bosnia dhe Herzegovina	35.5	40.2	40.3	39.0	34.8	33.6
Kosova	8.9	10.7	13.1	14.6	15.5	16.2
Maqedoni	34.0	38.1	38.1	39.6	39.3	41.9
Mal i Zi	56.9	58.7	65.2	63.4	63.3	70.8
Serbia	59.6	70.4	70.0	67.8	57.9	54.6
Mesatarja e rajonit	44.2	48.0	49.9	49.5	46.8	47.4

Burimi: ECFIN, Pranverë 2019, MFE

1.3 PARASHIKIMET AFATMESME 2020-2022

Perspektiva ekonomike mbetet e favorshme në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet të jetë mbi nivelin prej 4% përgjatë viteve 2020-2022. Më konkretisht, rritja ekonomike parashikohet të jetë në nivelin prej 4.1% në vitin 2020 dhe 4.5% për dy vitet e tjera.

Rritja pritet të mbështetet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi privat ashtu edhe investimet. Ndërkohë kërkesa e huaj neto (eksport – import) pritet të sjellë gjithashtu një efekt pozitiv, megjithëse marxhinal. Konsumi privat pritet të nxitet kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimet në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave të cilat më tej priten të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, duke krijuar efektin e raundit të dytë në nxitjen e konsumit, si dhe duke intensifikuar prirjen e konsumatorëve për financimin e mëtejshëm të konsumit nëpërmjet një kredimarrje më të lartë. Ndërkohë, kredimarrja nga konsumatorët, e cila ka njohur një rritje më të qenësishme gjatë vitit 2019, parashikohet të vijojë e tillë, e nxitur si nga përmirësimi i kushteve financiare të individëve, ashtu edhe nga lehtësimi i pritshëm i standardeve të huadhënies nga sistemi bankar, si dhe nga vijimësia e politikës monetare akomoduese.

Rritja e investimeve pritet të nxitet nga shfrytëzimi më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përshpejtimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi përgjithësisht në trend pozitiv i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht edhe vijimësia e një politike monetare akomoduese, përmirësimi i kushteve financiare dhe lehtësimi i standardeve të huadhënies pritet të ushqejë kreditimin e bizneseve e të jetë një faktor i rëndësishëm i incentivues i investimeve private në afatin e mesëm.

Konsumi final total për periudhën afatmesme (2020 – 2022) parashikohet të rritet në terma real mesatarisht rreth 2.9% në vit, duke kontribuar mesatarisht rreth 2.6 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real mesatarisht rreth 5% në vit, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.2 pikë përqindje në vit.

Kërkesa e jashtme neto pritet të japë një kontribut lehtësisht pozitiv në rritjen ekonomike për periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2020-2022 parashikohen të rriten mesatarisht rreth 8.3% në vit në terma real, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 2.7 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 4.7% në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB me rreth -2.2 pikë përqindje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut lehtësisht pozitiv në rritjen totale të PBB, me mesatarisht rreth 0.5 pikë përqindje në vit.

Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
						Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9
Inflacioni (mesatar)	%	1.9	1.3	2.0	2.0	1.5	2.1	2.4	2.8
Deflatori i PBB	%	0.6	-0.6	1.5	0.9	1.1	1.1	1.7	2.5
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	126.0	124.1	119.1	108.0	109.5	109.5	109.5	109.5
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	139.7	137.4	134.2	127.6	123.1	123.1	123.1	123.1
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	43.9	44.4	45.0	45.0	45.0	45.0	45.0	45.0
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / Euro	46.8	50.0	52.3	52.3	52.3	52.3	52.3	52.3
Rritja reale e PBB	%	2.2	3.3	3.8	4.1	3.4	4.1	4.5	4.5
PBB	Lek miliardë	1,434.3	1,472.5	1,551.3	1,630.9	1,705.2	1,793.5	1,905.1	2,039.6
PBB	USD miliardë	11.4	11.9	13.0	15.1	15.6	16.4	17.4	18.6
PBB	Euro miliardë	10.3	10.7	11.6	12.8	13.8	14.6	15.5	16.6
PBB për banor	Lek mijë	497.9	512.0	539.9	567.5	593.4	624.1	662.9	709.6
PBB për banor	USD	3,952.8	4,124.0	4,532.9	5,255.7	5,416.8	5,696.8	6,051.2	6,477.8
PBB për banor	Euro	3,563.0	3,727.1	4,024.3	4,448.3	4,818.9	5,067.9	5,383.2	5,762.7
PBB për banor	USD-PPP	11,334.2	11,537.6	12,007.5	12,623.2	13,197.9	13,880.0	14,743.5	15,783.0
PBB për banor	Euro-PPP	10,638.9	10,239.4	10,322.5	10,851.8	11,345.9	11,932.2	12,674.5	13,568.1
Norma e papunësisë	%	17.5	15.6	14.1	12.8	11.4	10.6	9.8	9.4
Të ardhurat totale	% të PBB	26.4	27.6	27.7	27.6	27.8	28.0	27.8	27.8
Shpenzimet totale	% të PBB	30.5	29.5	29.7	29.2	29.7	29.7	29.1	28.9
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-4.1	-1.8	-2.0	-1.6	-1.9	-1.6	-1.3	-1.1
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-1.4	0.7	0.1	0.6	0.2	0.7	1.1	1.3
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	0.4	2.6	3.0	3.2	2.8	3.0	3.2	3.5
Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (Neto)	% të PBB	71.9	71.7	68.7	64.6	63.7	62.2	59.7	57.0
Borxhi Publik (Bruto)	% të PBB	72.7	72.4	70.1	67.9	65.5	64.4	59.8	58.3
<i>Borxhi publik i qeverise se pergjithshme</i>	% të PBB	68.8	68.7	66.9	65.1	62.9	61.9	57.6	56.2
<i>Borxhi publik jashte treguesve fiskale</i>	% të PBB	4.0	3.7	3.3	2.8	2.6	2.5	2.1	2.1
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-8.6	-7.6	-7.5	-6.7	-8.0	-7.1	-6.7	-6.2
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-17.3	-16.8	-15.1	-13.8	-15.2	-13.7	-12.9	-12.1
Mallra	% të PBB	-22.4	-24.3	-24.4	-22.5	-24.2	-23.5	-23.2	-22.8
Eksporte	% të PBB	7.5	6.7	6.9	7.7	7.0	7.8	8.0	8.1
Importe	% të PBB	-29.9	-30.9	-31.3	-30.2	-31.2	-31.2	-31.2	-30.9
Bilanci i pagesave	% të PBB	5.9	0.4	1.6	2.9	0.9	2.3	2.2	2.4
Rezervat valutore	Euro milion	2,880.0	2,945.0	2,995.9	3,367.3	3,495.7	3,826.5	4,161.9	4,558.7
Në muaj importi mallrash e shërbimesh	Muaj	7.6	7.2	6.7	6.9	6.5	6.8	7.0	7.2

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Banka Botërore

2. TREGUESIT KRYESORË TË BUXHETIT PËR VITIN 2020

2.1 PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE PËR VITIN 2020

Programimi i të ardhurave për vitin 2020, mbështet synimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për konsolidim fiskal, reduktim të deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Programi bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal nëpërmjet implementimit të projektit të fiskalizimit, dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, duke mbështetur në këtë mënyrë rritjen ekonomike të qëndrueshme, nëpërmjet nxitjes së prodhimit dhe eksporteve.

Në programimin e të ardhurave nga Tatimet dhe Doganat për vitin 2020, janë marrë në konsideratë faktorët kryesorë me ndikim në buxhet, përfshirë efektin e rritjes ekonomike dhe indeksit të çmimeve, politikat e reja fiskale si dhe efektet nga lufta kundër informalitet, e shoqëruar kjo me masa ligjore antishmangie me qëllim rritjen e nivelit të pajtimit vullnetar të tatimpaguesve me ligjin.

Metodologjia e programimit të të ardhurave është bazuar në modelet e njohura të programimit, si dhe në analizën e detajuar të faktorëve që ndikojnë në secilën taksë dhe tatim. Modelet bazë të përdorura janë:

- Parashikimet makroekonomike në lidhje me rritjen nominale dhe reale.
- Modeli bazuar në analizën e 60-grup produkteve kryesore për mallrat e importit
- Modeli i bazuar në analizën e serive kohore.
- Modeli bazuar në koeficientin e elasticitetit, “Buoyancy” dhe “Effective Tax Rate” për çdo taksë.

Në planifikim janë harmonizuar faktorët makroekonomikë, me treguesit kryesorë që ndikojnë në taksa specifike. Në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë për vlerësimin e të ardhurave janë:

- rritja nominale të PBB-së, duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Renta minerare dhe Taksa doganore.
- Kursi i pritshëm i këmbimit të dy monedhave kryesore: USD dhe EURO me Lekun;
- çmimet në bursë që ndikojnë në të ardhurat nga TVSH-ja dhe Renta minerare;
- sasi të pritshme të importit të mallrave.
- rritja e të ardhurave nga akciza për karburantet, cigaret, pijet etj, si rezultat i rritjes së pritshme në sasi të tyre, në përputhje me konsumin
- rritja e të ardhurave nga TVSH-ja në import dhe ajo brenda vendit.
- Programimi i fondeve të nevojshme për rimbursimin e tatimpaguesve, me qëllim uljen e stokut në fund të vitit 2020 me 67 % krahasuar me fundin e vitit 2019.
- rritja e të ardhurave nga Tatimi mbi Fitimin, e cila reflekton rritjen e deklarimit dhe qarkullimit të realizuar të operatorëve ekonomikë.

Të ardhurat tatimore që mblidhen nga administrata tatimore dhe ajo doganore në vitin 2020 programohet të jenë 334,12 miliard lekë, me rritje +6,42 % ose 20,16 miliard lekë krahasuar me të pritshmin e vitit 2019.

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore parashikohen të jenë 103 miliard lekë, +4,8 %, ose 4,7 miliard lekë krahasuar me të pritshmin e vitit 2019.

Të ardhurat doganore janë parashikuar duke u bazuar në analizën e trendit historik të 60 grup-produkteve kryesore, për një periudhë katër-vjeçare. Ky parashikim është korriguar me efektet e faktorëve të tjerë të jashtëm për secilën taksë. E njëjta procedurë është ndjekur edhe për të ardhurat nga tatimet, duke marrë për bazë modelin statistikor të projeksionit të të ardhurave të pritshme si dhe faktorët ekzogjenë me ndikim në çdo taksë.

Faktorët e jashtëm të marrë në konsideratë të cilët ndikojnë në rritjen e të ardhurave për vitin 2020 janë:

Kuadri Makroekonomik

Rritja nominale e Prodhimit të Brendshëm Bruto e skontuar me Koeficientin e Elasticitetit, është aplikuar duke analizuar këtë efekt në mënyrë të integruar me faktorë të tjerë për çdo taksë në veçanti, të ndërlidhur me të dhënat historike dhe projeksionet e çmimeve në tregjeve ndërkombëtare tek taksat ad-valorem si

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar, Renta minerare dhe Taksa doganore. Në projektion janë përfshirë, faktorët e mëposhtëm:

- Rritja nominale e PBB-së.
- Rritja e indeksit të cmimeve
- Kursi mesatar i këmbimit EURO–Lek dhe USD–Lek.
- Çmimet brent të naftës bruto dhe mineraleve të tjera.

Efektet e politikave fiskale

Për vitin 2020 nuk janë parashikuar ndryshime themelore fiskale. Prioritet do jetë zbatimi dhe matja e efekteve të politikave fiskale të miratuara ne 2-3 vitet e fundit, me qëllim konsolidimin e sistemit tatimor.

Ndryshimi kryesor ka të bëjë me ligjin e fiskalizimit, i cili pritet të ndikojë në transparencën dhe kontrollin e transaksioneve tregtare, nga ku gjenerohen detyrimet tatimore. Marrja në kohë reale e transaksioneve biznes-konsumator si dhe me pas e atyre biznes-biznes nëpërmjet përdorimit të faturës elektronike, synon që brenda një periudhe 2-3 vjecare, të rrisë parametrat e TVSH-së së brendshme nga 8,8 % e PBB-së, në 9,1 % të saj.

Parashikimi i të ardhurave sipas zërave për vitin 2020

Të ardhurat nga “T.V.SH-ja” parashikohet të jetë 151.6 miliardë lekë, 11.4 miliardë lekë më shumë se pritshmëria për vitin 2019, ose 8.1%. Burimet e rritjes së TVSH-se në vitin 2020 do të jenë:

- TVSH-së që do të gjenerohet si rezultat i rritjes ekonomike dhe indeksit të cmimeve;
- TVSH nga rritja e volumit të importeve dhe konjunktura e cmimeve ndërkombëtare;
- TVSH nga përmirësimi i administrimit, lufta ndaj informalitetit dhe kontrolli i zinxhirit të transaksioneve ndërmjet operatorëve. Në këtë proces jape ndikime pozitive implementimi i projektit të fiskalizimit.

Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin” rriten +8% ose 2.8 miliardë lekë më shumë se viti 2019, pra parashikohet të arkëtohen 38 miliardë lekë. Rritja e parashikuar në tatimin mbi fitimin bazohet:

- në rritjen ekonomike të projektuar
- në rritjen e vetdeklarimit nga ana e tatimpaguesve;
- në forcimin e kontrollit të deklaratave, bazuar në kriteret e riskut;

Të ardhurat nga “Akciza” programohen 50.5 miliardë lekë, me rritje +2.8 miliardë lekë ose 5.9% më shumë se pritshmëria e vitit 2019. Faktorët kryesorë që do ndikojnë në rritjen e parashikuar të të ardhurave nga akciza janë:

- programimi i rritjes së planifikuar të akcizës për cigaret me efekt 0.75 miliardë lekë;
- rritja me 4 % e importit/prodhimit të karburanteve dhe produkteve të tjera të akcizueshme si birra, vera etj;
- rritja e të ardhurave nga akciza e duhanit dhe zëvendësuesve të tjerë;
- lufta kundër informalitetit, kontrolli rigoroz i subjekteve të akcizës si dhe disiplinimi i mëtejshëm i procedurave të përfitimit të përjashtimeve dhe rimbursimeve nga kjo taksë.

Të ardhurat nga “Tatimi mbi të Ardhurat Personale” parashikohen 47.5 miliardë lekë, në të njëjtin nivel me pritshmëritë e vitit 2019. Në parashikimin e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale janë marrë në konsideratë:

- ulja e të ardhurave nga tatimi mbi dividendin, pasi në vitin 2019 u arkëtua përveç dividendit të vitit 2018 edhe dividenti i viteve të kaluara. Pra ky faktor për rreth 6 miliardë lekë, është marrë në konsideratë si “one off revenue”;
- rritja e numrit të të punësuarve, bazuar në ecurinë e vitit 2019;
- rritja e të ardhurave të tjera personale.

Të ardhurat nga “Taksa Nacionale dhe të tjera” vlerësohen të jenë 39.5 miliardë lekë. Parashikimet për këtë taksë për vitin 2020 janë +8.5% ose 3.1 miliardë lekë më shumë se i pritshmi 2019.

Të ardhurat nga “Taksa Doganore” në vitin 2020 vlerësohet të jenë 7 miliardë lekë, me rritje 396 milionë lekë ose 6% krahasuar me vitin 2019. Në programimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë efektet e rritjes së importeve të tatueshme.

Të ardhurat nga “Kontributet për Sigurime Shoqërore e Shëndetësore” në vitin 2020 parashikohet të rriten me +4,8%, ose +4,7 miliardë lekë krahasuar me të pritshmin e vitit 2019. Të ardhurat nga kontributet parashikohet të jenë 103 miliardë lekë, nga 98.3 miliardë lekë që parashikohet të arkëtohen në vitin 2019. Rritja e programuar e të ardhurave mbështetet në këta faktorë:

- rritjen ekonomike çka do reflektohet në rritjen e numrit të punëmarrësve;
- forcimin e administrimit nëpërmjet kontrollit të nivelit të pagës të deklaruar dhe deviacionit të saj nga paga reale që përfitohet;
- rritmin e rritjes së të ardhurave nga kontributet në dy-tre vitet e fundit;

2.2 SHPENZIMET PUBLIKE

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2020 është planifikuar **531.97 miliardë lekë** ose **29.6% e PBB**.

Shpenzimet e personelit për vitin 2020, reflektojnë koston aktuale të Administratës Publike, si dhe koston aktuale të institucioneve të krijuara për mbështetjen e reformës në drejtësi. Shpenzimet totale për pagat në Administratën Publike janë planifikuar në masën **83.8 miliardë lekë** ose **4.7% e PBB**.

Shpenzimet për interesa parashikohen në nivelin **40.95 miliardë lekë** ose **2.3% të PBB**, për të përballuar çdo risk të mundshëm të rritjes së normave të interesit.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2020 *(pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit)*, janë parashikuar në masën **46.7 miliardë lekë** ose rreth **2.6% e PBB-së**. Në këtë zë është programuar mbështetja me prioritet e politikave ekzistuese të qeverisjes qendrore si skema e fermerëve, mirëmbajtja e rrjetit rrugor kombëtar dhe mirëmbajtja e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2020, janë parashikuar në masën **57.128 miliardë lekë**, me një rritje prej 6.2% më shumë se në vitin 2019. Këto shpenzime për vitin 2020, zënë 3.2% të PBB-së nga 2.3% që zinin në vitin 2013. Burimi kryesor i rritjes së shpenzimeve vendore për vitin 2020 vjen kryesisht nga rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, si dhe nga rritja e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme e buxhetit të shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore do të jetë 1 përqind e PBB-së ose **400 milionë lekë** më e madhe se sa ajo e vitit 2019 dhe **rreth 46 përqind** më e lartë se transferta e vitit 2015.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshin shpenzimet totale për Fondet e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej **188.58 miliardë lekë**. Niveli i shpenzimeve për *Skemën e Sigurimeve Shoqërore* për vitin 2020, parashikohet në masën **137.5 miliardë lekë** ose **7.7% e PBB**. Nga ky fond, për indeksimin e pensioneve është parashikuar niveli prej **2.52 miliardë lekë**. Ndërsa, shpenzimet e *Skemës së Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor* për vitin 2020 janë parashikuar në masën **44.1 miliardë lekë** ose **2.5% e PBB** nga 41.9 miliardë lekë të parashikuara në aktin normativ për vitin 2019.

Së fundi, shpenzimet për *Fondin e Kompensimit në vlerë të Pronarëve*, parashikohen në total në masën **4.5 miliardë lekë** ose 0.3% e PBB.

Shpenzime të tjera sociale, përfshin fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe bonusin e lindjeve.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin **600 milionë lekë**.
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin **21 miliardë lekë** ose 1.2% e PBB.
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej **1 miliard lekë** ose 0.05% e PBB.
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej **2 miliardë lekë** ose 0.1% e PBB.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën **1.29 miliardë lekë** duke pësuar një ulje të lehtë krahasuar me një vit më parë. Këto shpenzime shkojnë për mbështetjen e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve bazuar në performancën e tij, si dhe për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore, veprimtarinë e shërbimeve qeveritare dhe nxitjen e punësimit.

Niveli i Fondit Rezervë për vitin 2020, planifikohet në masën **1.7 miliardë lekë**, përkatësisht **1.4 miliardë lekë** Fond Rezervë i Këshillit të Ministrave dhe **300 milionë lekë** fond kontigjence për mbështetjen e nevojshme të reformës në drejtësi.

Investimet Publike për vitin 2020 janë planifikuar në masën **4.7% e PBB** ose **83.8 miliardë lekë** (duke përfshirë këtu dhe mbështetjen për Sektorin e energjisë 2.5 miliardë lekë). Në planifikimin e investimeve për vitin 2020 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Ashtu, si edhe në vitin 2019, dhe në vitin 2020 do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim. Për planifikimin e investimeve janë ndjekur kriteret e mëposhtme:

- *Prioritetet e Programit të Qeverisë për periudhën 2017 – 2021;*
- *Prioritetet e integritit europian;*
- *Projektet në vazhdim.*
- *Mbështetja me kosto lokale dhe TVSH për projektet me financim të huaj;*

2.3 DEFICITI BUXHETOR

Defiçiti buxhetor për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1.6% të PBB. Ky përbën nivelin më të ulët të targetuar në dy dekadat e fundit. Për të pestin vit rradhazi balanca primare parashikohet të jetë pozitive në nivelin 0.7% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse për të pestin vit rradhazi. Rrjedhimisht targetohet që niveli i “borxhit publik neto nga asetet likuide në TSA” do të ulet me rreth 1.5 pikë përqindje [në 62.2% të PBB] dhe do të vijojë këtë trend rënës në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Financimi i defiçitit do të realizohet nëpërmjet burimeve huamarrjes së brendshme në rreth 1.3% të PBB, huamarrjes së huaj në rreth 0.8% të PBB ku parashikohet edhe emetimi i një eurobondi tjetër. Ndërkohë parashikohet të ketë një akumulim shtesë të gjendjes së depozitës në TSA gjatë vitit 2020 prej rreth 0.4% e PBB.

PARIMET DHE RREGULLAT FISKALE

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej Ligjit Organik të Buxhetit nr 57/2016, ligji i buxhetit për vitin 2020, materializojnë parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

1. *Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të Produktit të Brendshëm Bruto;*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2020 targeton një nivel të borxhit publik total në 64.4% të PBB nga niveli prej 65.5% e PBB i pritshëm për vitin 2019.

Njëkohësisht, edhe niveli i borxhit publik neto nga gjendja e mjeteve likuide në llogarinë e vetme të thesarit (TSA) targetohet me një reduktim në 62.2% e PBB në fund të 2020 nga 63.7% që pritet të rezultojë për vitin 2019.

2. *Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit;*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2020 bazohet në projeksionet e mëposhtme të PBB nominale, të cilat paraqiten në mënyrë krahasimore kundrejt projeksioneve të raportit “Perspektiva ekonomike botërore” (World Economic Outlook), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar më Tetor 2019²:

Parashikimet e PBB nominale të FMN dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

në miliardë lekë	2016	2017	2018	2019	2020
				Para.	Para.
FMN - Perspektiva Ekonomike Botërore	1,472	1,551	1,626	1,705	1,809
Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1,472*	1,551*	1,631*	1,705	1,793
Diferenca FMN - MFE (diferenca nuk duhet të jetë më e vogël se zero)	0.0	0.0	-4.7	0.1	15.5

*Vlera e PBB nominale për këto vite është përditësuar sipas vlerave më të fundit të publikuara nga INSTAT.

3. *Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontingjencë e veçantë, prej jo më pak se 0,7 për qind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2020 përfshin në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontingjencë për impaktin në borxhin publik nga luhatjet e normave të interesit, et.j” një kontingjencë prej 4 miliardë lekë ose 0.8% e shpenzimeve totale. Kjo vlerë e përfshirë në buxhet është e papërdorshme për qëllime të tjera përveç pagesës së interesave nëse këto të fundit për të gjithë vitin në tërësi rezultojnë më tepër se sa alokimet respektive në buxhet.

4. *Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rastet e arkëtimit ato përdoren, jo më pak se 50 për qind, për uljen e borxhit publik dhe pjesa tjetër për investime publike. Pas arritjes së nivelit të borxhit publik, sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni, përdorimi i të ardhurave të arkëtuara nga privatizimet përcaktohet në ligjin vjetor të buxhetit.*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, ligji vjetor i buxhetit 2020 nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.

5. *Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale të parashikuara çdo vit në ligjin e buxhetit.*

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – “rregulli i artë”) të LOB deficiti i targetuar në këtë ligj vjetor të buxhetit 2020 është 65% më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara. Rrjedhimisht, balanca korente e bartëguar është pozitive në nivelin prej rreth 3.0% të PBB.

1 Në vlerë nominale stoku i borxhit total i pritur (vlerësuar) për vitin 2019 është 1,117.5 miliardë lekë, ndërsa ai i targetuar për vitin 2020 është 1,154.4 miliardë lekë. Ndërsa projeksionet (parashikimet) e PBB nominale janë respektivisht 1,705.2 miliardë lekë për vitin 2019 dhe 1,793.5 miliardë lekë për vitin 2020.

2 <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2019/10/01/world-economic-outlook-october-2019>

3. MENAXHIMI I BORXHIT PUBLIK

Borxhi Publik gjatë vitit 2019 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, duke qenë në linjë me nevojat e buxhetit, politikat makro-fiskale për konsolidimin e financave publike dhe objektivat strategjikë afatmesëm të menaxhimit të borxhit.

Në linjë me buxhetin e vitit 2019 është realizuar me sukses huamarrja, e cila ka mundësuar rifinancimin e borxhit ekzistues, menaxhimin e nevojave për likuiditet dhe financimin e deficitit buxhetor të planifikuar për vitin 2019.

Nisur nga vlerësimet paraprake për sa i përket dinamikës së treguesve makroekonomikë (*të tillë si rritja ekonomike, deficitit buxhetor, kursi i këmbimit etj.*), niveli borxhit publik në raport me PBB pritet të rezultojë me rënie edhe në vitin 2019, duke qenë në linjë me politikat makro-fiskale për konsolidimin e nivelit të borxhit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Në përputhje me objektivat e strategjikë afatmesëm të menaxhimit të borxhit, gjatë nëntëmuorit 2019 portofoli i borxhit publik është rikompozuar në drejtim të reduktimit të mëtejshëm e ekspozimit ndaj risqeve. Në këtë drejtim, në portofolin e borxhit të brendshëm ka vijuar të ulet pesha e borxhit që maturohet brenda një viti dhe pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme, duke mundësuar reduktimin e ekspozimit ndaj riskut të rifinancimit dhe atij të normave të interesit. Risku i kursit të këmbimit vijon të mbahet nën kontroll, pasi stoku i borxhit në valutë qëndron ndjeshëm nën kufirin e strategjik të përcaktuar në Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit.

Kostot për njësi të borxhit kanë pësuar një rënie të moderuar kryesisht për shkak të nivelit ende të ulët të normave të interesit, të cilat kanë mundësuar rifinancimin e titujve afatgjatë që maturohen me tituj me norma interesi më të favorshme. Normat e interesit në nivele ende të ulëta vazhdojnë ta favorizojnë strategjinë e rikompozimit të borxhit në drejtim të titujve afatgjatë, duke mundësuar raporte të favorshme ndërmjet kosos dhe risqeve.

Në vazhdim të angazhimit të ndërmarrë në lidhje me përmirësimin e mëtejshëm të tregut primar të titujve shtetërorë dhe zhvillimin e tregut sekondar, përgjatë vitit 2019 është vijuar me praktikën që kontribuojnë në krijimin e madhësive *benchmark* dhe konsolidimin e kurbës së yield-it në segmentin e titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë. Në këtë drejtim, ka vijuar të zbatohet projekti pilot “Për emetimin e obligacioneve 5 vjeçare referencë³”, ndërkohë që gjatë këtij viti ky projekt është shtrirë edhe tek obligacionet 3 vjeçare.

Gjatë vitit 2020, menaxhimi i borxhit do të ketë në fokus përmirësimin e mëtejshëm të strukturës së borxhit (*kryesisht strukturës së borxhit të brendshëm*) në drejtim të uljes së ekspozimit ndaj risqeve dhe mbajtjes nën kontroll të kosos. Në drejtim të reduktimit të risqeve, huamarrja e re në tregun e brendshëm do të synohet të realizohet kryesisht nëpërmjet titujve afatgjatë me norma interesi fikse, duke synuar zgjatjen e mëtejshme të jetëgjatësisë së borxhit të brendshëm. Nëpërmjet titujve afatshkurtër kryesisht do

³ https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Titujt_shteterore/Titujt_reference/

të synohet rifinancimi i titujve afatshkurtër që maturohen, menaxhimi i nevojave afatshkurtra për likuiditet, si edhe përmirësimi i strukturës së profilit vjetor të maturimeve.

Huamarrja nëpërmjet burimeve të huaja, gjithashtu do të paraqesë një kontribut të konsiderueshëm, pasi do të financojë në terma bruto rreth 20% të nevojave të përgjithshme për hua. Burimet potenciale të huamarrjes së huaj vlerësohet të jenë huatë nga burimet dypalëshe dhe shumëpalëshe, të cilat do të financojnë projektet ekzistuese dhe projektet e reja të konsideruara si prioritare nga qeveria, si edhe huatë në formën e mbështetjes buxhetore, të cilat do të mbështesin reformat dhe politikat zhvillimore të vendit. Huamarrja nëpërmjet këtyre burimeve do të kontribuojë në optimizimin e kostos së borxhit, duke qenë se pjesa dërmuese e këtyre huave akordohen me norma interesi të favorshme.

Gjithashtu, një burim potencial i cili do të synohet të shfrytëzohet gjatë vitit të ardhshëm do të jetë tregu i kapitaleve nëpërmjet instrumentit të Eurobond-it. Huamarrja nëpërmjet këtij instrumenti, përveç plotësimit të nevojave për hua do të garantojë mbajtjen e nivelit të huamarrjes në tregun e brendshëm brenda kapaciteteve optimale, do të sigurojë valutën e nevojshme për të shërbyer detyrimet e borxhit në valutë, si edhe do të garantojë prezencën e vendit në tregjet ndërkombëtare të kapitalit.

Në kuadër të zhvillimit të tregut të titujve shtetërorë do të vijohet me praktikën që kontribuojnë në krijimin e madhësive *benchmark* dhe konsolidimin e kurbës së yield-it në segmentin e titujve shtetërorë afatmesëm dhe afatgjatë.

4. POLITIKAT SEKTORIALE DHE PËRFITIMET PËR QYTETARIN

BUJQËSIA DHE ZHVILLIMIT RURAL

• Prioritetet 2020-2022

Prioritetet e sektorit të bujqësisë, për periudhën afatmesme 2020-2022, janë si më poshtë:

- Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas;
- Konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, administrimi i qëndrueshëm, ruajtja e saj nga dëmtimi, gërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë;
- Nxitja e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur kooperimin;
- Mbështetje për agroindustrinë;
- Mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale;
- Administrimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet kujdesit, sigurimit dhe administrimit të qëndrueshëm të sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmbytjeve;
- Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët.
- Zhvillimin i qëndrueshëm i sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimin e përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit si dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

• Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2020-2022

Në fushën e “Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit”, synohet të realizohet:

- Rritja e % së fermerëve që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës ujëtare dhe kulluese ndaj totalit të fermerëve në sipërfaqen potencialisht të ujitshme nga 70.3% në vitin 2019, në 76% në vitin 2022;
- Përqindja e sipërfaqes ujëtare ku fermerët kanë akses për ujë për ujitje, kundrejt sipërfaqes potencialisht të ujitshme (360 000 ha) nga 66.6% në vitin 2019, në 72% në vitin 2022;
- Përqindja e hidrovoreve të rehabilituara/ndërtuara/rikonstruata, kundrejt totalit të nevojshëm (14 hidrovorë) nga 21.4% në vitin 2019, në 36% në vitin 2022;
- Mirëmbajtje vjetore të rrjetit kullues për 45 000 hektarë tokë si proces ciklik vjetor;
- Vepra të mbrojtjes nga përmytja të rehabilituara/ndërtuara (argjinatura gjatësore dhe penele tërthorë), kundrejt totalit të nevojshëm (300 km) nga 12% në vitin 2019, në 28% në vitin 2022.

Në fushën e zhvillimit Rural duke mbështetur Prodhimin Bujqësor, Blegtoral, Agroindustrial dhe Marketingun” synon:

- Rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore dhe blegtorale përmirësimi i standardeve dhe garantimi i sigurisë ushqimore, si dhe zhvillimi i zonave rurale për një zhvillim bujqësor dhe rural të qëndrueshëm përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale, duke rritur:
 - ✓ Numrin e të punësuarëve në bujqësi dhe agropërpunim;
 - ✓ Sipërfaqet e mbjella me fruta dhe perime;
 - ✓ Aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agropërpunim të kryera.
- Arritja e standardeve të BE-së, në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, nëpërmjet:
 - ✓ Shtimit të numrit të përfituesëve nga skema e masave mbështetëse në bujqësi nga 1800 përfitues në vitin 2019 në 2450 përfitues në vitin 2022;
 - ✓ Certifikimit dhe testimit të farave dhe fidanëve që hidhen në treg në mënyrë që të sigurohen inpute cilësore për bujqësinë.

Nëpërmjet programit “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit” synohet fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë nëpërmjet:

- ✓ Kontrolleve dhe monitorimeve të sëmundjeve infektive dhe zoonotike në kafshët e gjalla duke ulur në këtë mënyrë numrin e kafshëve të prekura nga Bruceloza, nga plasja dhe nga tuberkulozi.
- ✓ Do të vijojë zbatimi i politikave të shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve të gjalla, si dhe programet e parandalimit, kontrollit, eliminimit deri në çrrënjosjen e sëmundjeve infektive në kafshë, sipas përcaktimeve të legjislacionit veterinar, nëpërmjet:
 - ✓ Vaksinimit të rreth 930 mijë kafshëve përgjatë viteve 2020-2022.
 - ✓ Rritjes së numrit të kontrolleve tek kafshët nga 170 mijë në vitin 2019, në 173 mijë në vitin 2022.
 - ✓ Punësimit në të gjitha komunat të një veterineri zyrtar me qëllim që të rritet kontrolli dhe fusha e mbulimit të vendit me mjekë veterinerë (në total 170 veterinerë).

- Mbajtjes së një fondi për emergjencat veterinarë dhe emergjencat për sigurinë ushqimore. Ky zë përdoret në rastet e shpërthimit të sëmundjeve ose epidemive të cilat janë të pa parashikueshme.
- Rritja e numrit të certifikatave të unifikuara për eksport nga 18 në vitin 2019, në 40 në vitin 2022.
- Rritjes së numrit të operatorëve që aplikojnë standardet HACCP në sigurinë ushqimore nga 1000 në vitin 2019, në 1200 në vitin 2022.
- Rritjes së numrit të inspektimeve; uljes së numrit të gjobave të vendosura nga inspektimet në terren (nga 1599 në vitin 2019, në 1200 në vitin 2022), uljes së numrit të bizneseve të mbyllura për mosplotësimin e kushteve të sigurisë ushqimore (nga 383 në vitin 2019, në 300 në vitin 2022), numrit të rasteve të produkteve ushqimore të hequra nga tregu ushqimore (nga 60 në vitin 2019, në 38 në vitin 2022) dhe uljes së numrit të ngarkesave të kthyera në Pikat e Inspektimit Kufitar (nga 38 në vitin 2019, në 26 në vitin 2022) si pasojë e politikave të ndërmarra nga MBZHR.
- Uljen e rasteve të sëmundshmërisë së njerëzve të shkaktuara nga kafshët;

ZHVILLIMI EKONOMIK

• Prioritetet 2020-2022

Gjatë periudhës 2020-2022 prioritetet në fushën e mbështetjes së zhvillimit ekonomik do të jenë:

- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjeve në panairë ndërkombëtare dhe road show promovuese, vizita në kompani (after care), në kuadër të zbatimit të aktiviteteve për krijimin e zonës ekonomike rajonale / MAP REA si dhe monitorim efektiv investimesh strategjike;
- Ndërmarrja me sukses e aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe të produkteve “*Made in Albania*”;
- Rritja e përpjekjeve për të reduktuar informalitetin e mikrondërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si pengesë kyçe në aksesin e financimeve të SME-ve, nëpërmjet:
 - ✓ Rritjes së konkurrueshmërisë së bizneseve shqiptare në tregun ndërkombëtar nëpërmjet granteve nga Fondi i Konkurrueshmërisë (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2022);
 - ✓ Avancimit të mëtejshëm në fushën e teknologjisë dhe inovacionit nëpërmjet granteve që i akordohen bizneseve të specializuara në këtë fushë nga Fondi i Inovacionit (75 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2022);
 - ✓ Nxitjes së krijimit të bizneseve të reja në sektorë me potencial zhvillimi nëpërmjet Fondit Start-Up (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2022);
 - ✓ Mbështetjes së sipërmarrjeve të sektorit të artizanatit dhe zejtarisë me qëllim konsolidimin e tyre në treg dhe rritjen e numrit të të punësuarëve nëpërmjet “Fondit në mbështetje të biznesit kreativ”, ku në total parashikohet të përfitojnë 85 SME vendase me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë (60 biznese të mbështetura financiarisht në 2019-2021).
 - ✓ Sigurimi i implementimit efektiv të masave të “gjelbëra” të planifikuara për SME-të nëpërmjet ridizenjimit të skemave mbështetëse.

- ✓ Nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve arsimore dhe bizneseve, përmes aksesit të lehtë të informacionit
- ✓ Zhvillimi i një qasje holistike në mbështetje të SME-ve në integrimin e zinxhirit të vlerave globale përmes pjesmarrjes së Shqipërisë në rrjetin e Enterprise Europe Netëork, Shtylla e Programit COSME.

INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

• Prioritetet 2020-2022

- ✓ Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikën e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- ✓ Bazuar në objektivin e përgjithshëm të Strategjisë Sektoriale të Transportit dhe Planit të Veprimit 2016-2020, synon: (i) të zhvillojë më tej sistemin kombëtar të transportit, (ii) të përmirësojë ndjeshëm qëndrueshmërinë, ndërlidhjen, ndërveprimin dhe integrimin e tij më gjerë, me sistemin ndërkombëtar dhe evropian të transportit dhe rajonin;
- ✓ Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes: (i) një portofoli të investimeve publike; dhe (ii) përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standartizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- ✓ Rritja e efikasitetit të energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme;
- ✓ Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, nëpërmjet vazhdimin të ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve të ngurta dhe rehabilitimit të venddepozitimeve ekzistuese.

❖ Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2020-2022

Programi “Transporti Rrugor”

- Ndërtimi rruga Kardhiq - Delvinë Loti 8 (rishikimi dhe plotësimi i sinjalistikës nga Loti 1 deri në Lotin 7), Subvencioni i Kontratës koncesionare "Për ndërtimin, përmirësimin, shrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostrades Milot - Morinë“, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugës Porti i Jahteve - By Pass Orikum -Dukat (Ura e Shën Elizës) si dhe financimi i rrugës së Arbrit plus supervizionin;
- Rritja e sigurisë rrugore në të gjitha akset kombëtare ku synohet ulja e numrit të aksidenteve me pasojë humbje jetë njerëzish dhe numri i pikave të zeza me 25%, sipas Strategjisë Kombëtare të Transportit.
- 3483 km rrugë të mirëmbajtura sipas standardeve në vitin 2022 në të gjithë territorin;
- Numri i kilometrave të ndërtuara rehabilituara, sistemuara, asfaltuara dhe të pajisura me sinjalistikë rrugore do të arrijë në 602 Km në vitin 2020 nga 308 Km që pritet të ndërtohen deri në fund të vitit 2019;

Programi “Ujësjellës Kanalizime”

- Reduktimi i humbjeve në nivel kombëtar në masën 50% në vitin 2022;
- Furnizimi me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 24 orë në vitin 2022.

- Mesatarja e orëve të furnizimit me ujë të pijshëm në rang kombëtar rritet në 14 orë në ditë në 2022, nga 12.5 orë në ditë në vitin 2019;
- Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të pijshëm zonë Urbane 95% në vitin 2022 nga 94% në vitin 2019;
- Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të pijshëm zonë Rurale 62% në vitin 2022 nga 59% në vitin 2019;
- Mbulimi me kanalizime zonë Urbane 81% në vitin 2022 nga 80% në vitin 2019;
- Mbulimi me kanalizime zonë Rurale 22% në vitin 2022 nga 16% në vitin 2019;
- Orët mesatare të furnizimit me ujë të pijshëm synohet në 16 orë/ditë në vitin 2022 nga 13 orë/ditë në vitin 2019;
- Sasia e ujit të faturuar synohet të arrihet në 122 litër/ frymë/ditë në vitin 2022 nga 115 litër/ frymë/ditë në vitin 2019;
- Orët e furnizimit me ujë në zonat bregdetare synohet të arrihet në 24 orë/ditë në vitin 2022 nga 13 orë/ditë në vitin 2019;
- Reduktimi i humbjeve në rrjet në nivel kombëtar synohet të arrihet në 50% në vitin 2022 nga 62% në vitin 2019;
- Mbulimi me shërbimin e ITUN (kanalizime+gropa septike) synohet të arrihet në nivelin 17% në vitin 2022 nga 12% në vitin 2019;
- Përqindja e mbulimit të kostove të Ujësjellës-Kanalizimeve me të ardhurat synohet të arrihet në vlerën 90% në vitin 2022 nga 75% në vitin 2019;

Programi “Mbështetje për Energjinë”

- Zhvillim i qëndrueshëm i ekonomisë nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurta energjetike me kosto minimale;
- Diversifikimi i furnizimit me burime energjetike dhe integrimi në rrjetet energjetike rajonale dhe Europiane, duke nxitur investimet dhe përmirësuar arkëtimet dhe likuiditetet;
- Në vitin 2020 do të rritet përdorimi i energjisë së rinovueshme me 38% kundrejt vitit 2019;
- Në vitin 2020 do të rritet efënca e energjisë me 6.5% referuar vitit 2019.

Programi “Menaxhimi i Mbetjeve Urbane”

- Në vitin 2022, synohet që të trajtohen rreth 50% të mbetjeve me landfill-e sipas standardeve, nga 30% që parashikohet në fund të vitit 2019;
- Norma e ndotjes së ajrit synohet të arrihet në 39 µg/m³ në 2022 nga 45 µg/m³ që pritet të arrihet në fund të 2019;
- Norma e mbetjeve të rikuperuara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të prodhuara synohet të arrihet në 30% në 2022 nga 3% që synohet në fund të 2019;

Programi “Planifikimi Urban”

- Do të mbështeten projektet me fokus lokal, rajonal dhe në rang vendi, si dhe hartimin e rregullave teknike në projektim duke i harmonizuar këto plane me PPK, PINS Durana dhe PINS Tiranë Durrës, për një zhvillimit të barabartë të territorit.
- Projektet e Përmirësimit të Infrastrukturës Publike “100 Fshatrat”;

Programi “Transporti Ajror”

- Rritja e standarteve dhe performancës së Organit Kombëtar të incidenteve/Aksidenteve ajrore nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve, në kuadër edhe të ndërtimit të infrastrukturave të reja aeroportuale;
- Numri i investigimeve të kryera në vitin 2022 të arrijë në 5 nga 4 investigime që pritet në 2020;
- Zbatimi i standarteve të njehësura të sigurisë dhe parrezikshmërisë në transportin ajror.

Programi “Transporti Detar”

- Kryerja e investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale në vend, me qëllim shndërrimin e Shqipërisë në një vend të zhvilluar detar që mbështet rritjen ekonomike dhe shpejton procesin e integritimit në BE;
- Rritja e volumit të përpunimit të mallrave në porte në masën 40% në vitin 2022 nga 25% që është aktualisht në 2019

Programi “Transporti Hekurudhor”

- Rikonstruksioni i segmentit hekurudhor Tiranë – Durrës si dhe ndërtimi i linjës së re hekurudhore Tiranë-Rinas;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore ekzistuese si dhe mirëmbajtja e mjeteve-hekurudhore; Studime fizibiliteti dhe projekte zbatimi për segmente të reja dhe ekzistuese hekurudhore.

Programi “Mbështetje për Burimet Natyrore”

- Nxitja dhe inkurajimi i ndërtimit të objekteve të përpunimit të mineraleve;
- Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit minerar dhe rritja e transparencës në shfrytëzimin racional të burimeve natyrore;
- Rritja e lejeve minerare aktive në të cilat zhvillohet aktivitet minerar konform standarteve;
- Realizimi në vazhdimësi i funksioneve të mbikëqyrjes së shfrytëzimit racional e efektiv të pasurive minerale, monitorimit minerar dhe të fenomeneve të postshfrytëzimit, rritja e kontrollit për rehabilitimin minerar;
- Përmirësimi i transparencës së biznesit në industrinë nxjerrëse, në mënyrë që të ardhurat nga ky biznes të kontribuojnë më shumë në zhvillimin e vendit.

Programi “Mbështetje për Industrinë”

- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për inspekimin dhe mbikëqyrjen, sigurinë në punë për monitorimin e inspektimit dhe mbikëqyrjes së sigurisë teknike të produkteve / pajisjeve / instalimeve në fushat e veprimtarisë së MIE;
- Rritja e standardeve të produkteve dhe sigurisë së pajisjeve / instalimeve me 7% deri në vitin 2022
- Nxitja e interesit të biznesit vendas dhe të huaj për mundësi zhvillimi veprimtarish industrial;
- Reduktimi i rrezikut nga kimikatet e rrezikshme me 13% deri në vitin 2022.
- Zhvillimi i strukturave dhe burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për sigurimin e kushteve të domosdoshme për inspektimin dhe mbikëqyrjen e shëndetit, sigurisë në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore të veprave hidroenergjetike;

- Rritja dhe përmirësimi i standarteve, kushteve të punës dhe të sigurisë së depozitimit dhe ruajtjes së kimikateve të rrezikshme nën përgjegjësinë e MIE-s, në Qendrën e Grumbullimit dhe Trajtimit të Kimikateve të Rrezikshme;
- Përfundimi i procesit të likuidimit dhe mbylljes së ish ndërmarrjeve industriale në varësi të MIE-s. Rehabilitimi i territoreve të ish ndërmarrjeve për nxitjen e investitorëve dhe promovimin e tyre për përdorim si parqe industriale;
- Rritja e mumrit të mostrave të analizuara të naftës dhe nënprodukteve të saj, të prodhuara në vend dhe të importuara në masën deri në 9200 në vitin 2022;
- Promovimi tek biznesi i studimeve tekniko-ekonomike për industrinë e Lëkurë-Këpucës, industrisë së bakrit, nikel-silikateve dhe kuarciteve, zhvillimit të QGTK dhe hartimi i raporteve mjedisore si dhe zhvillimi i disa ish territoreve industriale për ushtrimin e veprimtarive ekonomike.

REFORMA E UJIT

Duke patur si qëllim krijimin e një sektori të qëndrueshëm, i cili ofron shërbim cilësor për qytetarët, reforma në sektorin e ujit, është një nga prioritetet e Qeverisë.

Reforma në sektorin e ujësjellës kanalizimeve është mbështetur në reformimin e mirëqeverisjes dhe orientimin e investimeve drejt performancës, si dhe drejt sigurimit të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë.

Dy nga objektivat strategjik të sektorit janë:

- Reduktimin e Ujit pa të Ardhura;
- Përmirësimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonat bregdetare me rëndësi turistike.

Në kuadër të mirëqeverisjes Ministria përgjegjëse për infrastrukturën ka ndërmarrë këto nisma:

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për sektorin e ujësjellës kanalizimeve;
Me Urdhërin e Ministrit të MIE, Nr.581, datë 18.07.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e ligjit të funksionimit të sektorit të ujësjellës kanalizimeve”, është ngritur grupi i punës i cili, do të përgatisë ligjin sektorial të ujësjellës kanalizimeve, duke sjellë për herë të parë një ligj sektorial, i cili do të rregullojë raportet e funksionimit të gjithë aktorëve, institucioneve të përfshira në sektor, duke arritur kështu qartësinë dhe shmangjen e mbivendosjeve ndërmjet kompetencave të institucioneve.
2. Me Urdhërin e Ministrit të MIE, Nr.775, datë 6.11.2018 “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e strategjisë sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve”, po punohet për hartimin e Strategjisë sektoriale 2020-2030, e cila do të integrojë brenda saj dhe një mekanizëm të qartë dhe operacional për qëndrueshmërinë financiare të sektorit.
3. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve kryesore në këtë sektor;

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve në nivel qendror, u krijua me anë të VKM Nr 431, datë 11.07.2018 Agjencia Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve. AKUM do të luajë një rol të rëndësishëm në monitorimin e standardeve të shërbimit të ofruar për qytetarët dhe gjithashtu në monitorimin e performancës së shërbimeve UK me qëllim shtyerjen e sektorit drejt performancës.

Në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shoqërive të ujësjellës kanalizimeve u miratua programi kombëtar i trajnimit dhe certifikimit bazuar në testim, në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur, me anë të Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr.660, datë 28.09.2018.

Është ngritur Bordi i Certifikimit me Urdhërin e Ministrit të MIE, Nr.229, datë 03.06.2019 “Për krijimin e bordit të certifikimit për programin kombëtar të trajnimit dhe certifikimit bazuar në testim në sektorin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotur”, i cili ka si qëllim që të sigurojë një proces të vazhdueshëm të zbatimit të Programit të Certifikimit të Bazuar në Testim, në përputhje me kuadrin ligjor për certifikimin e fuqisë punëtore të sektorit të ujit në Shqipëri.

Shtyrja e sektorit drejt performancës:

Në fillim të vitit 2019, në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 138, datë 30.01.2018 “Për miratimin e treguesve dhe kritereve, të përfshira në kontratën e performancës (Model Tip), për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës kanalizimeve” u nënshkruan me secilin prej Krytarëve të bashkive kontratat e performancës, të cilat synonin formalizimin e sektorit, rezultatet e të cilit, në sajë edhe të aksionit në këtë sektor, për 6 mujin e 2019 janë:

- Vendosija e matësave të rinj 37.938 matës
- Shtuar 20.188 kontrata të reja
- Arkëtuar për 6 mujin e parë 2019 - 5.203.187.000 lekë

Përmirësimi i performancës së shoqërive të ujësjellës kanalizimeve do të arrihet edhe nëpërmjet një programi gjithëpërfshirës të Reduktimit të Ujit pa të Ardhura, ku synohet që në fund të vitit 2021, ky tregues të jetë ulur me 20%; Për secilën shoqëri ujësjellës kanalizimesh, është hartuar një plan i detajuar masash teknike dhe menaxheriale, i cili do të monitorohet nga MIE.

Sa i përket subvencioneve, në kuadrin e zbatimit të Reformës së Ujit, janë miratuar këto akte nënligjore:

- Udhëzim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 2, datë 02.04.2019 “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve”.
- Udhëzim i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 6, datë 14.10.2019 “Për një shtesë dhe ndryshim në Udhëzimin Nr.2, datë 2.04.2019 “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve

REFORMA E UJIT

Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në zonat bregdetare me rëndësi turistike, për të cilën në vitin 2019 është planifikuar objekti:

- Studim projektim i furnizimit me ujë dhe sistemim i ujrave të përdorura për zonat bregdetare –I, i cili do të japë në mënyrë të detajuar sasinë e fondeve që do të nevojiten për investime për brezin e parë të bregdetit në vitet 2020 e vazhdim.
- Përmirësimi i infrastrukturës së ujrave të zeza në zonën bregdetare Vlorë, i cili do të sistemojë ujërat e zeza në zonën kodrinore mbi Lungo Mare.

Detajimi i buxhetit për vitet 2020-2022 për sektorin Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime është bazuar në realizimin e objektivave të mëposhtme:

- Furnizimin me 24 orë ujë të zonave Urbane deri në vitin 2023
- Zgjerimin dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të zonave bregdetare
- Mbulimin e kostos operative dhe rritja e performances se Ndërmarrjeve
- Mbulimin me Kanalizime dhe ITUN

Që prej vitit 2017, subvencionimi nga buxheti i shtetit për këto ndërmarrje u rrit ndjeshëm, duke kapur nivelin e parashikuar në strategji prej 1 miliard lekë. Nivel ky që është akorduar sistematikisht për secilin nga vitet 2017-2018,2019 dhe gjithashtu parashikohet 300.000 mijë lekë edhe në projektbuxhetin 2020, dhe 400,000 mijë lekë për 2021,-2022. Shtesa e subvencionit të këtyre ndërmarrjeve, është e lidhur ngushtë me realizimin e një sërë kriterëve/treguesve të performancës për secilën ndërmarrje, realizim ky që kushtëzon alokimin respektiv të ‘Subvencionit mbi bazë Performance’. Kështu, në zbatim të VKM Nr. 2, datë 02.04.2019 “Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen dhe përdorimin e subvencioneve shtetërore për ofruesit e shërbimeve në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve” përcaktohet se:

Detajimi i fondit të subvencionit për cdo shoqëri aksionere të ujësjellës kanalizimeve dhe përdorimi i tij do të bëhet si më poshtë:

1. Subvencioni do të shpërndahet dhe përdoret nga AKUM-i në masën e planifikuar në ligjin vjetor të buxhetit, në përputhje me zërin buxhetor:

a) Subvencione, me llogari ekonomike (603), me kod produkti 90611AB;

Subvencioni i përfituar sipas kësaj pike, do të përdoret nga AKUM-i, vetëm për shoqëritë që kanë nënshkruar kontratat e performancës, për të përballuar mbulimin e kostos direkte të operimit (KDO), diferencën = të ardhura të faturuara të sh.a. UK&ITUN – kosto direkte e operimit.

b) Reforma e ujit, me llogari ekonomike (231), me kod produkti 18BQ607, si dhe të gjitha shtesave të tjera të bëra me VKM.

Subvencioni i përfituar sipas kësaj pike, do të përdoret:

- Për të mbështetur dhe nxitur përmirësimin e performancës së sh.a. UK që operojnë në sektorin e ujësjellës kanalizimeve.

- Për të mbështetur sh.a. UK, të cilat e kanë të pamundur operimin optimal, pavarësisht përmbushjes së kriterëve të performancës.

SHËNDETËSI

- **Prioritetet 2020-2022**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në sektorin e shëndetësisë do të prioritetizojë:

- ✓ Në fushën e kujdesit parësor dhe dytësor synohet mbulimi universal i popullsisë me shërbim cilësor, diagnostikimi dhe parandalimi i sëmundjeve si dhe shtimi i gamës së medikamenteve që

trajtohen me recetë rimbursimi, reflektuar kjo në rritjen e jetëgjatësisë mesatare të grave dhe burrave në Republikën e Shqipërisë, mbi nivelet aktuale prej respektivisht 80 dhe 77 vjeç.

- ✓ 120 Qendra shëndetësore do të ri-konstruktohen për vitin 2020, me një vlerë të përlogaritur rreth 350 milionë lekë në vit. Këto qendra do të mobilohen dhe pajisen me pajisje mjekësore me një vlerë prej 64 milionë lekë për vitin 2020 dhe 30 milionë lekë për vitin 2021.
 - ✓ Rikonstruksione të godinave spitalore me një vlerë 2.4 miliardë lekë për periudhën 2020-2022.
 - ✓ Pajisje mjekësore spitalore për spitalet në vlerë rreth 660 milion lekë.
 - ✓ Shtimi i flotës së autoambulancave me 100 copë për periudhën 2020-2021, me një vlerë të përlogaritur rreth 474 milion lekë.
 - ✓ Risi në këtë fushë është mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale. Synohet që në periudhën 2020-2022, nëpërmjet këtij mekanizmi, të punësohen persona të trajtuar më parë me Ndhimë Ekonomike (NE) dhe pagesë të Aftësisë së Kufizuar.
- **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2020-2022**
 - Ofrimi i shërbimit të kontrollit bazë (check-up) për mesatarisht 475 mijë pacientë në vit;
 - Trajtimi me recetë rimbursimi i një numri më të lartë pacientësh nga 475 mijë pacientë aktualisht (2019) në 478 mijë pacientë në vitin 2022.
 - Rritja e numrit të pacientëve të trajtuar nga 290 mijë pacientë në vitin 2019 në 330 mijë pacientë në vitin 2022;
 - Rritja e numrit të pacientëve që përfitojnë nga paketat e kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë (200 pacientë më shumë çdo vit, për periudhën 2020-2022);
 - Rritje e ndjeshme e numrit seancave për pacientët që përfitojnë nga trajtimi me dializë nga 170 mijë seanca në vitin 2019, në 234 mijë në vitin 2022; (1 pacientë kryen mesatarisht 13 seanca në muaj).
 - Ulja e nivelit aktual prej 15% të pacientëve të rishtruar për të njëjtën diagnozë brenda 72 orësh, nëpërmjet urgjencës;
 - Reduktimit të kohës aktuale prej 45 ditësh të pritjes për ekzaminime të rëndësishme (rezonancë magnetike, skaner etj.);
 - Uljes nën 5.3 për 1000 lindje të gjalla të indeksit aktual të vdekshmërisë foshnjore;
 - Përmirësimi i mëtejshëm i koeficientit të shfrytëzimit të shtretërve më shumë se 49% që rezulton në vitin 2019.
 - Rritjes me më shumë se 40% të nivelit të numrit të pacientëve të vizituar për herë të parë brenda vitit nga personeli shëndetësor;
 - Rritjes me më shumë se 45% të numrit të grave mbi 35 vjeç të depistuar për kancer gjiri.

MBROJTA SOCIALE

- **Prioritetet 2020-2022**

Në fushën e mbrojtjes sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale synon zbatimin me sukses të reformës së programit të përkujdesit social në tre shtyllat kryesore të tij: Ndhimë Ekonomike, Paftësia e Kufizuar dhe Shërbimet Sociale. Më konkretisht synohet:

- Zbatimi i skemës së re të vlerësimit dhe programeve të ri-integrimit social do të sjellë reduktimin e numrit të familjeve dhe individëve në nevojë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike nga 66.5 mijë familje aktualisht në 65 mijë familje në vitin 2022.
- Numri i përfituesve nga PAK dhe kujdestarëve të tyre do të financohet nga 163 mijë në 171 mijë në vitin 2022.

- **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2020-2022**

Risi në këtë fushë është mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale. Synohet që në periudhën 2020-2022, nëpërmjet këtij mekanizmi, të punësohen persona të trajtuar më parë me Ndihmë Ekonomike (NE) dhe pagesë të Aftësisë së Kufizuar. Gjithashtu, krijimi i fondit social synon mbështetjen e njësive të vetqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve sociale territoriale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të NE me paketa sociale shëndetësore. Implementimi i reformës do të sjellë:

- Rritjen mbi 80% të numrit të përfituesve të varfër që marrin NE mbi totalin e aplikuesve.
- Rritjen me 57% të numrit të personave me aftësi të kufizuar që janë komisionuar përmes sistemit të menaxhimit të informacionit;
- Rritjen me 12% të numrit të përfituesve të grave kryefamiljare që marrin Ndihmë Ekonomike mbi totalin e aplikuesve gra kryefamiljare;
- Rritja me më shumë se 66 e numrit të grave dhe vajzave në nevojë të riintegruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesit social.

SIGURIMI SHOQËROR

❖ Prioritetet 2020-2022

Në fushën e Sigurimeve Shoqërore, për periudhën 2020-2022 synohet:

- Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme.
- Përsosja e menaxhimit të skemës së sigurimeve shoqërore, sidomos të mbledhjes së të ardhurave kontributive si dhe shpërndarjes së drejtë të tyre në formën e përfitimeve, aty dhe atëherë kur lind e drejta.
- Vazhdimi i implementimit të reformës së pensioneve dhe përmirësimi i efikasitetit të ISSH në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, suplementare dhe programore.
- Formulimi, miratimi dhe zbatimi i një skeme të re për masën e kontributit dhe ndikimit të saj në masën e pensionit mujor, për personat e vetpunësuar në bujqësi.
- Vazhdimi i implementimit të skemës së pensioneve profesionale të profesioneve shumë të vështira.
- Vazhdimi i punës për konsolidimin administrativ të ISSH, si një institucion bashkëkohor e i aftë për t'u integruar dhe për të zbatuar standartet e BE.
- Vendosija e personave të siguruar dhe e përmirësimit të shërbimit ndaj tyre, në qendër të veprimtarisë së tij. Në këtë kontekst, plotësimi i kërkesave të aplikantëve jo më vonë 30 -32 ditë nga data e aplikimit.

- Përmirësimi i infrastrukturës së shërbimeve, vazhdimi i punës për arkivimin e përqëndruar të dokumentacionit për periudhat e sigurimit, skanimin dhe dixhitalizimin e tyre si dhe fillimi e zbatimi i pjesshëm i një projekti për dixhitalizimin e të dhënave të kontributeve të paguara në periudhën 1994-2011.

Rezultatet e synuara për t'u arritur në periudhën 2020-2022:

- Rritja e nivelit të përfitimeve të pensionistëve sipas rritjes së indeksit të çmimeve të mallrave të konsumit dhe të shërbimeve, të përcaktuar në shportën e pensionistëve. Rritja është llogaritur me indeksin mesatar 2.5 % në vit, duke filluar në periudhën 01.04 i çdo viti, duke respektuar kështu edhe fondet e kontigjencës. Fondet kontigjencë sipas viteve janë; Viti 2020_2520 milionë leke; Viti 2021_2620 milionë leke; Viti 2022_3120 milionë leke.
- Mbulimi i efekteve financiare të shtesës natyrale të numrit të përfituesve e cila në harkun e tre viteve parashikohet të jetë rreth 48,000 përfitues, pra një shtesë neto me rreth 16,000 persona në vit, me një efekt financiar rreth 13 miliardë lekë.
- Mbulimi i efekteve financiare të skemave të reja të përfitimeve, naftëtarë minatorë të cilat pas rishikimit parashikohet të sjellin një efekt financiar te harmonizuar prej rreth 1.45 miliardë lekë.
- Sistemi do të vazhdojë të mbështesë me të ardhura mesatarisht nga 744-792 mijë persona që kanë përfituar dhe përfitojnë pensione publike, pensione suplementare si dhe një sërë të ardhura të tjera të parashikuara me ligje si dhe, vendime të veçanta si dhe vendime kompensuese të Këshillit të Ministrave.
- Numri mesatar i kontribuesve në skemën e sigurimeve shoqërore parashikohet mbi 820 mijë persona me një rritje në masën 4 % më shumë se i pritshmi i vitit 2019.
- Shkalla e mbulimit të popullsisë në moshë punë (kontribues / popullsi në moshë pune) do të jetë mbi 43%.
- Pjesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore ndaj totalit të fondeve të alokuara për skemat e sigurimeve shoqërore do të arrijë të mbulojë mesatarisht rreth 65.8 % të totalit;

Sistemi i Sigurimeve Shoqërore

Sistemi i sigurimeve shoqërore është fokusuar dhe synon:

- ✓ përmirësimin e vazhdueshëm të skemave aktuale, nëpërmjet forcimit të shtyllës publike të pensioneve e forcimit të një lidhje më të drejtpërdrejtë midis kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ardhshme,
- ✓ futjen graduale të skemave të përfitimeve suplementare të menaxhuar nga subjekte jo publike,
- ✓ zhvillimin e forcimit të skemave të sigurimeve suplementare profesionale dhe vullnetare,
- ✓ rritjen e efikasitetit dhe përmbushjes së funksioneve të ISSH-së nëpërmjet shtimit të kapaciteteve drejtuese, informatizimit të sistemit në përgjithësi të proceseve të punës dhe të informacionit arkivor,
- ✓ përmirësimin e shërbimit proklient.

Realizimi i objektivave të sipërcituar bëhet përmes menaxhimit me efikasitet dhe efektivitet të tre skemave:

✓ **Skema e Sigurimit të Detyrueshëm:**

Mbulon me fonde transfertat për individët nga pensionet publike, rastet e paafetësisë së përkohshme në punë, rastet e barrëlindjeve, rastet e aksidenteve në punë, në momentin e lindjes së të drejtës dhe nevojës për to. Gjithashtu, mbulon mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarve vullnetarisht, administrimi i kontributeve dhe i transfertave me destinacion nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e ISSH, si dhe administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me të drejtat e fituara të kontribuesve në skemën e sigurimit shoqëror të detyrueshëm.

✓ **Skema e Sigurimit Suplementar**

Mbulon transfertat fondeve shtetërore për individët që kanë kryer funksione kushtetuese, ish ushtarakët dhe policisë së rendit, si dhe mbështetje për ata individë që kanë statusin e profesorit, naftëtarit, metalurgut, si dhe punonjësve që kanë punuar në miniera.

✓ **Skema Kompensuese të shtetit dhe trajtimeve të veçanta**

Mbulon transfertat fondeve shtetërore në buxhetet individuale të pensionistëve dhe personave të tjerë rezidentë që përfitojnë nga programe kompensuese shtetërore ose trajtime të veçanta financiare si personat nën statusin "Dëshmor i Atdheut", punonjësit e ndërmarrjeve ushtarake, për pilotët fluturues në pension, etj.

Buxheti i ISSH-metodologjia e përgatitjes

Llogaritjet për përgatitjen e buxhetit të ISSH-së bëhen duke përdorur modelin aktuarial afatmesëm, i cili kalon nëpër të gjitha hapat e kryerjes së një parashikimi. Kjo konsiston në:

- ✓ mbledhjen dhe analizën e të dhënave;
- ✓ hartimin e bashkësisë së supozimeve për periudhën që parashikohet;
- ✓ plotësimin e të dhënave në periudhën bazë dhe supozimet në periudhën e parashikimit;
- ✓ ekzekutimin e modelit dhe kryerjen e parashikimeve;
- ✓ marrjen e rezultateve dhe analizën e tyre.

Për periudhën 2019-2022 buxheti i parashikuar për ISSH në terma të ardhurash dhe shpenzimesh paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	2019	2020	2021	2022
Te ardhura	84,342	88,609	93,538	99,210
Nga kontrib. e personave juridike e fizike	81,332	85,569	90,468	96,110
Nga kontrib. e fermerëve dhe vullnetare	3010	3040	3070	3100
Shpenzimet	133,087	139,988	145,585	154,585
Shpenzime për përfitime dhe admin.	130,637	137,468	142,965	151,465
Kontigjence per politika pensionesh	2,450	2,520	2,620	3,120
Financime nga buxheti	48,745	51,379	52,047	55,375
Financime pa politikat e pensioneve	46,295	48,859	49,427	52,255

Raporti të ardhura nga kontributet me transfertën nga Buxheti i shtetit rezultojnë rezultatet respektisht për periudhën 2020: **1.8**, 2021: **1.8** dhe 2022: **1.8**.

Buxheti i ISSH në terma përfituesish për periudhën 2019-2022 rezultojnë sipas tabelës më poshtë:

Emërtimi	Plan vjetor		Programim vjetor		
	2019	2020	2021	2022	
Numri i Perfituesve					
1	Sigurimi Shoqëror i Detyrueshem	660,667	670,961	688,257	705,355
1	për paaftësi të përkohshme	2,076	2,286	2,420	2,559
2	barrë lindje	18,356	16,726	17,241	17,738
3	pensione	639,817	651,524	668,161	684,611
	nga keto pens pelqerie	515,984	534,661	548,221	561,013
4	aksidente e sëmundje profesionale	61	60	64	68
5	per mbledhjen e kontributeve per fermeret dhe vullnetare	357	364	371	379
2	Sigurime suplementare	56,742	59,722	61,021	62,368
1	sigurimi shtetëror suplementar	3,051	3,471	3,748	4,048
2	sigurimi suplementar ushtarake dhe i policisë së shtetit	27,776	29,842	30,140	30,442
3	statusi i profesorit	921	990	1,059	1,133
4	statusi i naftetarit	7,631	7,784	7,939	8,098
5	statusi i metalugut	3,000	3,060	3,121	3,184
6	trajtimi i vecantë i punonjësve të nëntokës	14,365	14,576	15,013	15,463
3	Programe kompensuese te shtetit dhe trajtime te vecanta	547,588	573,337	576,143	578,609
1	kompensime çmimesh	520,345	549,256	551,919	554,197
2	pensione të posaçme shtetërore	274	276	279	282
3	shpërblime për pensione për veteranët	3,050	2,844	2,702	2,567
4	shpërblime për invalidët e punës	522	1,050	1,060	1,071
5	kompensime per te ardhurat e pensionisteve	337,907	343,098	333,430	324,109
6	pensioni social	2,884	2,982	3,101	3,256
7	statusi "Dëshmor i Atdheut"	345	346	342	339
8	trajtimi i vecantë i pilotëve fluturues në pension	233	231	230	229
9	trajtimi i vecantë i punonjësve të industrisë ushtarake	455	362	359	355
10	ushtarakët e nëndetesëve në pension	61	58	58	58
11	shpenzimi varrimi	19,419	15,932	16,093	16,255

ARSIMI, SPORTI DHE RINIA

• **Prioritetet 2020-2022**

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve do të vijojë masat e saj të integruara për mbështetjen e arsimit bazë, të mesëm, dhe të lartë, orientimin e kurrikulave ndaj nevojave të tregut të punës dhe modernizimin e tyre, si edhe mbështetjen për trajnim dhe punësim të kategorive të veçanta. Për periudhën 2020-2022, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të financojë me prioritet:

- Transportin e 28-30 mijë nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e 9-12 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë;
 - Blerjen e teksteve shkollore për rreth 230-250 mijë nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë;
 - Për 1300-1400 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë do të garantohet trajtimi me kuotë ushqimore;
 - Mbështetje e vazhdueshme për studentët, përmes mbulimit të shpenzimeve për bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë, krijimit të kushteve të përshtatshme të akomodimit në tetë “Shoqëritë e Trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në Rrethe” për rreth 8-10 mijë studentë, mbështetjes me bursa të rreth 100-120 studentë të rinj ekselentë që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “Times Higher Education”.
 - Fonde për të mbuluar shpenzimet për rishikimin e kurrikulës dhe hartimin e programeve të arsimit para-universitar për veprimtarinë e Institutit të Zhvillimit të Arsimit me 20 -25 milion lekë në vit.
 - Fonde për të mbuluar shpenzimet për veprimtarinë e Maturës Shtetërore, provimet e shtetit, si dhe testime kombëtare e ndërkombëtare me 25 milion lekë në vit.
 - Në arsimin parauniversitar do të financojë me prioritet projekte për ndërtime të reja, rikonstruksion/rindërtimin apo shtesa në objektet aktuale për më shumë se 180-200 objekte arsimore të tjera ose rreth 1800-2000 klasa / laboratorë mësimore nga të cilat do të përfitojnë 38000- 40,000 nxënës dhe 3200-3500 mësues dhe edukatorë.
 - Edukimi nëpërmjet sportit si një faktor efikas në përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për qytetarët përmes sigurimit të një shërbimi cilësor nëpërmjet sportit elitare dhe sportit në tërësi në institucionet arsimore duke kontribuar kështu dhe në forcimin e statusit të të rinjve shqiptarë në të gjitha fushat e jetës.
- **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2020-2022**

Për arsimin parauniversitar për periudhën 2020-2022 synohet si më poshtë :

- Të sigurohet rritja e aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor 86%, ndjekja e arsimit bazë (nga 100% e moshës 6-16), si dhe përfshirja me përparësi e grupeve vulnerabël. Rritja e treguesit të regjistrimit me 10-15% ose 350-500 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 10% për nxënësit me aftësi të kufizuar. Reformimi i arsimit parashkollor dhe bazë, përmes miratimit të kornizës së re

kurrikulare dhe programeve për çdo grupmoshe për arsimin parashkollor, bazë, trajnimit të përvitshëm të mësuesve/ edukatorëve dhe punonjësve të shërbimit psikosocial (150 psikologë dhe 150 punonjës social) dhe pajisjes me materiale didaktike të kopshteve dhe shkollave.

- Zbatimi/implementimi i kurrikulës së re klasa 1-5 dhe klasa 6-9, përgatitja e 25 programeve kualifikues, 12 module trajnimi, 40 teste trajnuese për kurrikulën e re. Trajnimi i 12.000 mësuesve të klasa 4 dhe klasës 9 (trajnimi 25% të mësuesve të AB) për kurrikulen e re, përfshirë edhe 40 mësues të pakicave kombëtare, si dhe 200 mësues ndihmës për fëmijët me AK. Trajnimi i 80 mësuesve të diasporës në seminarin mbarëkombëtar për mësuesit e diasporës.
- Zhvillimi i reformës së teksteve shkollore, përmirësimi i cilësisë së teksteve shkollore si dhe kompensimi i çmimit të teksteve shkollore nga klasa I-IX, në masën 100 % fëmijëve që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie, fëmijëve që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijëve që gëzojnë statusin e të verbrit, fëmijëve të pakicave kombëtare, për nxënësit romë, egjiptianë, fëmijëve të familjeve të emigrantëve që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, fëmijët që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie; fëmijë të familjeve që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuar, fëmijë që vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura; familje në nevojë, viktimave të trafikimit, si dhe dhënia falas e teksteve shkollore të fëmijëve që ndjekin studimet në klasën parë deri në klasën pestë.
- Sigurimi i transportit të nxënësve për ndjekjen e arsimit parashkollor dhe bazë që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre si dhe mësuesve që punojnë e banojnë më shumë se rreth 5 km nga vendbanimi i tyre dhe mbulimi 100% i shpenzimeve të transportit me fonde të buxhetit.
- Numri i nxënësve që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë të arrijë në 95-97% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë, nga të cilët 65% ndjekin AM gjimnaze dhe 35% në arsimin profesional .
- Zbatimi i kurrikulës së re dhe trajnimi i mësuesve të klasës së 11 në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, si dhe zbatimi i sistemit të ri të zhvillimit profesional, të drejtuesve të IA, mësuesve dhe drejtuesve të rrjeteve profesionale.
- Realizimi i Maturës Shtetërore 2020 sipas kurrikulës së re me bazë kompetencën. Realizimi i testimit "Mësues për Shqipërinë" në formë elektronike.
- Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në arsimin e mesëm të lartë (rehabilitimi në masën 9% të klasave në gjimnaze në zonat urbane), shtimi me 5%-8% i klasave të reja në zonat urbane, pajisja me mjete didaktike për Fizikë-Kimi-Biologji për 8% në vit të shkollave të mesme, pajisja e klasave dhe shkollave me kompjuter, si dhe pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat me 10% të fondit ekzistues të bibliotekave.

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor për periudhën 2020-2022 parashikohet sa më poshtë:

- 100% të programeve studimore të akredituara brenda vitit 2030;
- Të sigurohet standardi një vend pune për dy studentë në laborator kërkimorë shkencorë, në përputhje me parimet e barazisë gjinore;
- Të sigurohet standardi 5-8 m² për student sipas natyrës së programit të studimeve në vitin 2022, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
- Fonde publike për IAL të arrijnë në 2% ndaj PBB në vitin 2022;
- 100% e të dhënave të stafit akademik, të studentëve, të karrierës akademike, diplomimit, janë në regjistrin elektronik kombëtar.

- 90% e stafëve me kohë të plotë të departamenteve të jenë me grada/tituj në 2022, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
- Rritja e mobilitetit të stafit dhe studentëve me 20% në 2020 dhe 40% në 2022 dhe 60% në vitin 2025;
- 100% e studentëve ekselente, studentë në nevojë të përfitojnë bursa e kredi studentore në 2022;
- Raporti student/pedagog të arrijë 15/1, në vitin 2025.
- Numrit të kërkuesve në deri në vitin 2021 të arrijë treguesit mesatare për kërkues në OECD;
- Të arrihet standardi 7 kërkues për çdo 1,000 të punësuar në vitin 2021;
- 40% e personelit në kërkim dhe zhvillim të jenë nga IAL publike (30% e kërkuesve shkencore të jenë femra me synim që pas vitit 2021) -;
- Rritja me 30% e financimit të projekteve kombëtare të kërkim zhvillimit që drejtohen nga kërkuese femra dhe Doktoratave të fushave prioritare të kërkimit, me synim që pas vitit 2021, të sigurohet barazi gjinore në projektet fitues ;
- Të rritet me 10%-15% në vit numri i aplikimeve nga programet bilaterale dhe Programin Horizon 2020 , si dhe programet ERASMUS +;
- Financim për punën kërkimore shkencore për 3,500- 4,000 kërkuesve në vit në IAL publike në periudhën 2019-2022;
- Synohet që fondet për kërkim ekselencë dhe inovacion në vitin 2020 të arrijnë 1% të PBB-së.

Për sportin dhe rininë për periudhën 2020-2022 parashikohet:

- Sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpikë në aktivitete, Evropiane, Botërore, Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpikë Japoni 2020, realizimi i 30 analizave antidoping për sportistëve elitari si dhe ato kandidat për Lojërat Olimpikë Japoni 2020.
- Mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik pjesëmarrës në Lojërat Olimpikë Japoni 2020 si dhe aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve në 42 Kampionate Kombëtare, 42 Kupa Shqipërisë, 42 Kampionate Evropiane, si dhe 42 Kampionate Botërore, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
- Mbështetja financiare me investime në sport, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, pajisje me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare.
- Zhvillimi i programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit, trajnime çdo vit për 20-25% e stafet teknike të sistemit sportiv kombëtar (732 teknike - trainerë, specialistë, instruktorë, mjekë etj, ku përparësi kanë sportistët dhe trajnerët femra).
- Rritja e mbështetjes financiare për shpërblimin e sportistëve elitari, fitues në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për 20-25 sportistë elitari në vit, si dhe mbështetje financiare për aktivitete sportive promovuese dhe garuese në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe universitar.
- Të përmirësojmë cilësinë e jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre, në punësim, në informim, në edukim dhe në vendimmarrje.
- Mbështetja financiare me investime për ristrukturimin/ ndërtimin dhe pajisjen e objekteve për rininë, në funksion të përmirësimit të kushteve për argëtim.

ARSIMI PROFESIONAL DHE PUNËSIMI

Prioritetet gjatë periudhës 2020-2022 që synohen në fushën e arsimit profesional dhe punësimit janë:

- Rritjen e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 46% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2022, krahasuar me 42% në vitin 2019;
- Rritjen e numrit të të diplomuarve në shkollat e mesme profesionale, nga 3.300 nxënës në 2019, në 3.600 nxënës në vitin 2022;
- Rritjen e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 40% e totalit në vitin 2019 në 55% e totalit në vitin 2022;
- Rritjen e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale nga 90 nxënës në vitin 2019 në 120 nxënës në vitin 2022.
- Rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, në 20.1% të totalit të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar në vitin 2022, krahasuar me 19.5% në vitin 2019;

TURIZMI DHE MJEDISI

Prioritetet për periudhën 2020-2022:

Në fushën e Turizmit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për qëllim kthimin e Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potenciale dhe burime lokale, duke u fokusuar në atë çka është unike në vendin tonë. Ndërsa për fushën e Mjedisit, synohet sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Prioritetet për periudhën 2020-2022:

- ✓ Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjeter;
- ✓ Arritja e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit në vitin 2022 sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit;
- ✓ Përmirësimi i performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve;
- ✓ Reduktimi i ndotjes nga shkarkimet industriale për lejet e tipit A dhe B dhe i rreziqeve nga aksidentet industriale sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- ✓ Forcimi i mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit dhe forcimi i menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve ujore;
- ✓ Përmirësimi i menaxhimit efektiv dhe sigurimi i vazhdueshëm i mbrojtjes dhe administrimit të zonave të mbrojtura.

KULTURA

Prioritetet 2020-2022:

Në fushat e kulturës dhe trashëgimisë kulturore do të prioritetizohet:

- Programi Kombëtar “Edukimi përmes Artit” do të jetë vijimi i një reforme të thellë dhe të qëndrueshme në institucionet e artit dhe politikat kulturore duke vënë theksin në rëndësinë dhe rolin e edukimit përmes kulturës në kohezionin social, i provuar tashmë në vende të tjera.

- Përmirësimi i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në të gjithë vendin, përmirësimi i infrastrukturës në Muzetë Kombëtarë, Parqe Arkeologjike si dhe përmirësimin i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në të gjithë vendin.
- Edukimi përmes librit dhe veprimtarive bibliotekare, pasurimi i fondit bibliotekar në të gjithë rrjetin e bibliotekave në mbarë vendin, me qëllim rritjen dhe edukimin e lexuesit.
- Rritja e aksesit të publikut në Muze, Monumentet e kulturës, ansambleve arkitektonike, qyteteve muze, qendra historike, zonave dhe parqeve arkeologjike në funksion të turizmit kulturor.
- Realizimi i një rrjet aktivitetesh që synojnë të forcojnë dhe konsolidojnë vlerat artistike dhe zhvillimit të diplomacisë kulturore në nivele të larta ndërkombëtare, nëpërmejt promovimit e Artit Shqiptar në Arenën Ndërkombëtare (Creative Europe, Traduki, Kalendari Shqipëri-Kosove, Kalendarin artistik me Maqedoninë, Bienalja e Venecias e Artit, Panairot Ndërkombëtare të Librit, etj).
- Realizimi i një kalendar aktivitetesh të dedikuara Turizmit Kulturor dhe veçanërisht vijës Bregdetare, për të ofruar dhe mundësuar një paketë të plotë vlerash dhe traditash.
- Mbështetja e arteve pamore përmes organizimit të ekspozitave kombëtare dhe ndërkombëtare të arteve pamore; kinematografisë;

✓ **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2020-2022**

Për Trashëgiminë kulturore

- Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit, duke përfshirë restaurimin e disa linjave muzeale, si edhe përshtatjen me standarde bashkëkohore. Rritja e numrit të objekteve të trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit të restauruara dhe mirëmbajtura nga 140 në vitin 2019 në 150 në vitin 2022.
- Rritja e aksesit të publikut në Muze, Monumentet e kulturës dhe Parqe Arkeologjike në funksion të turizmit kulturor (nr. Vizitore) me 10% në vit, nga 1.05 milion vizitorë në vitin 2019 në 1.29 milion turistë në 2022;
- Rritja e numrit të nxënësve të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të përfshirë në aktivitete të fushës së trashëgimisë kulturore, nga 14 mijë nxënës në vitin 2019 në 14,5 mijë nxënës në 2020 dhe 15 mijë –15.5 mijë përkatësisht në vitet 2021 – 2022;
- Mbështetja e aktiviteteve të fushës së trashëgimisë kulturore organizuar nga organizata jopublike (projekte me thirrje) nga 70 aktivitete që mbështetën aktualisht në 85 aktivitete në vitin 2022.
- Vijimi i mbështetjes financiare për projektet në fushën e artizanatit, kulinarisë dhe dukurive të tjera të trashëgimisë jomateriale, veçanërisht për gratë artizane (35% ndaj totalit të përfituesve)

Për Artin dhe Kulturën

- Rritja e aksesit në kulturë, e cila parashikon një rritje të vazhdueshme të numrit dhe cilësisë së aktiviteteve në të gjitha zhanret. Rrjet aktivitetesh që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike, promovimin e Artit Shqiptar në arenën ndërkombëtare, mbështetja e aktiviteteve kulturore në mbarë vendin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e artit dhe kulturës librit dhe përkthimit.
- Prioritet do të jetë integrimi, angazhimi dhe promovimi i të rinjve më të evidentuar të kësaj fushe.
- Nxitja e konkurrencës artistike përmes audicioneve dhe konkurrimit publik krahasuar me një vit më parë

- Mbështetja e skenës së pavarur për të mundësuar edukimin përmes kulturës si dhe përfaqësimin e produktit artistik në arenën elitare ndërkombëtare.
- Në vitin 2020 parashikohet të fillojë implementimi i projektit “Rijetësimi i Piramidës në Tiranë”, një bashkëfinancim i buxhetit të shtetit me Bashkinë Tiranë, për rivitalizimin e kësaj ndërtese në një Qëndër të edukimit për teknologjinë.
- Rritja e numrit të projekteve me thirrje në mbështetje e industrive krijuese duke respektuar barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, grupet e marginalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi nga 80 në vitin 2019 në 100 në vitin 2022.

DREJTËSIA

- **Prioritetet 2020-2022:**

Ministria e Drejtësisë për periudhën 2020-2022 do të prioritetizojë:

- Jetësimin e Reformës në Drejtësi;
- Jetësimin e reformës në Drejtësi për të miturit;
- Forcimi i Luftës kundër Korrupsionit në Administratë;
- Legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve dhe zonave informale. Rregullimi i çështjes së pronave në zbatim të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” dhe akteve nënligjore;
- Garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të personave me liri të kufizuar në sistemin e burgjeve dhe siguron ri-integrimin e tyre në shoqëri;
- Rritja e performancës së Shërbimit të Provës në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe standardeve më të larta në fushën e masave alternative për realizimin e programeve sa më efikase në realizimin e rehabilitimit të të dënuarve me masa alternative.

✓ **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2020-2022**

Për Sistemin e Burgjeve synohet:

- Norma e recidivitetit (burra) të ketë një trend konstant 18% ndër vite;
- Norma e recidivitetit (gra) të ketë një trend rënës nga 1% që është aktualisht;
- Të dënuar që punësohen pasi fitojnë lirinë të rritet nga 10% e totalit që është aktualisht.

Për Shërbimin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave synohet:

- Ndarja e fondit të vënë në dispozicion kundrejt subjekteve që kanë përfituar të drejtën e kompensimit duke bërë që të rritet numri subjekteve të kompensuara nga viti në vit.

REFORMA NË DREJTËSI, ARRITJET 2019 DHE SYNIMET 2020-2022

Sistemi i drejtësisë në Shqipëri i është nënshtruar një sërë reformash të thella, në funksion të përmbushjes së standardeve evropiane në këtë sistem. Përmes miratimit të Ligjit nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417/1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, Shqipëria filloi zbatimin e reformës në drejtësi.

Synimet e Reformës në Drejtësi ne periudhën afatgjatë janë:

- ✓ Të forcoje llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe të luftojë korrupsionin brenda sistemit të drejtësisë;
- ✓ Të demonstrojë progres të mëtejshëm me synim krijimin e precedentëve solidë të hetimeve, ndjekjes penale dhe dënimeve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet;
- ✓ Të përmirësojë mekanizmat institucionale për të nxitur përpjekjet për ta sjellë legjislacionin ekzistues për drejtësinë për të mitur në përputhje me standarde ndërkombëtare;

ARRITJE 2019 DHE OBJEKTIVAT 2020-2022

Një paketë ligjesh është miratuar, duke mbuluar të gjitha aspektet e reformës gjyqësore, ku Kuvendi ka miratuar 22 ligje, si dhe një vendim, duke përmbyllur kështu paketën e ligjeve të reformës në sistemin e drejtësisë. Konkretisht, gjatë vitit 2019 janë miratuar aktet e mëposhtme:

Në muajin dhjetor 2018, Kuvendi miratoi Ligjin nr. 110/2018 "*Për Noterinë*"⁴. Ligji përcakton rregullat për ushtrimin e profesionit të noterit, si dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimit të noterisë në Republikën e Shqipërisë. Për më tepër, ligji përcakton dhe procedurat për provimin e pranimit në formimin fillestar, krijimin e pozicionit të zëvendësnoterit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së zëvendësnoterëve, mbikqyrjen dhe përgjegjësinë disiplinore, kompetencat, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat, financimin e veprimtarisë noteriale, organizimin dhe funksionimin e Dhomës Kombëtare të Noterisë etj.

Në muajin prill 2019, Kuvendi miratoi Vendimin Nr. 47/2019, datë 18.04.2019 "*Për miratimin e Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut 2019 – 2023*". Strategjia për edukimin ligjor të publikut (SELP) përcakton vizionin, objektivat strategjike dhe specifike të edukimit ligjor të publikut (ELP) përgjatë periudhës 2019-2023. SELP është dokumenti i parë strategjik i miratuar në Shqipëri me fokus të veçantë edukimin ligjor të qytetarëve. Vizioni i ELP për vitet e ardhshme është: *Qytetarë më të ndërgjegjësuar për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, bazuar në nevojat specifike dhe nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.*

Në muajin prill 2019, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 25/2019 "*Për organizimin dhe Funksionimin e Policisë Gjyqësore*". Ky ligj përcakton rregullat dhe parimet e përgjithshme në lidhje me: a) organizimin dhe funksionimin e shërbimeve dhe seksioneve të Policisë Gjyqësore; b) veprimtarinë e tyre hetimore; c) statusin e oficerëve të Policisë Gjyqësore; ç) raportet me prokurorinë dhe me institucionet shtetërore ku bëjnë pjesë.

Në muajin maj 2019, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 26/2019 "*Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat*"⁵. Ky ligj ka si objekt përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe të funksionimit të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Privat, kushtet që duhet të përmbushin individët për të ushtruar detyrën e përmbartuesit gjyqësor privat, statusin, masat disiplinore, detyrat, përgjegjësitë, rregullat e caktimit të tarifave, si dhe marrëdhëniet me institucionet shtetërore dhe me subjektet e tjera publike dhe private.

Janë ngritur dhe po funksionojnë 3 institucione të reja të sistemit të drejtësisë:

4 Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 16, dt. 13 shkurt 2019. Më datë 07.02.2019, me Vendimin Nr. 29/2019 është rrëzuar Dekreti Nr. 11 054, Datë 14.1.2019, të Presidentit të Republikës, "Për Kthimin e ligjit Nr. 110/2018 'Për Noterinë'".

5 Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 99, dt. 10 korrik 2019. Më datë 04.07.2019, me Vendimin Nr. 74/2019 është rrëzuar Dekreti Nr. 11 195, Datë 31.05.2019, të Presidentit të Republikës, "Për kthimin e ligjit Nr. 26/2019 'Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat'".

- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
- Kolegji i Posaçëm të Apelimit;
- Komisioneri Publikë;

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit deri më datë 30 shtator 2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka dhënë **194 vendime**, nga të cilat:

- ✓ 83 vendime për konfirmimin në detyrë të 34 gjyqtarëve, 40 prokurorëve dhe 9 ndihmësve ligjorë;
- ✓ 71 vendime për shkarkimin nga detyra të 42 gjyqtarëve dhe 27 prokurorëve dhe 2 ndihmësve ligjorë /kandidatë për magistratë;
- ✓ 15 vendime për ndërprerjen e procesit për 10 gjyqtarë, 4 prokurorë dhe 1 këshilltar ligjor në Gjykatën Kushtetuese; (neni G i Aneksit të Kushtetutës);
- ✓ 8 vendime për pushimin e procesit për 3 gjyqtarë, 1 prokuror dhe 4 ndihmësve ligjorë të Gjykatës së Lartë (neni 56 i ligjit nr. 84/2016);
- ✓ 16 vendime për përfundimin e procesit për 10 gjyqtarë, 5 prokurorë dhe 1 (Kryeinspektorin) e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. (neni 95 i Kodi i Procedurave Administrative dhe neni 64 i ligjit nr. 96/2016);
- ✓ 1 vendim për pezullimin nga detyra të një prokurori.

Në Kolegjin e Posaçëm i Apelimit deri më **30 shtator 2019**, janë regjistruar 86 çështje (40 në vitin 2018 dhe 46 deri në shtator 2019) dhe janë shpallur 35 vendime të Juridiksionit të Rivlerësimit (12 në vitin 2018 dhe 23 vendime deri në shtator 2019). Nga 35 çështjet të cilat kanë përfunduar, Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka vendosur:

- Lënien në fuqi të Vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit - **në 23 vendime (8 janë të vitit 2018)**;
- Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me përmbajtjen në dispozitiv për, ndalimin e subjekteve të rivlerësimit të emërohen gjyqtarë apo prokurorë të çdo niveli, anëtar i KLGJ ose KLP, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm për një periudhë 15-vjeçare - **në 3 vendime (2 janë të vitit 2018)**;
- Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit - **në 7 vendime (1 vendim është i vitit 2018)**
- Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra - **në 1 vendim**
- Pushimin e shqyrtimit të çështjes për shkak të tërheqjes së ankimit nga ankuesi - **në 1 vendim (i përket vitit 2018)**.

Institucioni i Komisionerëve Publikë, për periudhën janar - shtator 2019, është njoftuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) për **103 vendime**. 8 prej tyre janë ankimuar dhe për 93 vendime është vendosur mosankim⁶. Në proces shqyrtimi ishin 6 vendime të KPK-së.

Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë përmban *tetë objektiva strategjike të nivelit të lartë*, të cilat janë:

1. Forcimi i pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies së institucioneve të sistemit të drejtësisë.
2. Konsolidimi i arsimit ligjor dhe trajnimit, si dhe specializimi i magistratëve dhe personelit të gjykatave.
3. Përmirësimi i operimit të sistemit gjyqësor duke forcuar efikasitetin, transparencën dhe qasjen e tij në përputhje me standardet evropiane.
4. Rritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor penal dhe masave antikorrupsion përmes konsolidimit të misionit, statusit dhe funksioneve të institucioneve të drejtësisë penale.
5. Përmirësimi i funksionimit të sistemit të drejtësisë duke siguruar sisteme moderne elektronike dhe lehtësira për zhvillimin e bashkëpunimit të fuqishëm ndërkombëtar.
6. Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimit.
7. Përmirësimi i funksionimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe institucioneve të saj të varësisë.
8. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit të profesioneve ligjore dhe vendosja e një kuadri ligjor për arbitrazhin.

⁶ Në rubrikën mosankim janë përfshirë 4 vendimet e KPK-së, të njoftuara në fund dhjetori 2018, për të cilat vendimarrja është realizuar në Janar 2019.

POLITIKA E JASHTME

• Prioritetet 2020-2022:

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen nga aktiviteti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për vitin 2020-2022 janë:

- Hapja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian;
- Zhvillim i mëtejshëm i tërësisë së marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partnerët strategjike, vendet mike dhe aleate si dhe vendet fqinjë;
- Vazhdimi i angazhimit për njohjen e mëtejshme ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin i saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare;
- Funksionalizimi dhe mbështetja e punës së dy nismave rajonale me seli në Tiranë: Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor si dhe në tërësi sigurimi i pjesëmarrjes aktive në bashkëpunimin shumëpalësh rajonal, përfshirë RCC;
- Kryesimi i disa nismave rajonale dhe organizatave ndërkombëtare;
- Pjesëmarrje aktive dhe realizimi i kontributit të RSH në kuadër të NATO-s;
- Zbatimi i detyrimeve të anëtarësimit në organizata dhe forume shumëpalëshe, ku jemi palë;
- Plotësim i bazës ligjore të bashkëpunimit me vende të tjera;
- Forcimi dhe rritja e rolit të diplomacisë publike, ekonomike dhe diasporës, në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë, promovimit dhe potencialeve për investime, tregti dhe bashkëpunimit ekonomik, tregtar dhe kulturor me partnerët tanë ndërkombëtarë dy dhe shumëpalësh;
- Realizim i një shërbimi konsullor të mbështetur në profesionalizëm, efikasitet, transparencë dhe përgjegjshmëri;
- Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit të MEPJ dhe përfaqësive për procesin e negociatave.

MBROJTJA

• Prioritetet 2020-2022:

Ministria e Mbrojtjes synon të përmbushë reformat e nisura dhe realizimin e detyrave kushtetuese të Forcave të Armatosura (FA), angazhimeve ndërkombëtare në kuadër të NATO-s, angazhimeve të FA në kuadër rajonal dhe në aftësitë trajnuese të vetë FA. Më konkretisht, Ministria e Mbrojtjes synon:

- Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA duke:
 - zhvilluar kapacitetet e FA në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit;
 - vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO;
 - zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake;
 - modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike.
- Vijimin e pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s duke rritur nivelin e angazhimit të FA, në operacionet e Aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë.
- Zhvillimin dhe mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve të FA për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e

Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-se dhe BE-së.

- Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura.

RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE

• Prioritetet 2020-2022:

Ministria e Brendshme synon mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe garantimin e sigurisë së jetës, shëndetit dhe pronës së qytetarit, të cilat janë dhe prioritetet për veprimtarinë e Policisë së Shtetit, e cila do të ketë si togfjalësh kyç në veprimtarinë e saj, 'kontrollin e territorit' dhe 'policimin në komunitet', të realizuara në praktikë përmes riorganizimit të sistemit të prezencës së policisë në territor, në funksion të një kontrolli më efektiv të tij dhe transformimin rrënjësor të marrëdhënieve dhe shërbimit ndaj komunitetit. Gjithashtu, synon sigurimin e rendit publik, pronës publike e private, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore, krijimin e një mjedisi të sigurt për komunitetin, nëpërmjet shërbimeve profesionale, në kohë dhe me cilësi dhe policimit me standardet me të larta të performancës.

Ministria e Brendshme synon të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj, të Objekteve të Rëndësishme të Veçantë nëpërmjet rritjes së kapaciteteve menaxhuese dhe përputhjes me standartet europiane në fushën e sigurisë. Gjithashtu, Ministria e Brendshme synon konsolidimin e mëtejshëm të një sistemi bashkëkohor të dixhitalizuar të regjistrimit kombëtar të gjendjes civile (RKGJC), të sistemit të regjistrimit kombëtar të adresave (RKA) dhe sistemit të personalizimit dhe shpërndarjes së letërnjoftimit elektronik dhe pasaportës biometrike.

✓ Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2020-2022

Përgjatë 3 viteve të PBA 2020-2022, Ministria e Brendshme do të përmbushë objektivat e saj përmes:

- Rritjes së numrit të hetimeve proaktive në luftën kundër krimit të organizuar, trafikeve, korrupsionit dhe terrorizmit;
- Përmirësimit rrënjësisht të sistemit të kontrollit rrugor, duke synuar krijimin e një kulture të re në qarkullimin e mjeteve dhe të qytetarëve dhe sidomos në menaxhimin e sigurisë rrugore. Synohet ulja e numrit të aksidenteve në rrugë në masën 1% çdo vit nga 1 936 raste në vitin 2019;
- Rritjes së nivelit të sigurisë publike duke forcuar kontrollin e territorit dhe policimin në komunitet përmes rritjes së numrit të shërbimeve të patrullimit si dhe reduktimit të kohës së reagimit të shërbimeve policore (nga 20 minuta në vitin 2019 në 13 minuta në vitin 2022).
- Reduktimit të trafikeve, krimit ndërkuftar dhe rasteve të imigrimit të paligjshëm kryesisht nëpërmjet reduktimit të kohës së procedimit (nga 26 minuta në vitin 2019 në 15 minuta në vitin 2022).
- Reduktimit të kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje (18 minuta në vitin 2019 në 14 minuta në vitin 2022).
- Të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të Sigurisë së Personaliteteve Vendas dhe të Huaj në përputhje me standartet europiane (nga 33% në vitin 2019 në 45% në vitin 2022).
- Përdorimit në mënyrë efektive të përditësimit të ngjarjeve në regjistrin civil, në autorizimin dhe çertifikimin e aplikimeve për lëshimin e dokumenteve të identitetit. Synohet reduktimi i kohës për trajtimin e kërkesës nga sistemi i RKGJ-së (nga 1.5 orë në vitin 2019 në jo më shumë se 0.5 orë në vitin 2022).

5. BUXHETI VENDOR 2020

Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore, ka qënë dhe mbetet një angazhim i vazhdueshëm i qeverisë e cila ka miratuar dhe po zbaton një program ambicioz decentralizimi.

Thellimi i decentralizimit fiskal, rritja e autonomisë financiare dhe konsolidimi i financave vendore janë ndër objektivat kryesore të qeverisë në drejtim të përdorimit me efektivitet të fondeve publike në nivel vendor dhe përmirësimit të standarteve të shërbimeve që i ofrohen komunitetit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Viti 2020, do të jetë viti i zbatimit të plotë të të gjithë instrumenteve të reja financiare të parashikuara në ligjin për financat e vetëqeverisjes vendore (68/2017), me synimin e konsolidimit të burimeve të financimit, për të garantuar një menaxhim më cilësor të shpenzimeve vendore.

Mbështetja që ka dhënë qeveria për njësitë e vetëqeverisjes vendore nëpërmjet reformave të ndërmarra, por edhe rritja e konsiderueshme e nivelit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore ka bërë të mundur që pesha e buxhetit vendor të rritet nga 2.5% e PBB-së në vitin 2013 në 3.2% të PBB-së në vitin 2020, duke e vendosur Shqipërinë më afër vendeve të rajonit.

Me zbatimin e legjislacionit të ri për financat e vetëqeverisjes vendore është rritur autonomia fiskale e bashkive, ku:

- Të ardhurat e bashkive nga transfertat e pakushtëzuar janë rritur nga 12.2 miliard lekë në vitin 2013 në 17.6 miliard në vitin 2019 dhe në vitin 2020 do të jenë 18 miliardë lekë;
- Lidhja e transfertës me 1% të PBB-së, garanton stabilitet, parashikueshmëri dhe rritje me rritjen e ekonomisë;
- Të ardhurat e bashkive nga taksat e ndara, gjithashtu do të rriten me rreth 700 milion lekë për vitin 2020 dhe vitet në vijim;
- Gjithashtu, reforma në taksën mbi pasurinë e paluajtshme dhe ngritja e kadastrës fiskale do të rrisin më tej të ardhurat për buxhetet vendore.

Buxheti i pushtetit vendor për vitin 2020, do të jetë rreth **11.2 përqind** më i lartë se ai i 2019-ës ose **5.7 miliardë lekë** më shumë fonde për shërbime dhe investime publike. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme e buxhetit të shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore do të jetë 1 përqind e PBB-së ose **400 milionë lekë** më e madhe se sa ajo e vitit 2019 dhe **rreth 46 përqind** më e lartë se transfertat e vitit 2015. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore në vitin 2020 do të jenë **26.9 miliardë lekë** ose **18.2 përqind** më të larta se në vitin 2019. Buxheti për vitin 2020 do të jetë rreth 3.2 përqind e PBB-së, dhe krahasuar me vitin 2015 rezulton me një rritje të ndjeshme me rreth 62 përqind.

Rritja e burimeve të buxhetit vendor në vitin 2020, krijon më shumë hapësira për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për qytetaret (për funksionet ekzistuese dhe ato të reja të tranferuara me reformën administrativo territoriale) dhe njëkohësisht për uljen e stokut të detyrimeve të prapambetura të trashëguara nga ndarja e vjetër administrativo territoriale.

Fokusi kryesor në buxhetin vendor të vitit 2020, për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë do të jetë konsolidimi i procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor në funksion të vazhdimit të zbatimit të

reformës administrative territoriale dhe decentralizimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore nëpërmjet:

- Forcimit të disiplinës financiare në nivel vendor, nëpërmjet vendosjes së parimeve, rregullave, proceseve dhe procedurave për hartimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, duke synuar parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura (të papaguara).
- Planifikim dhe buxhetim eficient dhe i mirë-integruar i shpenzimeve publike në nivel vendor me synim rritjen e efektivitetit dhe përdorimit me ekonomi të fondeve publike.
- Përmirësimi i raporteve të monitorimit, duke u fokusuar tek standartizimi i formateve raportuese, përdorimi i treguesve të performancës për çdo program buxhetor si dhe përmirësimi i aftësive monitoruese dhe të raportimit për të identifikuar në kohë probleme potenciale gjatë zbatimit të buxhetit.
- Përmirësimi i metodologjisë për analizën, ndjekjen dhe monitorimin e performancës buxhetore të njësive të vetëqeverisjes vendore. Nëpërmjet kësaj metodologjie do të synohet që përmes treguesve të performancës të matet efektiviteti i përdorimit të fondeve publike në nivel vendor.
- Forcimi i planifikimit strategjik dhe procesit të menaxhimit të buxhetit vendor.
- Menaxhimi efektiv i të ardhurave vendore si një mënyrë e rëndësishme për të rritur investimet dhe rialokimin e fondeve në interesin publik;
- Përcaktimi i rregullave për menaxhimin e situatave të vështirësive financiare si një formë e rëndësishme e vlerësimit të njësive të vetëqeverisjes vendore; Implementimi i një metodologjie të mirëstrukturuar në lidhje me evidentimin e rasteve të vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.
- Përmirësimi i raportimit dhe analizave për financat vendore si nga vetë njësitë në nivel vendor por gjithashtu edhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
- Rritja e parashikueshmërisë, efektivitetit dhe transparencës së transfertave ndërqeveritare si një formë e rëndësishme e konsolidimit fiskal;

Gjithashtu, përmes buxhetit të vitit 2020, do të vazhdojë mbështetja financiare për reformën në arsimin parashkollor me synim vendosjen e një skeme financimi të përshtatshme dhe efektive që synon përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Në buxhetin e vitit 2020, fondet e pagave për edukatorët do të ndahen kryesisht mbi bazën e numrit të fëmijëve. Më specifikisht, 60% e fondeve për pagat e edukatoreve do të ndahen mbi bazën e numrit të fëmijëve (me moshë 3-6 vjeç) dhe 40% mbi bazën e numrit të edukatoreve.

Reforma për financimin e funksionit të arsimit parashkollor do të vazhdojë të sigurojë:

- Uljen e madhësisë së grupeve/klasave të fëmijëve në kopshte nga raporti aktual mesatar 18 fëmijë për një edukatore në raportin 15 fëmijë për një edukatore.
- Ruajtjen e nivelit aktual të fondeve për ato bashki të cilat rezultojnë të kenë një numër relativisht "të lartë" edukatoresh për numrin e fëmijëve të regjistruar në kopshte, krahasimisht me bashkitë e tjera.
- Një ndarje më të drejtë të fondeve për pagat e edukatoreve, duke zbutur diferencat ndërmjet bashkive përsa i përket raportit fëmijë për edukatore.

Kostoja e kësaj reforme është 327 milionë lekë, dhe mbulohet nga rritja e transfertës së pakushtëzuar për bashkitë për vitin 2020. Kjo reformë, realizon një ndarje më të drejtë të fondeve, zbut diferencat ndërmjet

bashkive përsa i përket raportit “fëmijë për edukatore” dhe siguron fonde shtesë për ato bashki që kanë një nevojë imediate për rritjen e numrit të edukatorëve.


❖ **Transferta e pakushtëzuar 2020 dhe formula e shpërndarjes së saj**

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2020, bazohet në një formulë të thjeshtë për t’u kuptuar dhe zbatuar, të bazuar në kritere që garantojnë funksionimin normal të njërive të vetëqeverisjes vendore. Transferta e pakushtëzuar do t’u sigurojë njërive të vetëqeverisjes vendore mbulimin e diferencës mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur.

Për vitin 2020, transferata e pakushtëzuar përbëhet nga dy pjesë: a) pjesa e përgjithshme dhe b) pjesa sektoriale. Formula e shpërndarjes së transfertës garanton një sistem më të drejtë ekualizimi fiskal duke ndihmuar bashkitë me kapacitet më të ulët fiskal. Mekanizmi i shpërndarjes së transfertës është i përshtatur në funksion të reformës administrativo-territoriale. Ndarja e grantit bazohet plotësisht në formulë, pa përfshirë fondet për konviktet, shërbimet sociale, fondet e rrugëve rurale. Gjithashtu, formula e shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar identifikon nevojat për shpenzime të bashkive duke u bazuar tek popullsia relative, dendësia e popullsisë (që reflekton diferencat në koston e ushtrimit të funksioneve ndërmjet bashkive) dhe tek numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Përveç ekualizimit të kostove të shërbimeve që bëhet nëpërmjet komponentit të dendësisë, formula e ndarjes së transfertës së pakushtëzuar sjell edhe ekualizimin e kapacitetit fiskal (të matur nga të ardhurat faktike nga taksat e ndara ndërmjet qeverisë qendrore dhe asaj vendore), të cilat mblidhen dhe u transferohen plotësisht ose pjesërisht bashkive nga administrata tatimore qendrore. Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, nga taksa vjetore e automjeteve të përdorura dhe taksa e kalimit të pasurisë për pasuritë e paluajtshme të shitura nga personat juridik.

Në buxhetin e vitit 2020, shuma e transfertës së pakushtëzuar e shpërndarë me anë të formulës rritet në 18 miliardë lekë, nga 17.6 miliardë lekë që ishte në buxhetin e vitit 2019, pra rreth 400 milionë lekë më shumë (ose rreth 3 % më e lartë) se në vitin 2019. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2020, krahasuar me vitin 2015, është 5.7 miliardë lekë më shumë ose rreth 46.3 përqind më e lartë (sic paraqitet edhe në grafikun e mëposhtëm). Rritja e konsiderueshme e transfertës së pakushtëzuar, tregon rëndësinë që ky buxhet i kushton procesit të decentralizimit dhe efikasitetit të qeverisjes vendore.

Grafiku 1: Transferta e pakushtëzuar 2011-2020 (në mln lekë)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

Në transfertën e pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2020, në nivelin prej 1% të PBB-së ose 18 miliard lekë, do të shtohen edhe fondet prej 7,6 miliard lekë transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja të transferuara në njësitë e vetëqeverisjes vendore në bazë të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Në total, në vitin 2020, transferta e pakushtëzuar do të jetë 25.6 miliard lekë.


❖ Detyrimet e prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore

Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore dhe zbatimi i akteve nënligjore në zbatim të tij kanë krijuar kuadrin rregullator për të forcuar disiplinën financiare dhe për të parandaluar akumulimin e detyrimeve të papaguara në të ardhmen për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në këtë kuadër, qeveria po i kushton një vëmendje të vecantë shlyerjes së detyrimeve të prapambetura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore ka hartuar dhe është duke zbatuar një plan veprimi për shlyerjen e këtyre detyrimeve. Stoku i detyrimeve të papaguara, i cili parashikohet të shlyhet në një periudhë afatmesme, bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është ulur në 7 miliard lekë nga 11.8 miliard lekë në vitin 2015. Gjatë vitit 2020, do të vazhdohet të monitorohet periodikisht zbatimi i planit të shlyerjes së detyrimeve dhe mos krijimi i detyrimeve të reja nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, deri në shlyerjen e plotë të tyre.

❖ Treguesit Fiskal e Buxhetor të Pushtetit Vendor

Buxheti vendor i vitit 2020, parashikohet të jetë rreth 11.2 përqind më i lartë se ai i vitit 2019, ose në nivelin prej 3.2 përqind e PBB-së. Ndërkohë, krahasuar me vitin 2015 buxheti vendor për vitin 2020 paraqitet me një rritje të ndjeshme me rreth 62 përqind. Me buxhetin e vitit 2020, do të financohen funksionet e transferuara, dhe të gjitha funksionet e tjera të parashikuara në ligj, të cilat njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë ti ushtrojnë në shërbim të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Grafiku 2: Buxheti Vendor 2015-2020




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2020, janë parashikuar në masën 57.128 miliardë lekë ose 3.2 përqind e PBB-së. Në këtë zë është përlogaritur rritja e transfertës së pakushtëzuar për njësitë e vetëqeverisjes vendore, financimi i funksioneve të reja, si dhe rritja e të ardhurave të veta.

Të ardhurat nga taksat dhe tarifat e veta vendore për vitin 2020, parashikohet të kenë një rritje me mbi 3.8 miliard lekë më shumë se sa plani i vitit 2019 ose e thënë ndryshe me një rritje prej 18.2%, ndërkohë krahasuar me vitin 2015, si viti para referomës administrative, të ardhurat vendore parashikohen me një rritje të konsiderueshme me rreth 15.2 miliardë lekë. Kjo rritje e të ardhurave do të vazhdojë si rrjedhojë e ndarjes më të drejtë dhe transparente të financave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, përmirësimit të vazhdueshëm të skemës së financimit të funksioneve të veta si dhe rritjes së burimeve të financimit të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, ndryshimet që po zbatohen në taksën e pronës, kadastrën fiskale parashikojnë të ndikojnë në peshën e rritjes së të ardhurave në buxhetin vendor.

Tendenca e rritjes së buxhetit vendor do të vazhdojë edhe në projektbuxhetin e vitit 2020 (Grafiku x), ku buxheti vendor, me autonomi të plotë financiare, parashikohet të jetë 3.2 përqind e PBB-së.


Grafiku 3: Tendanca e buxhetit vendor 2015-P/Buxhet 2020



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

Rritja e të ardhurave të mbledhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë viteve 2015-2020, evidentohet edhe në rritjen e peshës që zënë këto të ardhura si ndaj të ardhurave totale të buxhetit të shtetit, ashtu edhe ndaj Produktit të Brendshëm Bruto, sikurse shihet edhe në grafikun e mëposhtëm. Kjo tregon përmirësimin e kapacitetit fiskal të njësive vendore në drejtim të mbledhjes së më shumë të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.


Grafiku 4 :Pesha specifike e të ardhurave të buxhetit vendor ndaj të ardhurave të buxhetit të shtetit dhe PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

Rritja e shpenzimeve të realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, gjatë viteve 2015-2020, konstatohet edhe në rritjen e peshës që zënë këto shpenzime si ndaj shpenzimeve buxhetore në total, ashtu edhe ndaj Produktit të Brendshëm Bruto. Pesha specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj buxhetit të shtetit është rritur ndjeshëm për periudhën 2016 – 2020 (10.8 përqind), krahasuar me vitin 2015, ku shpenzimet e buxhetit vendor zinin vetëm 7.7 përqind të shpenzimeve të buxhetit shtetit. Ndërkohë, siç vihet re edhe nga grafiku i mëposhtëm, për vitet 2019 - 2020, pesha specifike e buxhetit vendor ndaj Produktit të Brendshëm Bruto është rritur ndjeshëm me rreth 1 përqind më shumë se pesha që zinte në vitin 2015.

Figura 5:Pesha specifike e shpenzimeve të buxhetit vendor ndaj shpenzimeve të buxhetit të shtetit dhe PBB-së



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

❖ Objektivat kryesore për buxhetin vendor të vitit 2020

- **Rritja e burimeve të financimit të qeverisjes vendore me rreth 5.7 miliardë lekë ose 11.2% më shumë se në vitin 2019**, rritje e cila sigurohet nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore. Kjo rritje krijon hapësirat e nevojshme për përmirësimin e shërbimeve publike dhe fokusim më të madh në investime kapitale;
- **Ngritja e kadastrës fiskale** dhe implementimit në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore me qëllim taksimin sa më të drejtë, me objektiv rritjen e të ardhurave për njësitë e vetëqeverisjes vendore;

- **Harmonizimi dhe unifikimi i procedurave mbi hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve** të njësisve të vetëqeverisjes vendore, konform standarteve ndërkombëtare;
- **Konsolidimi i procedurave dhe i sistemit të menaxhimit të financave vendore** në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij;
- **Menaxhimi më i mirë i shpenzimeve administrative** me qëllim ofrimin e më shumë shërbimeve publike cilësore me një kosto sa më të ulët. Kjo, do të arrihet nëpërmjet rritjes së peshës së shpenzimeve për investime dhe uljes së peshës që zënë shpenzimet administrative;
- **Rritja e eficiencës në ofrimin e shërbimeve publike** në nivel vendor, duke identifikuar tregues të performancës së shërbimit të ofruar;
- **Përmirësimi i cilësisë së raporteve të monitorimit të buxhetit vendor** dhe krijimi i një sistemi të monitorimit mbi bazën e treguesve të performancës.
- **Sigurimi i menaxhimit financiar transparent dhe efektiv** për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- **Rritja e transparencës dhe llogaridhënies** së qeverisjes vendore në raport me komunitetin, në drejtim të monitorimit të publikimit të dokumentave buxhetorë dhe zhvillimin të seancave të vazhdueshme të konsultimit me qytetarët.
- **Implementimi i një metodologjie** të mirëstrukturuar në lidhje me evidentimin e rasteve të vështirësive financiare të njësisve të vetëqeverisjes vendore.

6. POLITIKAT E TAKSAVE PËR VITIN 2020

6.1 PAKETA E RE FISKALE

Paketa Fiskale 2020 parashikon disa ndryshime në legjislacionin fiskal. Ndër ndryshimet kryesore renditen:

Tatimi mbi te ardhurat

- Incentivimin e sektorit të industrisë automotive duke ulur normën e tatim fitimit në 5 %, për personat juridikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik në këtë industri.
- Promovimin e sportit, me qëllim rritjen e impaktit pozitiv të tij në shoqëri. Për këtë arsye propozohet incentiva fiskale për përjashtimin nga tatimi mbi te ardhurat personale të shpërblimeve që u jepen sportistëve, apo ekipeve sportive pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni përkatës. Gjithashtu, për personat juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milion lekë, shumat e sponsorizuara në fushën e sportit, të njohura si shpenzime të zbritshme, për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin, janë të zbritshme sa trefishi i shumës së sponsorizuar.

- Mbartjen e humbjeve për një periudhë 5-vjecare për tatimpaguesit, që investojnë në projekte biznesi me vlerë mbi 1 miliard lekë.
- Harmonizimin e Ligjit nr 8438 nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar me ligjin e ri “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”

Taksat kombetare

- saktësimin e vlerës së mjetit për efekt të kriterëve që duhet të përmbushi një automjet për tu konsideruar automjet luksi, duke e amortizuar vlerën e automjetit me 10% me vlerë të mbetur;
- ndryshime në penaltet me qëllim unifikimin e gjobës për pagesë të vonuar për taksën vjetore të mjeteve të përdorura;
- rritje të komisionit që përfiton DPSHTRR, prej 5 (pesë) përqind për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze”;
- shtimin e kategorisë së personave me aftësi të kufizuar për tu përjashtuar nga taksa vjetore të mjeteve të përdorura.
- përjashtimin nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura, “Automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi”.

Procedurat Tatimore, Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Ndryshimet në Ligjet: “Për procedurat tatimore” dhe “Për tatimit mbi vlerën e shtuar” lidhen kryesisht me hartimin dhe miratimin e ligjit “Për fiskalizimin”. Pra janë ndryshime procedurale të lidhura me të. Njëkohësisht janë rishikuar edhe disa shkelje administrative dhe nivele penaltetesh me qëllim lehtësimin e zbatimit praktik të tyre.

Efektet e politikave fiskale

- Rritja e programuar e akcizes së cigareve. Efekti vjetor +750 milion lekë.
- Miratimi i një ligji për rivlerësimin e banesave. Efekti i vlerësuar për 2020 është +4 miliard lekë.
- Incentivimin e sektorit të industrisë automotive duke ulur normën e tatim fitimit në 5 %, për personat juridikë që ushtrojnë aktivitet ekonomik në këtë industri. Aktualisht nuk kemi efekte që mund të llogariten në të ardhurat e buxhetit
- Përjashtimin nga tatimi mbi të ardhurat personale të shpërblimeve që u jepen sportistëve, apo ekipeve sportive pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni përkatës. Efekti do jetë minimal në vartësi të rezultateve të arritura
- Personat juridikë, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milion lekë, shumat e sponsorizuara në fushën e sportit, të njohura si shpenzime të zbritshme, për efekt të llogaritjes së tatimit mbi fitimin, janë të zbritshme sa trefishi i shumës së sponsorizuar. Llogaritjet janë teorike, pasi duhet të identifikohen ato kompani që do financojnë sportin.
- Mbartjen e humbjeve për një periudhë 5-vjecare për tatimpaguesit, që investojnë në projekte biznesi me vlerë mbi 1 miliard lekë. Nuk mund të llogariten efekte.
- Saktësimin e vlerës së mjetit për efekt të kriterëve që duhet të përmbushi një automjet për tu konsideruar automjet luksi, duke e amortizuar vlerën e automjetit me 10% me vlerë të mbetur; Ndryshimi është procedural

- Rritje të komisionit që përfiton DPSHTRR, prej 5(pesë) përqind për taksën e regjistrimit fillestar dhe taksën e përvitshme për automjetet luksoze”;
- Shtimin e kategorisë së personave me aftësi të kufizuar për tu përjashtuar nga taksa vjetore të mjeteve të përdorura. Efekte minimale.
- Përjashtimin nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura, “Automjeteve të hershme me interes historik dhe koleksionimi sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi”. Efekte minimale

6.2 PËRJASHTIMET NGA TAKSAT (“TAX EXPENDITURES”)

Shpenzimet tatimore, apo “tax expenditures” konsiderohen humbje nga të ardhurat fiskale të parashikuara në legjislacionin fiskal në fuqi, si rezultat i lehtësirave fiskale ose normave preferenciale të vendosura për kategori të caktuara taksapaguesish ose aktiviteteve. “Shpenzimet tatimore” janë vlerësuar duke përdorur një metodologji të re bazuar mbi disa modele për vlerësimin e shpenzimeve tatimore sipas llojit të tatimeve. Analiza e përjashtimeve ligjore dhe përcaktimi i benchmark-ut (përjashtime që janë normë në të gjithë vendet) u krye me asistencë të Bankës Botërore.

Për vlerësimin dhe matjen e “përjashtimeve nga taksat” janë marrë në konsideratë tatimet dhe taksat e mëposhtme:

- Tatimi mbi vlerën e shtuar, përkatësisht në Ligjin nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar” në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
- Tatimi mbi të ardhurat, përkatësisht në [Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar.](#)
- Akciza, përkatësisht në Ligjin nr. 61/2012 “Për Akcizën në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sipas metodologjisë së re, duke përdorur edhe Tabelën e Burim-Përdorimeve (prodhuar nga INSTAT), janë përcaktuar vlerat e shpenzimeve tatimore për TVSH.

Bazuar në Ligjin e të Ardhurave Personale janë llogaritur si “Tax Expenditure”:

- Tatim Fitimi: me supozimin që të mos paguajnë 5% por 15% mbi fitimin e tatueshëm, të gjithë subjektet me xhiro vjetore nën 8 milionë lekë.
- Të ardhurat personale mbi pagat: me supozimin që të punësuarit me fashën e të ardhurave nga 30.000 lekë/muaj në 150.000 lekë/muaj, të taten me normë 15% dhe jo 13%, siç është aktualisht.
- Akciza: me supozimin e llogaritjes së shpenzimeve tatimore nga akciza si:

(Norma më e lartë e përcaktuar me ligj – Normën efektive) * Sasinë e hedhur në konsum

Tabela e mëposhtme pasqyron një përmbledhje të përjashtimeve të taksave, si përqindje e Prodhimit të Brendshëm Bruto, bazuar në të dhënat e marra nga Administrata Tatimore dhe Administrata Doganore për vitin 2019.

Tabela 7

(në milionë lekë)

Lloji i Tatimit	Viti 2020			Viti 2019				
	Shpenzimet Tatimore	Në % ndaj Totalit	Në % ndaj të Ardhurave	Në % ndaj PBB	Shpenzimet Tatimore	Në % ndaj Totalit	Në % ndaj të Ardhurave	Në % ndaj PBB
TVSH	90,060	95.9%	20.50%	5.02%	87,437	95.9%	20.85%	5.12%
Akciza	1,263	1.3%	0.29%	0.07%	1,226	1.3%	0.29%	0.07%
Tatim Fitimi	644	0.7%	0.15%	0.04%	625	0.7%	0.15%	0.04%
TAP	1,933	2.1%	0.44%	0.11%	1,877	2.1%	0.45%	0.11%
Totali	93,900	100.0%	21.37%	5.24%	91,165	100%	21.74%	5.34%
PBB Nominal 2019 (sipas Kuadrit Makrofiskal)							1,793,466	
PBB Nominal 2018							1,707,079	

Burimi: *Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)*

7. RREZIQUET FISKALE DHE MASAT MBROJTËSE

Risqet Fiskale në krahun e të Ardhurave

Në lidhje me të ardhurat tatimore të vitit 2020, risqet fiskale konsistojnë në:

Projeksioni i të ardhurave për vitin 2020 është mbështetur në rritjen nominale ekonomike 4,1 % dhe indeksin e cmimeve 2,1 %. Nëse ekonomia nuk do performojë në këto parametra, ka risk për të ardhurat e buxhetit. Nëse ekonomia do rritet jo 4,1 % por 3,5 % efekti negativ në të ardhurat tatimore do jetë 2-3 miliard lekë

Është parashikuar rritje e importit dhe prodhimit vendas të karburantit me 4% bazuar në performancën e vitit 2019. Në rast se nuk verifikohet kjo rritje mund të rezultojë më e ulët mund të kemi një efekt negativ në të ardhurat me -0.5 miliardë lekë.

Tabela 8

Risqet	Efektet negative në të ardhurat				
	Akçizë		TVSH	TAP	Total
Rritja e PBB-se jo 4,1 % por 3.5 %			3,000		3,000
Rritja e karburantit jo 4% sipas ecurisë 2019 por 2,4 %	280		220		500
Mosmiratimi i ligjit për rivlerësimin e banesave				4,000	4.000
Total					7,500

Risku i normave të interesit

Gjatë viteve të fundit ekspozimi ndaj riskut të normave të interesit ka ardhur duke u zbutur, kryesisht për shkak të rikompozimit të portofolit të borxhit të brendshëm në drejtim të titujve afatgjatë me norma interesi fikse. Megjithatë, risku i normave të interesit vazhdon të jetë i konsiderueshëm, pasi rreth gjysma e portofolit të borxhit shtetëror rivlerëson normën e interesit në harkun kohor të një viti. Impakti në buxhet nga luhatjet e normave të interesit mund të jetë nga i nivelit të ulët në periudhën afatshkurtër deri në i nivelit mesatar në periudhën afatmesme.

Projeksionet në lidhje me shpenzimet e interesave në buxhetin e vitit 2020 vlerësohen të jenë realiste dhe me risqe të moderuara. Megjithatë, duke filluar nga viti 2017 në zbatim të detyrimit ligjor të përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit, në buxhetin e shtetit janë programuar kontigjenca të veçanta për të absorbuar e rritjen e shërbimit të borxhit që mund të burojnë nga rritja e normave të interesit përtej pritshmërive. Në këtë drejtim, në buxhetin e vitit 2020 janë parashikuar 4 miliard Lekë kontigjenca, një nivel ky i mjaftueshëm për të përballuar rritjet e normave të interesit për gjatë vitit 2020.

Koncesionet dhe PPP-të:

Ministria e Financave vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet koncesionare dhe të partneritetit publik privat (PPP), si edhe çdo ndryshim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve individuale apo në grup, për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor. Në rast tejkalimi të këtij kufiri, Këshilli i Ministrave merr masa korrektuese në krahun e të ardhurave buxhetore, të nevojshme dhe të mjaftueshme, për t'u rikthyer brenda kufirit të lejuar, gjatë dy viteve të ardhshme buxhetore.

Aktualisht, janë aktive 13 kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP)⁷ sipas Tabelës 9 të mëposhtme:

Tabela 9: Koncesionet/PPP aktive me mbështetje financiare nga buxheti i shtetit

Autoriteti Kontraktor	Nr.	Emertimi i Kontrates PPP	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Programi	Lloji i shpenzimit	në mijë Lekë				
							2018 Fakt	2019 9 mujori	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi	2022 Parashikimi
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	1	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë së Elbasanit	2015	2021	06220	Investime	601,429	436,386	661,500	331,000	0
	2	Ndërtimi, operimi dhe transferimi e inceneratorit për përpunimin e mbetjeve urbane të Bashkisë Fier	2016	2023	06220	Investime	752,771	564,576	752,770	752,770	752,770
	3	Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese	2015	2019	04320	Investime	1,355,108	1,505,821	0	0	0
	4	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit	2018	2030	04520	Investime	0	2,612,316	3,925,000	3,925,000	3,000,000
	5	Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rrugës Milot-Morinë	2017	2047	04520	Investime	308,183	315,621	720,000	720,000	692,000
	7	Ndërtimi dhe Operimi i Porti Jahteve Oriku - Dukat	2018	2030	04520	Investime	0	0	393,147	1,087,880	1,036,300
	8	Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Baldren	2018	2032	04520	Investime	0	0	100,000	100,000	312,000
	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	1	Shërbimi i Skanimit në Dogana	2013	2030	01150	Korrente	1,525,579	1,133,730	1,540,896	1,587,123
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1	Koncesioni/PPP Kontrolli baze i popullsisë 35-70 vjeç (check up)	2015	2024	07220	Korrente	876,083	657,062	876,083	876,083	876,083
	2	Koncesioni/PPP (Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale)	2015	2024	07330	Korrente	1,625,581	1,639,628	1,655,322	1,704,982	1,756,211
	3	Koncesioni/PPP (Ofrimi i shërbimit të dializës në 5 spitale rajonale)	2016	2025	07330	Korrente	738,911	589,380	688,581	734,021	756,200
	4	Ofrimi i Shërbimeve laboratorike spitalore	2019	2028	07330	Korrente	0	0	1,280,444	1,290,241	1,300,136
Bashkia Tiranë / Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	1	Për përmirësimin e Infrastrukturës arsimore në Bashkinë Tiranë	2017	2024	09120	Investime	0	0	1,018,303	1,528,336	1,401,505
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë / Bashkia Tiranë	1	Per ndërtimin e landfillit, inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike	2017	2046	06220	Korrente	977,000	767,126	998,410	1,165,124	1,165,124
	14	TOTALI					8,760,645	10,221,646	14,610,456	15,202,560	14,683,066
Totali i të Ardhurave Tatimore i parashikuar per periudhen 2018-2020							419,333,310	448,336,713	465,089,688	490,815,966	---
Respektimi i Rregullit Fiskal (perpjesa e pagesave te PPP ndaj totalit te te ardhurave tatimore te vitit paraardhes buxhetor me pak se 5%)							2.2%	2.4%	3.3%	3.3%	3.0%

Për sa i përket respektimit të nenit 4/2 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor ku përcaktohet se "...shuma e përgjithshme e pagesave vjetore neto, që kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat rezultojnë nga kontrata koncesionare apo partneriteti publik privat (PPP), si rregull, nuk duhet të tejkalojnë kufirin prej 5 për qind të të ardhurave tatimore faktike të vitit paraardhës buxhetor.", për vitin 2020 vërehet se:

- Për vitin 2020, **kufiri i lejuar** i pagesave neto për kontratat koncesionare/PPP, prej 5% i të ardhurave tatimore të pritshme të vitit 2019, është rreth **22.42 miliardë lekë**.
- Referuar Tabelës 9, **për vitin 2020 pagesat vjetore neto** që parashikohen të kryhen nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme për kontratat koncesionare apo PPP, kapin vlerën rreth **14.6 miliardë lekë**.
- Rrjedhimisht, në **buxhetin 2020 është respektuar kufizimin ligjor** i sipërcituar në zbatim të rregullit fiskal respektiv, pasi vlera e parashikuar prej 14.6 miliardë lekë për pagesat vjetore neto të kontratave koncesionare apo PPP për vitin 2020, përbën vetëm **3.3 për qind të totalit të të ardhurave tatimore të parashikuara për vitin 2019**, prej rreth 448.3 miliardë lekë.

⁷ Kontrata PPP “Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi (BOT) HEC mbi lumin Devoll, rimbursimi i ndërtimit të rrugëve zëvendësuese përfundon në fund të vitit 2019, vit në të cilin parashikohet të kryhet dhe pagesa e fundit.

Gjatë vitit 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka intensifikuar monitorimin e performancës së kontratave koncesionare/PPP-ve me mbështetje buxhetore, duke monitoruar jo vetëm ecurinë e pagesave faktike buxhetore por edhe treguesit e performancës të planifikuar/realizuar për secilën kontratë koncesionare/PPP. Duke filluar nga viti 2019, monitorimi dhe raportimi mbi kontratat koncesionare/PPP është institucionalizuar përmes përfshirjes në udhëzimin plotësues nr.1, datë 17.01.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”, të skedulit të detyrueshëm kohor të raportimit të tyre nga çdo autoritet kontraktor dhe të formateve standarde respektive, me qëllim thellimin e analizës dhe rritjen e transparencës. Ky monitorim është kryer në bazë mujore.

Përsa i përket ecurisë faktike të pagesave koncesionare, për periudhën Janar-Shtator 2019 dhe pritshmëritë deri në fund të vitit 2019, në vijim jepet një tablo përmbledhëse:

- Fondet buxhetore të planifikuara për vitin 2019, me destinacion mbështetjen nga buxheti për kontratat koncesionare/PPP, janë në total 12.44 miliardë lekë. Nga këto, rreth 6.38 miliardë lekë janë investime dhe 6.06 miliardë lekë shpenzime korente.
- Kundrejt faktit të vitit 2018 që kapi vlerën 8.76 miliardë lekë, plani 2019 rezulton 42% më i lartë ose rreth 3.68 miliard lekë më shumë.
- Pagesat faktike në total për 9-mujorin 2019, rezultojnë 10.22 miliardë lekë ose 82.1% e planit vjetor 2019. Nivelin më të lartë të pagesave e ka shënuar muaji Janar me 2.9 miliardë lekë nga të cilat 2.52 miliard lekë është pagesa për kontratën e MIE “Ndërtimi dhe Operimi i Rrugës së Arbrit”, specifikisht për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e kësaj kontrate.
- Krahasuar me pagesat faktike për 9 mujorin e vitit 2018, të cilat arritën nivelin rreth 6.4 miliardë lekë ose 79.3% e planit vjetor 2018, realizimi 9 mujor i vitit 2019 rezulton në masën rreth 3.8 miliard lekë më shumë ose 60 përqind më i lartë.
 - Theksojmë faktin se, për kontratën koncesionare/PPP “Ndërtimi i rrugës së Arbrit”, në vitin 2018 nuk ka pasur asnjë pagesë buxhetore.
- Bazuar në parashikimin e ecurisë së pagesave për periudhën e mbetur të vitit 2019 (tetor-dhjetor), fondi i planifikuar për t’u shpenzuar është 2.14 miliardë lekë, nivel ky që do të përmbushte 99.3% planin vjetor të miratuar për vitin 2019.

Sektori Energjitik

Sektori i ndërmarrjeve shtetërore dhe kryesisht ndërmarrjet që operojnë në sektorin e energjisë kanë qenë dhe mbeten nën monitorimin e vazhdueshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, duke marrë parasysh ndikimin e ndjeshëm fiskal dhe në ekonomi të këtij sektori kyç. Ky monitorim, i cili është kryer periodikisht mbi bazë tremujore, ka konsistuar në analizimin e treguesve të performancës financiare të secilës prej tre kompanive KESH, OSHEE dhe OST.

Në mbështetje të nenit 4/2 të ligjit 57, datë 2.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, sipas së cilit: “*Planet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare mbi bazë tremujori, të çdo njësie jo të qeverisjes së përgjithshme, dorëzohen në Ministrinë e Financave*”, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, periodikisht mbi bazë tremujore, ka mbledhur, përpunuar dhe analizuar informacionin e nevojshëm në lidhje me treguesit e performancës financiare të tre kompanive të sektorit energjitik. Kjo, me qëllim identifikimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve fiskale që rezultojnë nga ndërmarrjet

publike me kapital shtetëror në tërësi dhe nga sektori energjistik në veçanti, duke konsideruar rëndësinë strategjike të tij dhe problematikat sensitive që e karakterizojnë.

Referuar analizës mbi raportimin më të fundit të treguesve financiarë të miratuar zyrtarisht për këtë sektor, atyre të **periudhës Janar-Qershor 2019**, në tabelën e mëposhtme paraqitet në mënyrë të përbledhur ndikimi që sektori i energjisë ka patur në financat publike.

Tabela 9

Në milionë Lekë

	2014	2015	2016	2017	2018	6 Mujor 2019
1. Për garancitë dhe nënhatë e paguara nga MFE						
-Për garancitë e paguara nga MFE	2.269	2.278	2.061	2.702	2.624	1.115
-Për fondet me financim të huaj të nënhuazuara	1.778	1.839	2.313	3.199	4.698	1.716
-Për mbështetjen buxhetore me fonde nga buxheti i shtetit	1.500	-	1.000	2.241	-	-
3. Net Lending Nënua	5.792	5.962	3.942	8.293	4.349	280

Disbursimet për sektorin e Energjisë (2011-2019) Nënua

në milion lekë

		2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	6 mujor 2019	Parashikimi 2019
ENERGJIA	Projekte	3.355,2	1.515,1	2.103,7	4.429,3	6.208,5	3.650,6	6.819,8	4.510,5	521,4	6.584,7
	Mbështetje Buxhetore	-	2.000,0	-	1.500,0	-	1.000,0	2.500,0	-	-	-
	Gjithsej	3.355,2	3.515,1	2.103,7	5.929,3	6.208,5	4.650,6	9.319,8	4.509,9	521,4	6.584,7
	Pozicioni Neto (Nënua) ²	2.239,7	3.198,6	1.995,3	1.881,1	4.758,5	3.942,4	8.308,4	4.349,2	469,8	2.471,3

2) Merr parasysh principalin e paguar nga sektori dhe principalin e falur/netuar

Arkëtimet nga nënhuaja për sektorin e Energjisë (2011-2019)

në milion lekë

		2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	6 mujor 2019	Parashikimi 2019
ENERGJIA	Interesa*	231,0	85,7	121,6	209	396,4	326,8	157,1	91,7	72,6	733,2
	Principal*	1.115,4	316,5	108,4	130	237,2	708,3	1.011,4	161,3	51,6	4.113,4
	Gjithsej	1.346,4	402,1	230,1	339,1	633,5	1.035,0	1.168,5	253,0	124,2	4.846,7

*) Në zërat Interesa dhe Principal për periudhen 2011-2017 përfshihen principli dhe interesat e paguara dhe ato të falura/netuara

Detyrimet kontigjente nga garancitë

	31 Dhjetor					Qershor 2019
	2014	2015	2016	2017	2018	
	<i>(Milion lekë)</i>					
Stoku i borxhit të garantuar	54,540	56,030	53,468	49,885	44,672	43,356
Grancitë e brendshme.....	26,033	30,439	30,286	30,117	29,454	28,168
Grancitë e jashtme.....	28,507	25,591	23,182	19,768	15,218	15,188

Përsa i përket performancës së Sektorit në tërësi dhe OSHEE sh.a në veçanti, vlen të theksojmë se:

- **Gjatë vitit 2018**, Gjatë vitit 2018 sektori u përmirësua ndjeshëm duke rezultuar me rritje të konsiderueshme në nivelin e fitimit operativ dhe pasurisë së kompanive që rrjedhimisht ndikon në përmirësimin e pozicionit financiar të sektorit. Si rezultat i nivelit të lartë të shirave prodhimi i energjisë në 6-mujorin e parë të vitit i tejkaloi parashikimet. Kjo situatë favorizoi më së shumti kompaninë KESH dhe OST duke sjellë të ardhura shtesë, por për OSHEE kjo situatë solli rritje të shpenzimeve për blerje energjie pasi OSHEE ishte e detyruar të blejë prodhimin e shtuar të HEC-ve me një kosto më të lartë. Prodhimi i energjisë në nivel kombëtar ishte shume herë më i lartë se

mesatarja shumë-vjeçare e prodhimit. Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2018 ka shënuar një rekord përse i takon totalit të prodhimit me rreth 8.6 GWh, nga e cila rreth 68 përqind është realizuar nga centralet prodhuese të KESH sh.a dhe rreth 32 përqind është realizuar nga centralet e tjerë prodhues. Niveli i humbjeve u përmirësua ndjeshëm në 24 përqind dhe niveli i arkëtimeve gjithashtu rezultoi rreth 101.9 përqind.

- **Gjatë muajve të parë të vitit 2019** sektori energjistik u përball me një nivel rekord minimal të prodhimit të energjisë i cili u reflektua dhe në performancën financiare të sektorit në tërësi. Në kuadër të angazhimit maksimal për optimizimin e sistemit energjistik u miratua **“Plani i Konsolidimit Financiar për Sektorin Publik Elektroenergjitik”**. Qëllimi i këtij plani është të paraqesë një pamje të përgjithshme të situatës financiare të Sektorit Energjistik në Shqipëri për periudhën 2015-2017 dhe propozimin e një plani për rimëkëmbjen financiare për pesë vitet e ardhshme, shoqëruar me një plan veprimi konkret.
- **Mbështetja buxhetore neto** nëpërmjet financimit të huaj për sektorin e energjisë **për vitin 2019**, është miratuar në nivelin 3 miliard lekë. Duke marrë në konsideratë situatën e pafavorshme hidrike, kompanive iu është kërkuar të rishikojnë dhe të prioritarizojnë shpenzimet operative dhe sidomos ato kapitale të planifikuara për periudhën 2019-2020, me qëllim paraprirjen e ndonjë nevojë kritike për mbështetje buxhetore extra.
- **Për vitin 2020**, parashikimet e kompanive dhe monitorimi i MFE do të fokusohen në garantimin e objektivit madhor për një performancë të shëndetshme të Sektorit, përmes (i) *ruajtjes së një rezultati neto (net position) të qëndrueshëm (në nivelet e dakordësuara me Bankën Botërore) prej 3-5 miliard lekë, që nuk rrezikon buxhetin për sektorët e tjerë prioritarë dhe (ii) mbajtjen e një rezerve për përballimin e vulnerabilitetit ndaj kushteve meteorologjike të paparashikuara.*

Kompanitë mund dhe duhet të sigurojnë arritjen dhe ruajtjen e parametrave të sipërcituar, përmes përmirësimit të performancës dhe disiplinimit të shpenzimeve (operative dhe kapitale) të secilës prej tre kompanive. Referuar Planit të Konsolidimit Financiar për Sektorin Publik Elektroenergjitik, miratuar përmes VKM nr.253 datë 24.04.2019, masat financiare të parashikuara nga Qeveria Shqiptare si në drejtim të kompanive ashtu edhe në drejtim të tregut do të shërbejnë në mënyrë që:

- *Sektori elektroenergjitik të mos përbëjë rrezik fiskal serioz dhe të sigurojë vetë-qëndrueshmëri përtej vitit 2020.*
- *Të tërhiqen investimet e sektorit privat në sektorin e energjisë elektrike në një mjedis konkurrues, efikas dhe të favorshëm;*
- *Të rritet siguria e rrjetit dhe furnizimi me energji elektrike nëpërmjet përdorimit të burimeve alternative të prodhimit të energjisë.*

Mbi këto baza, pritshmëritë për vitin 2020 janë për një rezultat financiar pozitiv të sektorit, që është i rëndësishëm për përballimin e situatave të vështira të motit pa rënduar buxhetin e shtetit.

Detyrimet Kontigjente:

- **Vendimet e Gjykatës së të Drejtave të Njeriut në Strasburg (GJEDNJ)** kryesisht çështje dhe vendime që lidhen me kthimin dhe kompensimin e pronave tek ish-pronarët. Sipas Avokaturës së Shtetit, risqet financiare që burojnë nga vendimet e GJEDNJ-së janë të karakterizuara nga një

aftësi e dobët parashikuese, përsa kohë që kjo Gjykatë nuk funksionon më me një kalendar të përcaktuar për komunikimin e çështjeve dhe nxjerrjen e vendimeve.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka respektuar në vazhdimësi të gjitha vendimet e miratuara nga GJEDNJ përmes zbatimit të VKM-ve respektive miratuar në mbështetje të tyre, me përpikmëri dhe brenda afateve strikte të përcaktuara prej këtij organi. Kjo, duke konsideruar faktin se kur pagesat nuk kryhen brenda afatit tre mujor nga data kur vendimi përkatës merr formën e prerë, shteti shqiptar ngarkohet me pagesën e një kamatë-vonesë për çdo ditë vonesë. Sidoqoftë, për garantimin e shlyerjes në kohë të këtyre vendimeve, MFE ka rekomanduar vazhdimisht përdorimin e të gjitha kanaleve të mundshme institucionale dhe procedurale, brenda hapësirave që siguron kuadri ligjor në fuqi, duke sugjeruar që:

- *Vendimet e GJEDNJ-së duhet të dërgohen fillimisht për zbatim në Agjencinë e Trajtimin të Pronës, duke shfrytëzuar të gjitha mundësitë për kompensim fizik të tyre, nëse kjo parashikohet nga vendimi i Gjykatës.*
 - *Pjesa tjetër e detyrimit financiar të paguhet sipas mundësive të buxhetit të shtetit me këste, në negociim me përfituesit.*
- Ndërkohë, hyrja në fuqi më datë 30.12.2018 e ndryshimeve në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”, përmban një kre të veçantë dedikuar ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së, ku specifikisht në nenin 19/4 përcaktohen 2 mënyra ekzekutimi të shpërblimit:
 - *Vendimet me detyrim financiar mbi 10.000 EUR, implikojnë nxjerrjen e VKM-ve respektive për ekzekutimin e tyre.*
 - *Vendimet me detyrim financiar deri në 10.000 EUR, ekzekutohen drejtpërdrejtë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas kërkesës zyrtare të Avokaturës së Shtetit.*

Edhe për vitin 2020, likuidimi i detyrimeve të këtij lloji përballohet nga Fondi Rezervë i buxhetit të shtetit.

- **Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të ARBITRAZHIT** që kanë të bëjnë me zgjidhjen e konflikteve në mosmarrëveshjet dy ose shumëpalëshe, në ngarkim të shtetit shqiptar, përbëjnë gjithashtu një risk real për buxhetin e shtetit. Në pjesën më të madhe, efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtyre vendimeve janë përballur nga buxheti i vetë institucioneve buxhetore (kryesisht ministri linje) që kanë përfaqësuar Qeverinë shqiptare. Në raste të tjera, sipas specifikave, është përdorur për këtë qëllim edhe Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka rekomanduar forcimin e rolit negociues të institucioneve buxhetore dhe Avokaturës së Shtetit në çështjet e kësaj natyre, si edhe disiplinimin e procesit të shlyerjes financiare të vendimeve finale.

- **Vendimet gjyqësore administrative të formës së prerë**, kryesisht për largime nga puna të ish-punonjësve, procese gjyqësore me karakter shpronësimi etj, implikojnë kosto buxhetore të paparashikuara. Për t’i paraprirë stokut eventual të akumulimit të tyre në kohë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë përveç një monitorimi periodik, vazhdimisht i ka bërë apel edhe aftësisë menaxhuese të vetë institucioneve buxhetore, përmes aplikimit me këste apo instrumentave të tjerë zbutës në kohë të barrës së tyre buxhetore.

Detyrimet e Prapambetura

Një nga çështjet problematike në sistemin tonë buxhetor, u vërtetua se ishte akumulimi i detyrimeve të prapambetura të krijuara përpara vitit 2014. Qeveria jo vetëm e adresoi me prioritet çështjen e shlyerjes së tyre, por me angazhimin maksimal si të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ashtu edhe të institucioneve buxhetore të përfshira në këtë proces, u arrit që brenda dy viteve (2014-2015) të shlyen të gjitha detyrimet e prapambetura të raportuara, në vlerën 67 miliardë lekë. Bazuar në VKM nr. 50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë disa hapa konkretë në drejtim të monitorimit, raportimit dhe parandalimit të detyrimeve të prapambetura.

Stoku i detyrimeve të prapambetura në nivel 6-mujor për vitin 2019 rezultoi rreth 4.88 miliard lekë. Krahasuar me stokun e detyrimeve në Dhjetor 2018, niveli i detyrimeve të prapambetura është ulur me rreth 21 përqind. Një pjesë e konsiderueshme prej rreth 35 përqind e këtij stoku detyrimesh i referohen detyrimeve për vendime gjyqësore.

Vlen për t’u theksuar se tashmë monitorimi i detyrimeve të prapambetura është një proces i konsoliduar në kohë dhe cilësi, përmes monitorimit periodik intensiv të të gjitha detyrimeve të pashlyera të institucioneve buxhetore. Duke nisur nga muaji Shtator 2017, ky monitorim dhe raportim i cili më parë kryhej mbi bazë katërmujorësh, **tashmë ndiqet dhe analizohet mbi bazë tremujore**, në funksion të intensifikimit të rolit mbikqyrës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në këtë drejtim. Kjo, me qëllimin final të përmbushjes së objektivit konkret të Qeverisë, për ‘zerimin’ e të gjitha detyrimeve të prapambetura deri në vitin 2020.

Skeduli dhe modaliteti i raportimit dhe monitorimit të detyrimeve të prapambetura, **u përfshi në Udhezimin Nr.1 datë 17.01.2019 “Mbi zbatimin e Buxhetit 2019”**, duke përcaktuar si afatet strikte të raportimit nga ana e institucioneve buxhetore, ashtu edhe ato të analizimit dhe publikimit nga ana e MFE.

Për më tepër, që prej muajit Janar 2018, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka nisur edhe monitorimin periodik mbi ekzekutimin e pagesave (likuidimin) e detyrimeve të prapambetura përçdo institucion buxhetor, sipas angazhimeve të marra prej tyre për vitin buxhetor 2018. Kjo, krahas përditësimit dhe monitorimit të skedulit të parashikuar të këtyre pagesave edhe për vitin që pason, pra deri në Dhjetor 2019.


Në funksion të sa mësipër, duke konsideruar startimin në 1 Janar 2019 të implementimit të plotë të sistemit të ri informatik financiar të Qeverisë AFMIS, respektimi i angazhimeve financiare të institucioneve buxhetore do të garantohet, përmes monitorimit dhe kontrollit të automatizuar elektronik në kohë reale.

Në përfundim, parë në një aspekt më të gjerë dhe gjithëpërfshirës, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ka sugjeruar të gjitha njësitë të auditimit të brendshëm në sektorin publik që në “Planin strategjik dhe vjetor të veprimtarisë audituese për vitet 2018 – 2020” të përfshijnë angazhime auditimi për analizimin dhe vlerësimin e situatës së detyrimeve të prapambetura të njësitë publike. Kjo, për sa kohë që detyrimet e prapambetura janë përcaktuar si fushë me risk të lartë, dhe duhet të trajtohen me përparësi nga auditimi i brendshëm i njësitë publike, për të paraqitur gjendjen aktuale dhe për të dhënë rekomandime sa më të vlefshme për shlyerjen e tyre në afate të përcaktuara.

8. VEPRIMTARITË POTHUAJSE FISKALE

Në fund të muajit shtator 2019, portofoli i borxhit të garantuar vlerësohet në 43.1 miliard Lekë (2.5% e PBB⁸⁾ ose 3.9% e portofolit të borxhit të Qeverisjes Qendrore. Garancitë në tregun e brendshëm përfaqësojnë 35.2% të totalit të stokut të borxhit të garantuar ose 15.2 miliard Lekë, ndërsa garancitë e emetuara në favor të kreditorëve të huaj përfaqësojnë 64.8% të stokut të borxhit të garantuar ose 28.0 miliard Lekë. Krahasuar me fundin e vitit të kaluar, borxhi i garantuar është reduktuar në vlerë absolute me rreth 1.5 miliard Lekë, kryesisht si rezultat i ritmeve më të larta të ripagesave krahasuar me disbursimet si edhe për shkak të mbiçmimit të monedhës vendase në raport me monedhat e tjera që kompozojnë këtë portofol.

Grafiku 6: Portofoli i Garancive Shtetërore (2015–Shtator 2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Rikompozimi i më shumë se gjysmës së portofolit të garancive të emetuara në favor të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare (*KESH sh.a.*) nga linja huaje afatshkurtra në hua afatgjatë, ka zbutur ndjeshëm riskun e refinancimit të detyrimeve të kësaj kompanie, i cili mund të buronte nga risku sistematik i sektorit bankar ose ndryshimi i politikave investuese të bankave që kishin financuar linjat e huave. Rrjedhimisht, edhe risku i në buxhetin e qeverisë qendrore për materializimin e këtyre detyrimeve nga detyrime indirekte në detyrime të drejtpërdrejta është reduktuar.

Megjithatë, risku nga detyrimet kontigjente në buxhetin e shtetit vijon të jetë i konsiderueshëm, pasi më shumë se 80% e garancive shtetërore i përkasin sektorit të energjisë, duke e bërë buxhetin të ndjeshëm ndaj çdo risku që mund të paraqesë ky sektor.

Grafiku 7: Portofoli i Garancive shtetërore (2015 – Shtator 2019)

⁸ PBB mbi bazë vjetore, referuar të dhënave në “Kuatrin Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2020-2022”, miratuar me VKM Nr. 4, datë 09.01.2019”.



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Gjatë pjesës së mbetur të vitit 2019, niveli i garancive shtetërore në terma relativ ndaj PBB dhe ndaj totalit të stokut të borxhit pritet të qëndrojë pothuajse në të njëjtat nivele.

9. SHTOJCA ILUSTRUESE

9.1 ZHVILLIMET FISKALE GJATË 9-MUJORIT 2019

Të ardhurat totale të buxhetit për 9 mujorin 2019, u realizuan 98%, ose 7,8 miliard lekë më pak. Nga 351,4 miliard lekë të planifikuara, janë arkëtuar 343,5 miliard lekë.

Nga totali i të ardhurave, të ardhurat e arkëtuara nga “tatimet dhe doganat” (përfshirë kontributet e mbledhura nga DPT) për 9 mujorin 2018, u realizuan rreth 98 %, në vlerë 301.3 miliardë lekë, nga 308,5 miliard lekë të planifikuara. Rritja krahasuar me vitin 2018 është +3.7% ose 10.8 miliardë lekë.

Tabela 9 Performanca Tatime+Dogana dhe Kontributet Janar-Shtator 2019 (në milionë lekë)

Lloji i taksave	Fakt 9M 2019	Plan 9M 2019	Diferenca Fakt/Plan 2019	
			në vlerë	në %
1. TVSH Neto TOTAL	100,718	110,778	10,060	-9.1%
<i>a. Tvsh në import</i>	79,405	82,569	-3,164	-3.8%
<i>b. Tvsh brenda vendit Neto</i>	21,313	28,209	-6,896	-24.4%
<i>c. Rimbursim TVSH</i>	14,502	14,500	2	0.0%
2. Tatimi mbi fitimin	27,173	24,649	2,524	10.2%
3. Akciza	34,891	35,738	-847	-2.4%
4. Tatimi mbi të ardhurat personale	37,392	31,531	5,861	18.6%
5. Taksat Nacionale Total	26,389	30,740	-4,351	-14.2%
<i>a. Taksat nacionale</i>	24,635	28,617	-3,982	-13.9%
<i>b. Renta Minerare ne eksport</i>	1,754	2,123	-369	-17.4%
6. Taksë doganore	4,804	5,394	-590	-10.9%
TOTAL TATIME + DOGANA	231,367	238,830	-7,463	-3.1%
7. Kontributet e mbledhura (DPT)	69,935	69,708	227	0.3%


TOTAL DPD + DPT (Kontributet)	301,302	308,538	-7,236	-2.3%
--	----------------	----------------	---------------	--------------

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në performancën e 9 mujorit kundrejt planit janë:

- Rënia e kursit të këmbimit të monedhës vendase ndaj monedhës USD dhe EURO, ka dhënë efekte në uljen e të ardhurave nga TVSH-ja e importeve për 9 mujorin rreth 1,9 miliard lekë.
- Përfshirja e imputeve dhe makinerive dhe pajisjeve bujqësore ka reduktuar të ardhurat e 9 mujorit për rreth 1,3 miliard lekë.
- Rënia e cmimeve të metaleve dhe naftës në tregjet ndërkombëtare me efekt 1 miliard lekë në të ardhurat nga renta dhe TVSH-ja për periudhën janar-shtator
- Rritja e rimbursimit të TVSH-së me 4 miliard më shumë krahasuar me 9 mujorin 2018,.

Grafiku 8 Performanca e të ardhurave tatimore dhe doganore (përfshirë kontributet) 2018/2019



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për 9-mujorin e vitit 2019, ka arkëtuar 120.8 miliardë lekë, nga 125,8 miliard lekë të programuara sipas planit para ndryshimeve me aktin normativ. Pra 5 miliard lekë më pak ose Krahasuar me vitin 2018, të ardhurat janë rritur +3 miliardë lekë ose 2.5%. Deficiti i krijuar me planin lidhet kryesisht me impaktin negativ të kursit të këmbimit dhe cmimeve të mallrave në bursat ndërkombëtare mbi të ardhurat doganore, duke sjellë vlera më të ulta të importit të taksuar, çka ka ndikuar në uljen e të ardhurave tatimore nga veprimtaria doganore.

Të ardhurat nga “TVSH”-ja në import janë realizuar në vlerën 79.4 miliardë lekë, 1.8% ose rreth 1.4 miliardë lekë më shumë se 9 mujori i vitit 2018 dhe realizim në masën 96.2% kundrejt planit të periudhës. Rënia e kursit të këmbimit të monedhave të huaja kundrejt monedhës vendase, ka dhënë efekte të ndjeshme negative në uljen e të ardhurave nga TVSH-ja në import për të gjitha kategoritë e mallrave.

Të ardhurat nga “Akciza” janë realizuar në vlerën 34.9 miliardë lekë, me realizim kundrejt planit në masën 97.6%. Ndikim ka pasur “Karburanti” (import+prodhim vendas), që rezultoi rreth 457,583 ton, me një rritje prej 25,504 ton ose +6% krahasuar me 9 mujorin e vitit 2018. Gjithashtu performancë pozitive si rezultat i rritjes së sasisë kanë shënuar: importi dhe prodhimi i “Birrës” +4%; importi i “Duhanit” +28%; importi i “Miellit dhe grurit” +17%. Deklarimi i prodhimit vendas të duhanit është rritur nga 15 ton në 23 ton të deklaruar në periudhën Janar-Shtator 2019.

Të ardhurat nga “Renta Minerare” në eksport janë realizuar në vlerën 1.75 miliardë lekë, 12.6% ose 254 milionë lekë më pak krahasuar me 9 mujorin e vitit 2018, dhe realizim në masën 82.6% kundrejt planit. Të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë ulur me 80 milionë lekë, si rezultat i rënies së sasisë së eksportuar me rreth 11 mijë ton dhe janë ulur me 39.6 milionë lekë si rezultat i rënies së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke sjellë ulje të rentës për njësi nga 3.62 lekë/ton në 3.43 lekë/ton. Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rënie në masën 88 milionë lekë për shkak të rënies së çmimit të mineraleve në tregjet ndërkombëtare me 20%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, dhe janë rritur me 40 milionë lekë për shkak të rritjes së sasisë së eksportuar me 10%, duke dhënë një efekt total -49 milionë lekë.

Të ardhurat nga “Taksa Doganore” janë realizuar në vlerën 4.8 miliardë lekë, me një realizim në masën 105.4% krahasuar me vitin 2018 dhe 89.1% me planin e periudhës.

Të ardhurat e mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (përfshirë kontributet) për 9 mujorin e vitit 2019 janë realizuar në vlerën 180.5 miliardë lekë, 7.9 miliardë lekë ose 4.6% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë dhe realizim të planit të 9 mujorit në masën 98.8%, ose -2,2 miliard lekë.

Të ardhurat nga TVSH-ja brenda vendit janë realizuar në vlerën 21.3 miliardë lekë, 22% ose 6 miliardë lekë më pak se 9 mujori i vitit 2018 dhe 24.4% ose 6.9 miliardë lekë më pak se plani janar shtator 2019. Rimbursimi i TVSH është realizuar në vlerën 14.5 miliardë lekë, 40% ose 4.2 miliardë lekë më shumë se 9-mujori i vitit 2018. Në performancën e TVSH-se kanë ndikuar edhe faktorë që nuk varen nga puna e administratës tatimore si (i) ulja e prodhimit të energjisë elektrike dhe rritja e importeve të saj cka ka ulur TVSH-në e brendshme dhe ka rritur TVSH në import 2,4 miliard lekë vetëm për 9 mujorin janar-shtator; (ii) ndryshimi i skemës së Projektit TAP nga furnizime me TVSH ne furnizime të përjashtuara.

Të ardhurat nga “Tatimi mbi Fitimin” janë realizuar në vlerën 27.2 miliardë lekë, 11.5% ose 2.8 miliardë lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar dhe realizim në masën 110.2% të planit. Rezultati pozitiv financiar i kompanive në vitin 2018, reflektoi rritjen e fitimit të tatueshëm dhe tatimit të paguar nga ana e tyre në vitin 2019. Situata pozitive në sektorin energjitik gjatë vitit 2018, ka lejuar kompanitë e këtij sektori që të paguajnë në Buxhetin e Shtetit edhe detyrimet e papaguara nga vitet e kaluara.

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale janë realizuar në vlerën 37.4 miliardë lekë, +34% ose 9.5 miliardë lekë më shumë se 9-mujori i vitit 2018 dhe +18.6% ose 5.9 miliardë lekë më shumë krahasuar me planin. Krahasuar me 9-mujorin e vitit të kaluar, të ardhurat nga të punësuarit e sektorit publik dhe sektorit privat, janë rritur ndjeshëm, përkatësisht me 9.1% dhe 5.2%, kjo si rezultat i rritjes së numrit të kontribuesve aktiv krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Efekt pozitiv ka dhënë edhe ndryshimi i normës së tatimit mbi dividendin nga 15 % në 8 %. U arkëtuan mbi 11 miliard lekë në këtë zë të ardhurash.

Të ardhurat nga “Taksat Nacionale” janë realizuar në vlerën 24.6 miliardë lekë, realizim në masën 83% ose 4 miliardë lek më pak se plani i këtij 9-mujori. Ndikim të ndjeshëm në këtë të ardhur ka dhe politika që është ndjekur me mbylljen e lojrave të fatit.

Të ardhurat nga “Kontributet e D.P.T-së” janë realizuar në vlerën 70 miliardë lekë, 6% ose 3.8 miliardë lekë më shumë se 9 mujori i vitit 2018 dhe 0.3% ose 227 milionë lekë më shumë se plani. Rezultati i lartë me rritje të qëndrueshme buron kryesisht nga situata pozitive ekonomike dhe rritja si rrjedhojë e numrit të të punësuarve. Nga ana tjetër aksioni antiinformalitet ka dhënë efekte të dukshme në formalizimin e tregut të punës.

9.2 TË ARDHURAT E PRITSHME PËR VITIN 2019

Të ardhurat totale të buxhetit të shtetit në fund të vitit 2019, pritet të jenë 474 miliardë lekë. Krahasuar me vitin 2018, rritja rezulton +5.34%, ose 24 miliardë lekë më shumë. Totali i të ardhurave në raport me PBB-në në fund të këtij viti rezulton 27.8%, nga 27.6 % që ishte në vitin 2018. Rritja me +0.2% të PBB-së e të ardhurave të buxhetit të shtetit, është tregues i konsolidimit fiskal, përmirësimit në mbledhjen e të ardhurave dhe forcimit të financave publike të vendit. Kjo rritje vjen kryesisht si nga impakti i rritjes ekonomike, ashtu edhe nga përmirësimi në administrimin e të hyrave të buxhetit, pavarësisht efekteve negative në këto të ardhura të faktorëve të tillë si efektet nga kursi i këmbimit, ulja e prodhimit të energjisë elektrike, rënia e cmimeve të bursës për një sërë mineralesh etj.

Të ardhurat fiskale që administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, pritet të realizohen në nivelin 97.3%. Të ardhurat e arkëtuara nga administrata fiskale janë rritur +4,12 %, ose, 16,2 miliard lekë krahasuar me vitin 2018.

(në milionë lekë)

Lloji i taksave	Plani Vjetor	I Pritshmi 2019	Diferenca Plan/I Pritshem	Në %
1. TVSH Neto TOTAL	153,313	140,218	(13,095)	-8.5%
a. Tvsh në import	114,813	109,405	(5,408)	-4.7%
b. Tvsh brenda vendit Neto	38,500	30,813	(7,687)	-20.0%
c. Rimbursim TVSH	19,000	19,010	10	0.1%
2. Tatimi mbi fitimin	33,500	35,173	1,673	5.0%
3. Akciza	48,300	47,691	(609)	-1.3%
4. Tatimi mbi të ardhurat personale	41,900	47,892	5,992	14.3%
5. Taksat Nacionale Total	41,200	36,389	(4,811)	-11.7%
a. Taksat nacionale	38,400	33,965	(4,435)	-11.5%
b. Renta Minerare ne eksport	2,800	2,424	(376)	-13.4%
6. Taksë doganore	7,392	6,604	(788)	-10.7%
TOTAL TATIME + DOGANA	325,605	313,967	(11,638)	-3.6%
7. Kontributet e mbledhura (DPT)	94,570	94,935	365	0.4%
TOTAL DPD + DPT (Kontributet)	420,175	408,902	(11,273)	-2.7%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Pritshmëria e të ardhurave nga Administrata Doganore

Të ardhurat e pritshme për vitin 2019, janë vlerësuar mbi bazën e performancës së të ardhurave në periudhën Janar-Shtator 2019 si dhe të faktorëve që do të ndikojnë në muajt në vijim.

(në milionë lekë)

Lloji i taksave	Plani Vjetor	I Pritshmi 2019	Diferenca Plan/Pritshem 2019	Në %
1. Tvsh në import	114,813	109,405	(5,408)	-4.7%
2. Akciza	48,300	47,691	(609)	-1.3%
3. Renta Minerare ne eksport	2,800	2,424	(376)	-13.4%
4. Taksë doganore	7,392	6,604	(788)	-10.7%
TOTAL DOGANA	173,305	166,124	(7,181)	-4.1%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Performanca e të ardhurave nga TVSH në import është ndikuar në një masë të rëndësishme nga disa faktorë:

- Rënia e kursit të këmbimit të monedhës EURO kundrejt Lekut. Ky faktor ka krijuar efekte negative në të ardhurat nga TVSH-ja për mallrat e importit. Vetën për periudhën 9 mujore Janar-Shtator, ky efekt negativ në të ardhurat e TVSH-së për mallrat e importit ka qënë -1.9 miliard lekë, ndërkohë që efekti i pritshëm vjetor pritet të jetë -2.5 miliard lekë.

- Rënie e cmimeve të metaleve dhe naftës në tregjet ndërkombëtare me efekt 1 miliard lekë për periudhën janar-shtator dhe efekt të pritshëm vjetor 1,3 miliard lekë.
- Heqja e TVSH-së për imputet dhe makineritë bujqësore me efekt 1,2 miliard lekë për periudhën janar-shtator dhe efekt të pritshëm vjetor 1,5 miliard lekë.

Performanca e të ardhurave nga Akciza

Në zërin e akcizave, në periudhën janar-shtator, janë arkëruar 47,7 miliard lekë, 98,7 % e programit të periudhës. Deri në fund të vitit 2019, programi i të ardhurave pritet të realizohet rreth 99 %.

Ecuria e 9 mujorit dhe perspektiva deri në fund të vitit ndikohet nga disa faktorë:

- Cigare për konsum, objekt akcize është rritur 6,2 % ose 132 ton krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Pritshmëria është që të realizohet objektivi vjetor I programuar.
- Karburante për konsum, objekt akcize është rritur 4,2 % ose 19 mije ton krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Edhe në karburante pritshmëria është që të realizohet objektivi vjetor i programuar.
- Gjatë periudhë janar-shtator është rimbursuar apo përjashtuar 1,85 miliard lekë akcize për përfitues sipas ligjit, nga të cilat 1,2 miliard akcizë lekë është rimbursuar për serat me ngrohje, 410 milion lekë më shumë se në vitin 2018. Rimbursimi i akcizës pritet të rritet në muajt në vijim.

Të ardhurat nga Renta Minerare në eksport për vitin 2019 pritet të shënojë vlerën 2.4 miliardë lekë, 376 milion lekë më pak, në nivel realizimi 86.6% kundrejt planit. Të ardhurat nga renta minerare për naftën bruto janë ulur si rezultat i rënies së sasisë së eksportuar, si dhe si rezultat i rënies së çmimit të naftës bruto në tregjet ndërkombëtare krahasuar me projeksionet për vitin 2019, duke sjellë rënie të rentës për njësi nga 3.62 lekë/ton në 3.42 lekë/ton. Ndërkohë, të ardhurat nga mineralet e eksportuara kanë pësuar rënie për shkak të rënies së çmimit të mineraleve në tregjet ndërkombëtare, e cila nuk është kompensuar nga rritja e sasisë së eksportuar me 146 mijë ton.

Të ardhurat nga Taksa Doganore parashikohet të realizohen për 12-mujorin 2019 në masën 6.6 miliardë lekë ose në masën 90.3% ndaj planit si dhe një rritje e pritshme 387 milionë ose 6.2% krahasuar me faktin e vitit 2018.

Pritshmëria e të ardhurave nga Administrata Tatimore

Të ardhurat e pritshme për vitin 2019 janë vlerësuar mbi bazën e performancës gjatë periudhës Janar-Shtator 2019, si dhe të faktorëve që do të ndikojnë në muajt në vijim.

(në milionë lekë)

Lloji i taksave	Plani Vjetor	I Pritshmi 2019	Diferenca Plan/ I Pritshem 2019	Në %
1. Tvsh brenda vendit Neto	38,500	30,813	(7,687)	-20.0%
Rimbursim TVSH	19,000	19,010	10	0.1%
2. Tatimi mbi fitimin	33,500	35,173	1,673	5.0%
3. Tatimi mbi të ardhurat personale				14.3%

	41,900	47,892	5,992	
4. Taksat nacionale	38,400	33,965	(4,435)	-11.5%
TOTAL TATIME	152,300	147,843	(4,457)	-2.9%
5. Kontributet e mbledhura (DPT)	94,570	94,935	365	0.4%
TOTAL DPT + Kontributet	246,870	242,778	(4,092)	-1.7%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Të ardhurat nga Tatimi mbi Vlerën e shtuar brenda vendit pritet të realizohen në masën 30.8 miliardë lekë, 80% kundrejt planit. Në total, Administrata Tatimore pritet të arkëtojë në buxhet në vitin 2019 rreth 49,8 miliard lekë, nga 50,9 miliard lekë të arkëtuara në vitin 2018. Krahasuar me vitin 2018, rimbursimi i TVSH-se rritet 32 % ose +4,6 miliard lekë. Ulja e të ardhurave nga TVSH-ja e brendshme lidhet edhe me dy faktorë të rëndësishëm:

- Ulja e prodhimit të energjisë elektrike dhe rritja e importeve të saj cka ka ulur TVSH-në e brendshme dhe ka rritur TVSH në import 2,4 miliard lekë vetëm për 9 mujorin janar-shtator
- Ndryshimi i skemës së Projektit TAP nga furnizime me TVSH ne furnizime të përjashtuara.

Të ardhurat nga Tatimi mbi Fitimin pritet të realizohen në masën 35.2 miliardë lekë, 1.7 miliardë lekë ose 5% më shumë se plani vjetor i parashikuar. Rezultati pozitiv financiar i kompanive në vitin 2018, reflektoi rritjen e fitimit të tatueshëm dhe tatimit të paguar nga ana e tyre në vitin 2019. Vecanërisht, situata pozitive e sektorit energjistik gjatë vitit 2018, ka lejuar kompanitë e këtij sektori që të paguajnë në Buxhetin e Shtetit gjatë vitit 2019, jo vetëm tatimin mbi fitimin e vitit 2018, por edhe një pjesë të detyrimeve të papaguara nga vitet e kaluara.

Tatimi mbi të Ardhurat Personale pritet të realizohet 47.9 miliardë lekë, +6 miliardë lekë ose 14.3% mbi planifikimin. Të ardhurat e të punësuarve në sektorin publik e privat janë rritur përkatësisht me 9.1% dhe 5.2% kjo si rezultat i rritjes së numrit të të punësuarve dhe nivelit të pagës. Ulja e normës së tatimit mbi dividendin nga 15 % në 8 %, ka gjeneruar në buxhetin e shtetit mbi 11 miliard lekë të ardhura, nga 3,5 miliard lekë që janë arkëtuar si dividend në vitin 2018.

Të ardhurat nga Taksa Nacionale pritet të realizohen në masën 34 miliardë, -4.4 miliardë lekë ose 11.5% më pak se programi. Ndikim në uljen e të ardhurave nga taksat krahasuar me periudhat papaardhëse ka patur mbyllja e pjesës dermuese të lojrave të fatit.

Të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore që mblihen nga administrata tatimore priten të realizohen në masën 95 miliardë lekë, +365 milionë lekë ose 0.4% më shumë se parashikimi. Krahasuar me vitin 2018, të ardhurat nga kontributet rriten me 7%. Në total, së bashku me pjesën që mbledhin ISSH dhe ISKSH janë arkëtuar 98 miliard lekë kontribute. Rezultatet me rritje të qëndrueshme në arkëtimin e kontributeve janë pasojë e përmirësimeve në luftën kundër informalitetit dhe punës së zezë, cka ka rritur numurin e të punësuarve.

Krahasimi me vitin 2018 për të Ardhurat Doganore, Tatimore dhe Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore

Viti 2019 pritet të mbyllet me një performancë pozitive në të ardhura, duke shënuar një rritje me 16,2 miliardë lekë, ose +4,12 % kundrejt vitit 2018. Rritja e të ardhurave reflekton rritjen ekonomike reale, impaktin e reformave strukturore dhe luftës ndaj informalitetit. Nëse nuk do të kishim efekte negative në të ardhurat tatimore nga efektet e kursit të këmbimit dhe ulja e cmimeve në bursat ndërkombëtare, rritja e të ardhurave do të ishte mbi 20 miliard lekë.

- Të ardhura nga TVSH-ja pritet të jenë -3 miliardë lekë ose -2% kundrejt vitit 2018.
- Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin, pritet të jenë 725 milionë lekë, ose +2.1% kundrejt vitit 2018.
- Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale, pritet të jenë +11.5 miliardë lekë, ose +31.6% krahasuar me vitin 2018.
- Të ardhurat nga akciza pritet të jenë +2.7 miliardë lekë ose +6% kundrejt vitit 2018.
- Të ardhurat nga taksat nacionale dhe të tjera pritet të jenë -2.1 miliardë lekë ose -5.7% kundrejt vitit 2018.
- Të ardhurat nga taksa doganore pritet të jenë +387 milionë lekë ose +6.2% kundrejt vitit 2018.
- Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore pritet të jenë +6.1 miliardë lekë ose +6.9% krahasuar me vitin 2018.

(në milionë lekë)

Lloji i taksave	I Pritshmi 2019	Fakt 2018	Diferenca i pritshem 2019/Fakt 2018	Në %
1. TVSH Neto TOTAL	140,218	143,526	(3,308)	-2.3%
a. Tvsh në import	109,405	107,157	2,248	2.1%
b. Tvsh brenda vendit Neto	30,813	36,369	(5,556)	-15.3%
c. Rimbursim TVSH	19,010	14,394	4,616	32.1%
2. Tatimi mbi fitimin	35,173	34,448	725	2.1%
3. Akciza	47,691	44,986	2,705	6.0%
4. Tatimi mbi të ardhurat personale	47,892	36,404	11,488	31.6%
5. Taksat Nacionale Total	36,389	38,579	(2,190)	-5.7%
a. Taksat nacionale	33,965	35,961	(1,996)	-5.6%
b. Renta Minerare ne eksport	2,424	2,618	(194)	-7.4%
6. Taksë doganore	6,604	6,217	387	6.2%
TOTAL TATIME + DOGANA	313,967	304,160	9,807	3.2%
7. Kontributet e mbledhura (DPT)	94,935	88,829	6,106	6.9%
TOTAL DPD + DPT (Kontributet)	408,902	392,989	15,913	4.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

9.3 ANALIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2019

9.3.1 BUXHETI QENDROR

Shpenzimet e përgjithshme publike për muajin e nëntë të vitit 2019, arritën në rreth 345.8 miliard LEK me një realizim në masën 96.4 përqind të planit të periudhës. Ndërkohë që, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë ka rezultuar 6.1 përqind më i lartë ose rreth 19.85 miliard LEK më shumë. Në terma vjetor, shpenzimet e përgjithshme për 9 mujorin e vitit 2019 u realizuan në masën 66.6 përqind të planit vjetor.

Grafiku 9: Shpenzimet e përgjithshme korrente dhe kapitale (miliardë lekë) dhe ritmi i rritjes për periudhën 9 mujore (në %)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

a. Shpenzimet sipas natyrës ekonomike

Shpenzimet korente dhe ato kapitale, kanë shënuar një realizim respektivisht:

- ✓ Shpenzimet korente 100.1 përqind të planit të periudhës dhe 71.4 përqind të planit vjetor.
- ✓ Shpenzimet kapitale 78.7 përqind të planit të periudhës dhe 45.7 përqind të planit vjetor.

Grafiku 10: Shpenzimet korente dhe kapitale fakt dhe plan 9 mujor (në milionë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Shpenzimet korente për periudhën 9 mujore të vitit 2019 rezultuan në rreth 304.3 miliard LEK, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ky zë ka rezultuar 8.1 përqind më i lartë ose rreth 22.9 miliard LEK më shumë. Shpenzimet korente për muajin e nëntë të vitit 2019 zënë 88 përqind të totalit të shpenzimeve ndërkohë që krahasuar me PBB zënë 17 përqind. Për shpenzimet korente, për periudhën 9 mujore ndër vite, raporti kundrejt PBB ka një nivel mesatar prej 17 përqind.

Shpenzimet kapitale për muajin e nëntë të vitit 2019 paraqesin një realizim në masën rreth 41.4 miliard LEK. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë është 6.9 përqind më i ulët ose rreth 3.1 miliard LEK më pak. Shpenzimet kapitale për muajin e nëntë të vitit 2019 zënë 12 përqind të totalit të shpenzimeve ndërkohë që krahasuar me PBB zënë 2.4 përqind. Për shpenzimet kapitale, për periudhën 9 mujore ndër vite, raporti kundrejt PBB ka një nivel mesatar prej 3.1 përqind.

Grafiku 11: Struktura e shpenzimeve të përgjithshme dhe raporti me PBB-në për periudhën 9 mujore




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Shpenzimet korente në raport me planin 9 mujor të këtij viti, paraqesin një realizim prej 100.1 përqind, duke rezultuar në rreth 304.3 miliard LEK. Zërat kryesorë që ndikuan në nivelin e realizimit të shpenzimeve korente, kundrejt planit 9 mujor janë përkatësisht:

- ✓ *Shpenzimet për Subvencione arritën në nivelin 787 milion LEK ose 146.8 përqind të planit të periudhës dhe 52.8 përqind të planit vjetor.*
- ✓ *Shpenzimet e tjera sociale me 107.5 përqind të planit të periudhës dhe 76.5 përqind të planit vjetor.*
- ✓ *Shpenzimet për buxhetin vendor me 105.3 përqind të planit të periudhës dhe 82.5 përqind të planit vjetor.*

Grafiku 12: Struktura e shpenzimeve korente (milionë lekë)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Shpenzimet e Personelit gjatë muajit Shtator 2019, përfaqësuan 18.8 përqind të totalit të shpenzimeve korente. Niveli i shpenzimeve faktike të personelit prej rreth 57.2 miliard LEK, realizon nivelin e

parashikuar për këtë zë në planin e periudhës 9 mujore, në masën 98 përqind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë është 4.4 përqind më i lartë ose rreth 2.4 miliard LEK më shumë.


Grafiku 13: Shpenzimet e Personelit dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Shpenzimet për Interesa gjatë periudhës 9 mujore 2019 kanë përfaqësuar 8.3 përqind të shpenzimeve korente. Niveli faktik i tyre prej rreth 25.4 miliard lekë ka rezultuar në masën 97.5 përqind të planit të periudhës. Në raport me planin vjetor, në nivel 9 mujori këto shpenzime janë realizuar në masën 60.9 përqind të tij. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë ka rezultuar 8.8 përqind më i lartë ose 2.05 miliard LEK më shumë.


Grafiku 14: Shpenzimet për Interesa (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Shpenzimet Operative & Mirëmbajtje, gjatë periudhës 9 mujore të vitit 2019 kanë shënuar një realizim në masën rreth 32 miliard LEK ose 104.5 përqind të planit të periudhës. Niveli faktik i tyre ka rezultuar në masën 68.3 përqind të planit vjetor. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ky zë ka rezultuar 11.3 përqind më i lartë ose rreth 3.2 miliard LEK më shumë.


Grafiku 15: Shpenzimet Operative e Mirëmbajtje dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Shpenzimet për Subvencione, në fund të muajit të nëntë të vitit 2019, arritën nivelin 787 milion LEK, me një realizim në masën 146.8 përqind të planit të periudhës ose 251 milion LEK më shumë në terma nominale. Në raport me planin vjetor ky zë është realizuar në masën 52.8 përqind, ndërkohë që kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018 shpenzimet për subvencione rezultojnë 27.9 përqind më të larta ose 171 milion LEK më shumë.

Grafiku 16: Shpenzimet për Subvencione dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard LEK)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Shpenzimet për Fondet Speciale për muajin e nëntë të vitit 2019 rezultuan në nivelin rreth 128.2 miliard LEK, me një realizim prej 97.8 përqind kundrejt planit të periudhës. Përkatësisht:

- shpenzimet për sigurime shoqërore u realizuan në masën rreth 95.9 miliard LEK,
- shpenzimet për sigurime shëndetësore në rreth 30.7 miliard LEK dhe
- shpenzimet për kompensimin e pronarëve në rreth 1.66 miliard LEK.

Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018, shpenzimet për sigurime shoqërore janë 5.5 miliard LEK më të larta, shpenzimet për sigurime shëndetësore janë 1.9 miliard LEK më të larta, ndërsa shpenzimet për kompensimin e pronarëve 121 milion LEK më të ulëta.

Grafiku 17: Shpenzimet për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)


Shpenzimet për Papunësinë për 9 mujorin e vitit 2019 janë realizuar në masën 130.6 përqind e planit të periudhës ose 77.8 përqind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 59.3 përqind, ose 145 milion LEK më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike dhe Pagesën e Paaftësisë (PAK) për periudhën 9 mujore të vitit 2019 u realizuan në masën rreth 15.3 miliard LEK duke rezultuar 103.6 përqind e planit të periudhës ose 536 milion LEK më shumë në terma nominalë. Në raport me planin vjetor ato janë realizuar në masën 74.7 përqind të tij. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 6.7 përqind ose 962 milion LEK më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për kompensimin e ish-të përndjekurve politik për periudhën 9 mujore të vitit 2019 u realizuan në masën 992 milion LEK duke rezultuar 406 milion LEK më shumë se plani i periudhës. Në raport me planin vjetor ato janë realizuar në masën 99.2 përqind të tij, për shkak të ecurisë pozitive të shqyrtimit të dosjeve dhe realizimit të pagesave përkatëse. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018 shpenzimet për këtë zë rezultojnë me një rritje në masën 768 milion LEK më shumë në terma nominalë.

Shpenzimet për bonusin e lindjeve për periudhën 9 mujore të vitit 2019 u realizuan në masën 1.65 miliard LEK duke rezultuar 117.6 përqind e planit të periudhës ose 247 milion LEK më shumë në terma nominalë. Në raport me planin vjetor ato janë realizuar në masën 82.5 përqind të tij.


Grafiku 18: Shpenzimet për Ndihmën Ekonomike, PAK dhe Papunësinë (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Shpenzimet për Pushtetin Vendor, gjatë periudhës 9 mujore të vitit 2019 kanë arritur në masën rreth 42.3 miliard LEK duke përbërë 13.9 përqind të shpenzimeve korente. Kundrejt të njëjtës periudhë të vitit 2018 ky nivel rezulton 11 përqind më i lartë ose rreth 4.2 miliard LEK më shumë.


Grafiku 19: Shpenzimet e Pushtetit Vendor dhe ritmi i rritjes së tyre (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Shpenzimet kapitale, për muajin e nëntë të vitit 2019 kanë një realizim në masën rreth 41.4 miliard LEK ose 78.7 përqind në raport me fondet e planifikuara për këtë periudhë. Respektivisht, projektet e investimeve me financim të brendshëm kanë shënuar një realizim në masën rreth 29.2 miliard LEK duke rezultuar 91.4 përqind krahasuar me planin e periudhës ose 2.74 miliard LEK më pak, ndërkohë që ato me financim të huaj kanë shënuar një realizim në masën rreth 11.7 miliard LEK duke rezultuar 58.6 përqind krahasuar me planin e periudhës ose rreth 8.27 miliard LEK më pak në terma nominalë. *Krahasuar me planin vjetor*, për 9 mujorin e vitit 2019 është konstatuar një realizim i përgjithshëm i investimeve publike në masën 45.7 përqind të planit vjetor. Financimi i brendshëm dhe financimi i huaj janë realizuar respektivisht në masën 51.3 përqind dhe 35.9 përqind të planit vjetor.

Grafiku 20: Shpenzimet Kapitale dhe burimi i financimit të tyre (në miliard LEK)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)


9.3.2 BUXHETI VENDOR

ANALIZA E SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2019

❖ Të ardhurat e Pushtetit Vendor

Për 9 mujorin e parë të vitit 2019, njësitë e vetëqeverisjes vendore në nivel kombëtar kanë mbledhur të ardhura (tatimore dhe jo-tatimore) në masën e rreth 19 miliard lekë dhe krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë janë 3.4 miliard lekë më shumë ose 22 për qind më e lartë. Në mënyrë krahasimore në tabelën e mëposhtme paraqiten nivelet e të ardhurave sipas taksave për të njëjtën periudhë për disa vite.

Grafiku 21: Të ardhurat sipas burimit për njësitë vendore




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

Të ardhurat e qeverisjes vendore ndër vite kanë pësuar ndryshime si në vlerë ashtu dhe në strukturë. Taksat lokale gjenerojnë pjesën më të madhe të të ardhurave vendore me rreth 76% të vlerës totale të tyre. Kjo konfirmon edhe një herë që procesi i decentralizimit kryesisht në vitin 2016 e pas ka dhënë një efekt shumë pozitiv duke bërë që njësitë e vetëqeverisjes vendore të mbledhin më shumë të ardhura dhe sigurisht të ofrojnë më shumë shërbime dhe investime publike nga të ardhurat që ato vetë gjenerojnë. Pas kësaj takse pjesën më të madhe të të ardhurave e zënë ato që vijnë nga taksat mbi pasurinë, afërsisht rreth 4.2 miliard lekë ose 22 % të totalit të të ardhurave.

Parë në këtë këndvështrim, rritja e efektshmërisë së mbledhjes së taksave nga qeverisja vendore bën të mundur që njësitë të sigurojnë një nivel më të lartë decentralizimi dhe burimesh financiare për të ofruar shërbime dhe investime më të mira vendore. Nëse do të referohemi zërave të të ardhurave në raport me 9 mujorin e një viti më parë konstatojmë që në raport me të njëjtën periudhë të një viti më parë kemi një rritje më të madhe në të gjithë zërat e të ardhurave, si në taksat vendore ashtu edhe në atë të biznesit të vogël. Në raport me një vit më parë taksat e pasurisë ka qëndruar pothuajse në të njëjtin nivel, duke mos reflektuar ndryshime. Nga ana tjetër vihet re qëndrueshmëria e rritjes së taksave vendore përgjatë 9 mujorit të viteve të ndryshme duke siguruar një vlerë në rreth 3.4 miliard lekë. Taksa e biznesit të vogël nuk ka peshë të lartë në të ardhurat vendore prandaj edhe efekti nuk ka ndikim në ecurinë fiksale të pushtetit vendor për 9 mujorin e vitit 2019. Vlen të theksohet fakti që reforma në taksën e pasurisë për vitin 2019 nuk ka patur ndryshime të mëdha dhe si rrjedhim kontributi i këtij burimi të të ardhurave vendore nuk është rritur për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Sigurisht ndryshime deri në fund të vitit pritet të ketë edhe në rritjen e të ardhurave nga taksat vendore, të ardhura këto që zënë një pjesë të ndjeshme të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Rritja e të ardhurave nga taksat vendore përbën

një hap të madh në drejtim fortësimit të aftësisë së NJVQV-ve për të zhvilluar kompetencat e përcaktuara me ligj.

Grafiku 22: Të ardhurat totale nga pushteti vendor




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

Nga analiza 9 mujore konstatohet që, në tërësi qeverisja vendore ka rritur peshën e të ardhurave të veta vendore në raport me të ardhurat në tërësi. Rritja e të ardhurave të veta lokale është tregues thelbësor i faktit që rritja e autonomisë dhe decentralizimit fiskal ka rritur përgjegjësinë dhe efektshëmërinë e ushtrimit të funksioneve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, kjo rritje në të ardhurat vendore është tregues i performancës në rritje fiskale të pushtetit vendor i cili tashmë ka hyrë në një fazë të re të menaxhimit financiar në nivel vendor. Nga ana tjetër ndërtimi i kadastrës fiskale dhe reforma në taksën e pasurisë, është një tregues që tashmë nga ky burim do të pritët rritje e të ardhurave në mënyrë progresive nga viti në vit për vitet në vazhdim.

- *Taksa mbi Pasurinë*

Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të pushtetit vendor ose ndryshe rreth 22% të të ardhurave vendore. Për 9 - mujorin e vitit 2019 kjo taksë është mbledhur në vlerën 4.2 miliardë lekë, ose rreth 35 milion lekë më pak 9 - mujori i vitit 2018. Parë në këndvështrimin e efikasitetit, nga mbledhja e kësaj takse konstatohet një rënie e lehtë e nivelit të taksës së pasurisë në raport me një vit më parë oer rreth 33 milion lekë. Rritja e të ardhurave nga ky burim do ti sigurojë pushtetit vendor konsolidimin e një burimi të rëndësishëm të të ardhurave dhe sigurisht një mundësi më të madhe për të zhvilluar investime publike në nivel vendor. Rritja e peshës që zënë të ardhurat nga taksa e pasurisë në totalin e të ardhurave të veta të NJVQV-ve përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të konsolidimit financiar në nivel vendor.

Grafiku 23: Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

- *Taksa e biznesit të vogël*

Të ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogël, për 9 mujorin e vitit 2019 janë realizuar në masën 328 milionë lekë, shifër kjo që vjen me një rritje me rreth 11 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ulja e të ardhurave në raport me vitin 2015 vjen si rezultat i ndryshimeve ku subjektet me një xhiro nga 0-5 milionë lekë janë përjashtuar nga detyrimi tatimor ndërsa ato me xhiro 5-8 milionë kanë përfituar një reduktim me 2.5% të detyrimit, ndryshime të cilat kanë ndikuar pozitivisht në përmirësimin e klimës së biznesit. Megjithatë këto ndryshime u shoqëruan me masa për kompensimin e këtyre të ardhurave për qeverisjen vendore. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë në 9 mujorin e vitit 2019 janë realizuar rreth 33 milion lekë të ardhura më shumë nga taksa e biznesit të vogël. Ky burim i të ardhurave vendore zë një peshë të të vogël në raport me burimet e tjera të të ardhurave vendore, duke dhënë ndikim relativisht të vogël.

Grafiku 24: Të ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogël




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

- *Taksa lokale*

Të ardhurat nga taksat lokale vazhdojnë të konsolidojnë trendin në rritje jo vetëm krahasuar me një vit më parë por që pas reformës administrative territoriale. Për 9 - mujorin 2019 këto taksa janë mbledhur në vlerën rreth 14.5 miliardë lekë, ose rreth 3.4 miliardë lekë më shumë se një vit më parë ose ndryshe rreth 31% më shumë. Rritja e kapaciteteve të krijuara nga njësitë e reja dhe kontrolli më i mirë i shtrirjes territoriale ka rritur mbledhshmërinë e këtyre taksave duke ndikuar pozitivisht në qëndrueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu, rritja e të ardhurave nga ky burim dhe fakti që përbëjnë peshën më të madhe të të ardhurave vendore tregon qartë rritjen cilësore në drejtim të decentralizimit fiskal të pushtetit vendor.

Grafiku 25: Të ardhurat nga taksat lokale



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);


❖ Shpenzimet e qeverisjes vendore

Shpenzimet e qeverisjes vendore janë një tregues i rëndësishëm i procesit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor dhe tendencave zhvillimore të ekonomisë në tërësi. Rritja e peshës së shpenzimeve të pushtetit vendor në raport me shpenzimet që zënë shpenzimet e buxhetit qendror ndaj produktit të brendshëm bruto përbëjnë një tregues të rëndësishëm të përpjekjes për thellimin e decentralizimit fiskal vendor. Ndër vite shpenzimet e qeverisjes vendore janë një tregues në rritje dhe kjo vjen si pasojë e rritjes së nivelit të shërbimeve dhe funksioneve që qeverisja vendore ofron për qytetarët e saj të financuara nëpërmjet rritjes së të ardhurave vendore dhe mbështetjes financiare nga qeveria qendrore. Rritja e kompetencave dhe hapësirës administrative ka bërë që tashmë njësitë e vetëqeverisjes vendore të rrisin përgjegjësinë, transparencën konsultimin publik, si dhe llogaridhënien në përdorimin e financave publike vendore.

Buxheti vendor ndër vite ka një rritje të dukshme që vjen si rrjedhojë e decentralizimit fiskal në aspektin e mbledhjes dhe përdorimit në mënyrë autonome të të ardhurave dhe rritjes së transfertave buxhetore nga qeveria qendrore. Kjo reflektohet edhe në nivelin e shpenzimeve për 9 mujorin e vitit 2019, në raport me atë të vitit 2018. Nga grafiku i mëposhtëm evidentohet qartë që buxheti i qeverisjes vendore tashmë është drejt konsolidimit duke mos paraqitur luhatje të konsiderueshme dhe jo të logjikshme por vjen lehtësisht

me me rritje me një vit më parë. Viti 2019 për financat vendore e konsiderohet si viti i qëndrueshmërisë fiskale në kënvështrimin e menaxhimit të plotë pas periudhës tranzitore të reformës territoriale por gjithashtu edhe nën kuadrin e ri ligjor e nënligjor për menaxhimin financiar vendor. Në tërësi, të gjithë zërat e buxhetit vendor kanë patur rritje në raport me 9 mujin e vitit 2018, kjo tregon që tashmë njësitë e vetëqeverisjes vendore po shikojnë me prioritet rritjen e investimeve publike por gjithashtu edhe cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.


Grafiku 26: Shpenzimet për pushtetin lokal dhe ritmi i rritjes së tyre



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

Shpenzimet e pushtetit vendor sipas zërave kanë pësuar luhajtje të ndjeshme në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018. Duke ju referuar grafikut të mësipërm, konstatohet se në raport me 9 mujin e vitit 2018 kemi një ndryshim në rritje prej 2.4 miliard lekë të shpenzimeve kapitale shifër kjo e konsiderueshme për strukturën e shpenzimeve të qeverisjes vendore. Gjithashtu, konstatohet që në vitin 2019 shpenzimet e personelit kanë pësuar një rritje të lehtë në raport me një vit më parë me rreth 835 milion lekë më shumë, rritje kjo e cila nuk ka një ndikim të ndjeshëm në strukturën e shpenzimeve. Tashmë shpenzimet e personelit kanë marrë një natyrë të qëndrueshme në vite, tregues ky që reflekton mbylljen e periudhës tranzitore të konsolidimit të njësisë të reja vendore. Gjatë 9 mujit të vitit 2019 konstatohet rritje në zërin shpenzime operative të pushtetit vendor në raport me një vit më parë, kjo rritje vjen kryesisht si rrjedhim i nevojës për mirëmbajtje të investimeve të kryera nga njësitë vendore në vitet e mëparshme. Qëndrueshmëria e shpenzimeve për investime tregon qartë që shumë shpejt kjo do të shoqërohet me efekte të drejtpërdrejta pozitive në punët publike dhe cilësinë e shërbimeve të cilat ndikojnë në jetën e qytetarëve. Njësitë e vetëqeverisjes vendore tashmë janë më të përgjegjshme si në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve që ofrojnë por edhe të volumit të punëve publike të cilat ato duhet të kryejnë për përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Grafiku 27: Shpenzimet e qeverisjes vendore sipas strukturës ekonomike



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

Pas miratimit dhe jetësimit të reformës administrativo-territoriale janë bërë analiza periodike të ecurisë së shpenzimeve vendore në raport me shpenzimet para reformës, kryesisht në termat e tendencës së shpenzimeve të personelit dhe atyre kapitale. Krahasuar me vitin 2014, si vit para reformës konstatohet se ka një ndryshim të strukturës së shpenzimeve në favor të rritjes së shpenzimeve kapitale. Gjithashtu shpenzimet nga viti në vit konsolidohen në raport me formën ekonomikë të cilat ato përdoren duke reflektuar në këtë mënyrë përmirësimin e menaxhimit financiar në nivel vendor. Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur tabela e ndryshimeve të të ardhurave dhe shpenzimeve në financat publike vendore midis të njëjtës periudhë të vitit 2019 dhe 2018.

Tabela 10: Të ardhurat dhe shpenzimet e qeverisjes vendore sipas natyrës

Të dhëna progresive (në milion LEK)

Nr	E M Ë R T I M I	Fakt 9 mujsori		Diferenca	
		2019	2018	2019 / 2018	% e 2019 kundrejt 2018
I.	Të ardhura nga Pushteti vendor	18,998	15,585	3,414	122%
I.1	<i>Taksa mbi pasurinë</i>	4,191	4,224	-33	99%
I.2	<i>Taksa e biznesit të vogël</i>	328	296	33	111%
I.3	<i>Taksa Lokale</i>	14,479	11,065	3,414	131%
II.	Shpenzime nga Pushtetit Vendor	42,331	38,147	4,184	111%
II.1	Shpenzime Korente	28,245	26,474	1,771	107%
	<i>Personeli</i>	16,235	15,400	835	105%
	<i>Shpenzime Oper. Mirmbajtje</i>	11,036	10,284	752	107%
	<i>Interesa</i>	104	94	10	111%
	<i>Subvencione</i>	496	402	94	123%
	<i>Te tjera</i>	374	294	80	127%
II.2	Shpenzime Kapitale	14,086	11,673	2,413	121%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019);

Shpenzimet e Personelit, përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve totale të njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Për 9 mujsorin e vitit 2019, këto shpenzime janë realizuar në masën 16.2 miliard lekë ose rreth 835 milion lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2018. Rritja e lehtë e këtyre shpenzimeve për vitin 2019, argumentohet me faktin se në buxhetin e vitit 2019, u konsoliduan strukturat

organizative të njërive të reja të vetëqeverisjes vendore dhe në këtë mënyrë u vendos qëndrueshmëria e nevojshme në shpenzimet e kësaj natyre. Nga ana tjetër gjatë vitit 2019 nuk ka patur politikë të re në rritjen e pagave dhe si rrjedhim shpenzimet e personelit kanë pësuar rritje të lehta krahasuar me një vit më parë. Po ashtu shtimi i investimeve e për rrjedhojë shtimi i aseteve vendore kanë kërkuar në njësitë respektive edhe shtim të shpenzimeve të personelit me qëllim ofrimin e shërbimit sa më afër qytetarëve, detyra të cilat janë konsoliduar një vit më parë dhe këtë vit është ndjekur trendi i vitit 2018. Në këto kushte, themi me bindje që tashmë njësitë vendore kanë strukturuar plotësisht organizimin funksional sipas ndarjes administrativo-territoriale e si rrjedhim pesha e shpenzimeve të personelit për ofrimin cilësor të shërbimit ndaj qytetarëve vjen më rritje të lehtë në raport me një vit më parë.

Shpenzimet Operative, të cilat janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen dhe ushtrimin e funksioneve, rezultojnë me një rritje lehtësisht të ndjeshme në 9 mujorin e parë vitit 2019 në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shpenzimet operative përbëjnë rreth 26% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor për 9 mujorin e parë të vitit 2019 dhe 27% të këtyre shpenzimeve për vitin 2018. Në vlerë absolute në 9 mujorin e vitit 2019 janë shpenzuar rreth 11 miliard lekë ose e thënë ndryshe rreth 752 milion lekë më shumë se në të njëjtën periudhë të një vitit më parë. Faktorët që kanë ndikuar në rritjen e nivelit të shpenzimeve operative janë të lidhura me rritjen e nevojës për mirëmbajtje për funksionet e transferuara në vitin 2016, përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve publike vendore, si dhe shtimin e aseteve të ndryshme nga investimet që kërkojnë shpenzime për ruajtje dhe mirëmbajtje. Por nga ana tjetër vihet re tendenca e rritjes nga viti në vit i shpenzimeve operative, vjen si rrjedhojë se tashmë shpenzimet për investime të realizuara kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme.

Shpenzimet për subvencione dhe të tjera, janë shpenzimet që zhvillojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore për të paguar interesat, për të subvencionuar politikat e ndryshme vendore dhe mbuluar funksione të tjera administrative. Në këto kushte nga sa përcaktohet në tabelën mësipër në raport me 9 mujorin e vitit 2018, këto shpenzime në 9 mujorin e vitit 2019 kanë një rritje të lehtë me rreth 23%, nga 696 milion lekë në vitin 2018 në rreth 870 milion lekë. Këto ndryshime janë rezultat i procesit të riorganizimit dhe të shtrirjes së re që ka marrë njësitë e vetëqeverisjes vendore ku nën juridiksionin administrativ tashmë përmban më shumë përgjegjësi për të ushtruar. Në mbështetje të të dhënave konstatohet një rritje të shpenzimeve për interesa të shpenzimet për subvencione dhe të tjera. Njësitë e reja të vetëqeverisjes vendore duhet në të ardhmen të kenë strategji afatgjata në ofrimin e shërbimeve publike sa më afër qytetarëve, në mënyrë të tillë që efienca e ofrimit të shërbimit të rritet ndjeshëm.

Shpenzimet Kapitale, janë një zë mjaft i rëndësishëm jo vetëm për faktin që përbëjnë pjesën më të madhe të buxhetit vendor por edhe për shkak se këto shpenzime janë ato që ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen ekonomike dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve. Nga tabela e mësipërme vëmë re që në krahasim me 9 mujorin e vitit 2018, gjatë të njëjtës periudhë në vitin 2019 shpenzimet për investime kanë patur një rritje e cila reflektohet deri në vlerën rreth 2.4 miliard lekë. Në tërësi shpenzimet vendore pas reformës administrativo territoriale kanë ardhur gjithmonë e në rritje, tregues ky i një performancë më të mirë vendore dhe që ka ndikuar në rritjen e punëve publike që po aplikojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore.


Në periudhë afatgjatë vazhdimi i kësaj tendence rritëse të shpenzimeve për investime nga njësitë e vetëqeverisjes vendore do të sigurojë vepra infrastrukturore dhe punë publike në interes dhe favor të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Treguesit fiskal të qeverisjes vendore të 9-mujorit të vitit 2019, premtojnë një optimizëm për vazhdimësinë e tyre pozitive edhe për muajt e mbetur të vitit buxhetor 2019. Si rrjedhojë, parashikohet që edhe për vitin 2020 njësitë e vetëqeverisjes vendore të kenë një buxhet më të plotë financiarisht dhe më të konsoliduar në proceset e menaxhimit të financave të tyre.

9.4 ECURIA E BORXHIT PUBLIK PËR PERIUDHËN JANAR-SHTATOR 2019

Në fund të muajit shtator 2019, borxhi i qeverisjes qendrore u vlerësua në nivelin 1,109.9 miliard Lekë ose 63.3% e PBB. Në terma nominal stoku i borxhit të qeverisjes qendrore është rritur me rreth 3.3 miliard Lekë, nga të cilat 9.6 miliard Lekë i korrespondojnë rritjes së borxhit të brendshëm dhe -6.2 miliard Lekë borxhit të jashtëm. Pavarësisht sa më sipër, rritja e borxhit në terma nominal është brenda kufijve të parashikuara në ligjin vjetor të buxhetit dhe në përputhje me objektivat afatmesme makro-fiskale për uljen e nivelit të borxhit në raport me PBB.


Grafiku 28: Borxhi i Qeverisjes Qendrore në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB (2015–Shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Peshën më të madhe në stokun e borxhit të qeverisjes qendrore vazhdojnë ta mbajnë instrumentet e tregtueshme (*bono thesari, obligacione, eurobond*) dhe huatë e huaja me destinacion financimin e projekteve. Niveli i borxhit të brendshëm dhe atij të jashtëm në raport me totalin e borxhit të qeverisjes qendrore janë përkatësisht rreth 53.1% dhe 46.9%, duke ruajtur pothuajse të njëjtat raporte me fundin e vitit të kaluar, si edhe duke qenë në linjë me objektivat e vendosura në SAMB në kuadër të menaxhimit të riskut të kursit të këmbimit.

Grafiku 29: Përbërja e borxhit të Qeverisjes Qendrore në raport me totalin (2015–Shtator 2019)




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Përbërja e Borxhit Shtetëror

Gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2019, ashtu si edhe gjatë vitit paraardhës, në përputhje me politikat menaxhuese për uljen e ekspozimit ndaj risqeve, ka vazhduar tendenca e rritjes së peshës së titujve afatgjatë (*kryesisht të titujve me afat maturimi mbi 5 vite*) në portofolin e borxhit të brendshëm. Gjithashtu, pesha e titujve me norma interesi të ndryshueshme është reduktuar, pasi edhe gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë emetim të titujve me norma interesi të ndryshueshme.


Grafiku 30: Kompozimi i Borxhit të Brendshëm Shtetëror (2015-Shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Në portofolin e borxhit të jashtëm, mbi 50% të peshës e mban borxhi me normë interesi fikse. Ndërkohë, për sa i përket kompozimit sipas instrumenteve, pavarësisht diversifikimit të portofolit drejt instrumenteve të tregtueshme (*Eurobond-i*), peshën më të madhe vazhdojnë ta mbajnë kreditë me burim dypalësh dhe shumëpalësh me destinacion financimin e projekteve me natyrë zhvillimore.

Grafiku 31: Kompozimi i borxhit të jashtëm shtetëror sipas interesit dhe instrumenteve (2015–Shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Realizimi i Huamarrjes

Huamarrja gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2019 u realizua me sukses, duke mundur refinancimin e borxhit ekzistues dhe mbulimin e nevojave të qeverisë për likuiditet në përputhje me objektivat strategjike për ruajtjen e qëndrueshmërisë së raporteve ndërmjet kostos dhe risqeve.

Huamarrja e Brendshme

Gjatë periudhës janar-shtator 2019, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka emetuar në tregun e brendshëm tituj shtetërorë në vlerën 246.3 miliard Lekë, nga të cilat 235.9 miliard Lekë kanë shërbyer për rifinancimin e titujve ekzistues dhe pjesa tjetër (10.3 miliard Lekë) për financimin e deficitit buxhetor të planifikuar për vitin 2019. Në linjë me objektivin për reduktimin e ekspozimit ndaj risqeve, financimi neto (huamarrja e re) është siguruar në masën 89.4% nëpërmjet titujve afatgjatë.

Tabela 11: Huamarrja shtetërore nga burime të brendshme në terma bruto dhe neto

Huamarrja e Brendshme	Janar-Shtator 2019			
	Emetim (në mld Lekë)	Maturim (në mld Lekë)	Huamarrja Neto (në mld Lekë)	Huamarrja Neto (në %)
Tituj Afatshkurtër	164.3	163.2	1.1	10.6%
Bono Thesari në Lekë	164.3	163.2	1.1	10.6%
Bono Thesari në Euro	0.0	0.0	0.0	0.0%
Tituj Afatgjatë	82.0	72.8	9.2	89.4%
Obligacione 2 vjeçare	31.8	45.8	-14.0	-135.3%
Obligacione 3 vjeçare	14.1	10.7	3.4	32.6%
Obligacione 5 vjeçare	17.7	11.3	6.4	61.4%
Obligacione 7 vjeçare	8.9	5.0	3.9	38.0%
Obligacione 10 vjeçare	9.6	0.0	9.6	92.7%
Gjithsej Tituj Shtetërorë	246.3	235.9	10.3	100.0%

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Huamarrja e Huaj

Në periudhën janar-shtator 2019, huamarrja e huaj në terma bruto rezulton në vlerën 13.2 miliard Lekë dhe është realizuar kryesisht nëpërmjet huave që financojnë projektet ekzistuese. Pothuajse gjysma e huamarrjes së huaj bruto është realizuar në favor të sektorit të Transportit, Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës Urbane, duke qenë në përputhje me objektivat e qeverisë për të mbështetur këta sektorë me rëndësi jetike.

Tabela 12: Huamarrja e huaj në terma bruto

Disbursime të borxhit të jashtëm shtetëror	Janar-Shtator 2018		Janar-Shtator 2019	
	në mld Lekë	në %	në mld Lekë	në %
Hua për Financim Projektësh	13.3	99.8%	11.5	86.8%
Energjia	3.0	22.7%	0.9	6.7%
Transporti	3.3	24.4%	3.7	28.3%
Ujësjetës-Kanalizime	3.2	24.1%	3.3	24.9%
Infrastruktura Urbane	2.3	17.5%	2.5	19.0%
Të Tjera	1.5	11.1%	1.1	8.0%
Mbështetje Buxhetore	0.0	0.2%	1.7	13.2%
Total Huamarrja e Huaj	13.4	100.0%	13.2	100.0%


Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Kostot dhe Risqet

Kostot

Shpenzimet për interesa gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2019 janë vlerësuar në 25.4 miliard Lekë. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, në përputhje me parashikimet për buxhetin e vitit 2019, shpenzimet për interesa të borxhit shtetëror janë rritur me 2.1 miliard Lekë. Rritja e shpenzimeve për interesa i atribuohet kryesisht rritjes së stokut të borxhit në vlerë nominale.

Grafiku 32: Interesat e Borxhit Shtetëror në vlerë absolute dhe relative ndaj PBB




Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Nga ana tjetër, kostot për njësi të borxhit kanë pësuar rënie krahasuar me fundin e vitit 2018, kryesisht për shkak të nivelit ende të ulët të normave të interesit, të cilat kanë mundur mundësitë e refinancimit të titujve afatgjatë që maturohen me tituj me norma të interesit më të favorshme. Ulja e kostos për njësi të borxhit të brendshëm ndërkohë që maturiteti i borxhit vazhdon të rritet, reflekton një përmirësim në raportin ndërmjet kostos dhe riskut.

Grafiku 33: Kosto mesatare dhe jetëgjatësia mesatare e borxhit të brendshëm

Burimi:



Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Risqet

Gjatë nëntëmuajorit të vitit 2019 ekspozimi i portofolit të borxhit ndaj risqeve është menaxhuar me sukses, në linjë me objektivat strategjike afatmesëm. Ulja e peshës së titujve afatshkurtër dhe atyre me norma të interesit të ndryshueshme në portofolin e borxhit të brendshëm, kanë qenë faktorët mbizotërues në uljen e riskut të refinancimit dhe riskut të normave të interesit. Peshat e titujve afatshkurtër dhe atyre me norma të interesit të ndryshueshme janë ulur përkatësisht me 0.38 pp dhe 1.57 pp.

Risku i refinancimit është përmirësuar, pasi jetëgjatësia e borxhit të brendshëm është rritur me 36 ditë duke prekur nivelin e 819 ditëve në fund të muajit shtator 2019, krahasuar me 783 ditë në fund të vitit 2018.

Risku i normave të interesit gjithashtu është reduktuar, pasi peshat e instrumenteve që rivlerësojnë normën e interesit në harkun kohor të një viti është ulur nga 54.3% në dhjetor 2018 në 50.8% në shtator 2019.

Tabela 13: Treguesit e riskut të normave të interesit (2017–Shtator 2019)

Treguesi	2017	2018	Sht-2019
Borxhi me normë inyeresi fikse/Total	55.6%	59.1%	61.0%
Borxhi i rivlerësuar në një vit/Total	56.7%	54.3%	50.8%
Koha Mesatare në Rivlerësim (në vite)	1.97	2.06	2.19

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

Zhvillimet e Tregut Primar të Titujve Shtetërorë


Tregu primar i titujve shtetërorë gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2019 përgjithësisht është karakterizuar nga zhvillime pozitive, ndër të cilat mund të përmenden kërkesa e kënaqshme e tregut në raport me nevojat e qeverisë për huamarrje dhe rënia e normave të interesit në krahasim me ato të vitit 2018.

Gjithashtu, gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2019 ka vazhduar implementimi i projektit pilot për emetimin e obligacioneve 5 vjeçare referencë, pasi rezultatet paraprake të këtij projekti kanë qënë pozitive në kuadër të rritjes së aktivitetit të tregtimit të titujve në tregun sekondar. Nisur nga këto rezultate, gjatë vitit 2019 ky projekt është shtrirë edhe tek obligacionet 3 vjeçare.

Ecuria e ankandeve dhe kërkesa për titujt shtetërorë

Gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2019 kërkesa për tituj shtetërorë ka rezultuar në vlerën 318.7 miliard Lekë, nga të cilat 190.1 miliard Lekë për bono thesari dhe 128.7 miliard Lekë për obligacione. Kërkesa gjatë nëntëmuajorit të vitit 2019 ka qënë relativisht më e lartë se oferta e qeverisë për tituj shtetërorë, duke rezultuar në një raport të përgjithshëm mbulimi prej 1.26.


Grafiku 34: Raporti i mbulimit të ankandeve të titujve shtetërorë (Janar–Shtator 2019)



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)


Për sa i përket strukturës së mbajtësve të borxhit të brendshëm, ajo vazhdon të paraqesë pothuajse të njëjtat karakteristika me vitin e mëparshëm. Pavarësisht rritjes së moderuar në drejtim të institucioneve jo financiare, mbi 60% e borxhit të brendshëm vijon të mbahet nga sektori bankar.

Grafiku 35: Mbajtësit e borxhit të brendshëm shtetëror (2015-Shtator 2019)



Krahasuar me fundin e vitit 2018, normat e interesit gjatë vitit 2019 kanë shfaqur tendenca rënëse, duke reflektuar vazhdimin e politikave lehtësuese të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, si edhe reduktimin e nevojave për hua të qeverisë në gjysmën e parë të vitit, për shkak të likuiditetit të mjaftueshëm të siguruar nga emetimi i Eurobondit gjatë vitit 2018.

Grafiku 36: Kurba e yield-it mesatar të ponderuar të titujve shtetërorë



Pritshmëritë për Borxhin në vitin 2020

Referuar parashikimeve të rritjes ekonomike, si edhe deficitit buxhetor të planifikuar, niveli i borxhit publik në raport me PBB parashikohet të ulet me rreth 1.5 pp gjatë vitit 2020, duke qënë në përputhje me objektivat për konsolidimin e financave publike.

Nga pikëpamja e kompozimit të borxhit, pritet të ketë një rritje në favor të borxhit të denominuar në valutë të huaj dhe atij afatgjatë në portofolin e borxhit të brendshëm. Rrijta e borxhit në valutë parashikohet të jetë ndjeshëm nën kufijtë strategjikë të përcaktuar në Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit.

Huamarrja e brendshme pritet të realizohet nëpërmjet titujve shtetërorë në përputhje me kapacitetet e kërkesës në tregun e brendshëm.

Huamarrja e huaj do të realizohet nëpërmjet disbursimit të huave që financojnë ecurinë e zbatimit të projekteve prioritare të qeverisë. Gjithashtu, nisur nga kushtet ende të favorshme të tregjeve ndërkombëtare të kapitalit, si edhe nevojat për të shërbyer detyrimet e borxhit në valutë, gjatë vitit të ardhshëm do të synohet të shfrytëzohet instrumenti i Eurobond-it.

Duke marrë në konsideratë vijimin e politikave monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë, normat e interesit të titujve shtetërorë në tregun e brendshëm pritet të jenë të qëndrueshme dhe në nivele të krahasueshme me normat aktuale.

Për sa i përket tendencës së normave të interesit në tregjet e huaja, bazuar në deklaratat dhe vendimet e fundit të Rezervës Federale dhe BQE, këto institucione do të vijojnë ndjekjen e politikave monetare lehtësuese, duke bërë që edhe normat e interesit në këto tregje të qëndrojnë në nivele të ulta edhe përgjatë vitit 2020.

Në këto kushte, kostot për njësi të borxhit të brendshëm dhe atij të huaj pritjet të qëndrojnë pothuajse në nivele të krahasueshme me ato të vitit 2019.

Ndërkohë për sa i përket shpenzimeve për interesa të borxhit, gjatë vitit 2020 parashikohet një rritje e moderuar e tyre, kryesisht për shkak të rritjes së stokut të borxhit në vlerë nominale.

Tabela 13: Shërbimi i borxhit shtetëror 2019-2020

(në milion Lekë)

Shërbimi	Janar-Shtator 2019 (Fakt)	2019 (I pritshmi)	2020 (Parashikim)
Shërbimi i Borxhit Shtetëror	47,306.3	67,300.0	103,500.0
Interesat e Borxhit Shtetëror	25,394.2	35,800.0	36,950.0
-Interesat e Borxhit të Brendshëm Shtetëror	18,568.8	23,100.0	23,500.0
-Interesat e Borxhit të Jashtëm Shtetëror	6,825.4	12,700.0	13,450.0
Ripagesat e Borxhit të Jashtëm	21,912.1	31,500.0	*66,550.0

*Është përfshirë maturimi i Eurobond-it 2020 në vlerën 250 milion Euro

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2019)

9.5 LISTA E KONCENSIONEVE AKTIVE DHE TË PLANIFIKUARA

Kategoria	Lloji	Objekti i Kontratës	Vlera e investimit (në lekë) sipas Regjistrat te ATRAKO
Sektori i Mjedisit			1,903,372,646
	Ndërtim, Operim, Transferim		49,660,000
	Kontrate Sherbimesh		49,660,000
		Menaxhimi dhe zhvillimi teknologjik i prodhimit të fidanëve pyjor/arror në Fidanishten Shtetërore të Cërrikut, Elbasan	49,660,000
	Ndërtim, Operim, Transferim		1,350,000,000
		Për dhënie me koncesion të shërbimit të pastrimit, grumbullimit, transportimit dhe seleksionimit të mbetjeve urbane për Qytetin Kamëz.	1,350,000,000
	Shfrytëzim		503,712,646
		Shfrytëzimi i Burimit ujor "Sasaj, Bunec", Sarandë	503,712,646
Sektori i Transportit			30,327,033,677
	Kontrate Sherbimesh		1,380,764,190
		Menaxhimi, Operimi, Mirëmbajtja, Përmirësimi teknik dhe Adaptimi i terminalit të trageteve dhe krocerave Durrës.	581,387,190
		Projektim, financim, rehabilitim, testim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje të Qendrave të Kontrollit Teknik të mjeteve.	561,003,000
		Për dhënie me koncesion të disa shërbimeve detare	238,374,000
	Ndërtim, Operim, Transferim		28,946,269,487
		Menaxhimi, operimi, mirëmbajtja dhe përmirësimi teknik i terminalit të konteinerëve në portin e Durrësit	3,191,825,000
		Ndërtim, Shfrytëzim dhe Transferim në pronësi të shtetit, të Portit të Jahteve Shëngjin	730,338,000
		Ndërtimi i portit të jahteve në Kalanë e Turrës, Komuna Synej, Kavajë.	4,450,000,000
		Ndërtimi, Operimi dhe Transferimi i Aeroportit "Nënë Tereza"	9,310,000,000
		Ndërtimi, Operimi, Transferim i parkimit nëntokësor në parkun "Rinia", Tiranë	1,937,932,800
		Ndërtimi, shfrytëzimi i portit të jahteve në qytetin e Durrësit. (BOT)	1,356,144,750
		Ndërtim, Shfrytëzimi dhe Transferimi të portit të tipit MBM, Porto Romano, Durrës	1,280,814,000
		Operimi, Ndërtimi, Mirëmbajtja, Përmirësimi Teknik dhe Adaptimi i Terminalit Lindor Durrës.	2,069,371,737
		Infrastruktura Hekurudhore Fier-Ballsh, Fier-Vlorë	2,431,918,164
		Për rehabilitimin, operimin transferimin e Aeroportit të Kukësit	987,925,036
		Kryerja e shërbimit të rimorkimit të anijeve, Shërbimi i Transportit, Transportimi i Ekuipazheve të anijeve, Operacionet e ngarkim-shkarkimit.	1,200,000,000
Sektori i Bujqësisë			1,906,500,000
	Ndërtim, Operim, Transferim		1,906,500,000
		Kontratë Koncesioni për kultivimin e ullirit deri në 1000 ha, Kavajë	1,906,500,000

Kategoria	Lloji	Objekti i Kontratës	Vlera e investimit (në lekë) sipas Regjistrimit të ATRAKO
Sektori i Energjise			411,499,718,683
	Ndërtim, Operim, Transferim		411,499,718,683
		Financimi, Projektimi, Ndërtimi, Vënia në Punë, Administrimi, Mirëmbajtja dhe Transferimin e Hidrocentraleve "Shkallë", "Cerrujë", "Plesha", "Bejni1", "Bejni2", "Klos"	1,465,039,743
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve Gjuraç, Kashec, Ragam dhe Lepurushe	780,000,000
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve mbi Lumin Kardhiq	1,041,453,039
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve mbi Përroi Ujëmbledhës të Përroit të Zhejës	61,916,210
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës të Shmilit dhe Zallit të Gjuraçit, Rrethi Librazhd	1,165,964,018
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve RAPUN 3, RAPUN 3A dhe RAPUN 4	790,361,250
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve TREBINJA 1, TREBINJA 2, POTGOZHAN, KALIVAÇ dhe DUNICE	175,585,602
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve, Cemerica 1, Cemerica 2 dhe Cemerica 3	300,673,715
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit ARSTI	225,125,130
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Begaj	2,794,366,000
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Egnatia	321,956,600
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit KALIVAR	465,326,140
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Lingjaca	149,524,860
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit QYTEZË	27,700,000
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit VILIQ	199,260,305
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentralit LLËNGË	252,559,542
		Ndërtim, operim dhe transferim e hidrocentraleve SHEBA 1, SHEBA 2, SHEBA 3 dhe SHEBA 4	416,000,000
		Ndërtim, operim dhe transferim Hec Holta Kabash dhe Holta Porocan	500,000,000
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve GERMANI 1, 2, 3, 4 dhe 5	348,238,001
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve mbi Lumin SETA	1,400,805,550
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve PRELLE 1 dhe PRELLE 2	1,512,585,536
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentraleve të Lashkizës	322,691,040
		Ndërtim, operim dhe transferim hidrocentralit RUNJA	351,244,805
		Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve ARRËZ, SHËNDELLI, SOTIRE, PODE, MESARE, URA, RAJAN 2, RADON, DEDOVE, PESHTAN, OSNATI DHE GRADISHT	837,404,386
		Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve FLETI 1, FLETI 2, FLETI A dhe FLETI B	815,963,996
		Ndërtim, operim dhe transferim i hidrocentraleve KUKUR 1, 2, 3, 4 dhe 5	4,547,551,449
		Ndërtim, operim dhe transferim i Hidrocentralit Dragobia	2,404,858,492
		Ndërtim, operim dhe transferim të Hidrocentraleve në Kaskadën e Osumit	32,377,517,340
		Ndërtim, operim dhe transferim, i Hidrocentraleve, Prishtë1, Prishtë 2,	329,256,843
		Ndërtim, operim dhe transferimin e hidrocentraleve ZAJE, TUJAN, XHAFERAJ, KOLLOVOZ, NOVOSEJË, MËSHTEKËN	223,087,239
		Ndërtim, operim dhe transferimin e hidrocentralit ZEREC	120,311,959
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Arrez 1, Arrez 2, Arrez 3 dhe Arrez 4	295,860,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Backa 1, Backa 2, Backa A, Backa B, Backa C	1,156,808,769
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Ballenjë	138,314,960
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bershi-Klos	250,548,894
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bëngë dhe Tepelenë	675,221,200
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bigas dhe Veleshnje	42,420,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Bregu i Madh	128,136,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Cangonj	62,650,250
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Çaje, Reke, Livadhe, Shkinak, Lapaj 2, Bushtrica 1, Bushtrica 2 dhe Bushtrica 3	3,673,402,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gavran1 dhe Gavran	164,333,245
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Guri i Kuq 1/1 dhe Guri i Kuq 1/2	136,963,790
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Iballe 1, 2, Sapaç 1, 2, Berisha dhe Liqeni, Rrethi Pukë	1,572,169,360
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kaskada e Hec-eve të Hotolishtit	567,859,875
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kasollet e Selcës	526,318,254
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Kryezi 3, Kryezi 4 dhe Kryezi 5	131,064,360
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lajthia, Kolesjan, Domaj	123,761,020
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lefter 1, Lefter 2A, Lefter 2B, Lefter 3	208,659,212
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Lumzi	1,725,593,333
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi Lumin Gjader	1,592,690,975
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Meshanik dhe Guvë	216,152,500
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Myhejani 1, Myhejani 2, Myhejani 3	577,625,340
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve në Pellgun Ujëmbledhës të Zallit të Bulqizës/Vajkal- Rrethi Bulqize	587,563,575
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Potam	291,900,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Steblevë	159,680,320
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Suha 2	360,000,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shkopet 2 dhe Shkopet 3	2,273,383,994
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shpella Poshtë II dhe Shpella Poshtë III	144,560,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shutri	139,666,667
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vendresh, në Pellgun ujëmbledhës Përroi Vendreshes, Komuna Vendresh, Rrethi Skrapar	37,250,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vernik 1, Vernik 2, Vernik 3 dhe Vernik 4	971,365,040
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Vokopola 1, Vokopola 2 dhe Vokopola 3	497,257,690
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Denas	936,000,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Dobrenje-Tomorrice, në Përroi e Hijes, Skrapar	106,780,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Kaçinar	315,219,168

Kategoria	Lloji	Objekti i Kontratës	Vlera e investimit (në lekë) sipas Regjistrit të ATRAKO
Sektori i Energjise			411,499,718,683
	Ndërtim, Operim, Transferim		411,499,718,683
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Nishan	212,520,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Plepi, në Përroin e Plepit, Komuna Okshtun, Rrethi Diber	86,818,382
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Skatinë	129,541,704
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shengjon, Komuna Fan, Rrethi Mirditë	101,242,260
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Shengjun	349,864,502
		Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentraleve mbi Lumin Curraj, Rrethi Tropojë	13,728,387,330
		Ndërtim, Operim, Transferim i hidrocentralit Poçem	14,134,724,113
		Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Spathare	80,070,750
		Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Suha-1	3,181,563,000
		Ndërtim, operim, trenansferim i hidrocentralit Labinot Fushë	347,706,122
		Ndërtim, shfrytëzim dhe transferim të Hidrocentraleve Lura 1, 2 dhe 3	1,300,177,500
		Ndërtim, operim, transferim i Hidrocentralit Tucep 2	166,000,000
		Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentralit Lapaj	1,453,500,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Belesova 1 dhe 2	46,315,030
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bistrica 3 dhe 4	756,400,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Bishnica 1 dhe 2	250,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Borje, Oreshkë, Cernalevë, Cernalevë 1	830,097,322
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Çekrezë 1, 2	123,858,465
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Dobjot i Madh, Arrëz, Miras, Menkulas, Bracen, Kuç	124,254,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gomsiqe 1,2,3,4	2,149,411,466
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Gostivisht, Langarica3, Ura e Dashit	309,815,533
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Hurdhasi 1, 2, 3	200,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Kozel, Helmes 1 dhe Helmes 2	108,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Lengarica 1 dhe 2	1,980,904,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Nishova 1, 2	89,684,218
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Strelca 1, Strelca 2, Strelca 3	1,084,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shemri dhe Mguille	69,026,908
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Shtika 1,2,3,4	87,570,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Zerec 1 2	199,921,096
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Bisak	50,617,908
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Driza	151,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kabash 1 dhe 2	671,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kacni	133,121,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Klos	96,422,100
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit koka 1	392,862,289
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Koxheraj	102,963,375
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Kryezi dhe Kryezi i Epërm	50,419,481
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Treskës	656,545,309
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Lumi Zalli i Okshtunit	4,443,351,400
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Martanesh	857,861,985
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Nicë	49,800,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ostren i Vogël	46,870,792
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Peqin	521,573,382
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Perrollaj	51,434,808
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Përroi i Trebshit, Bulqizë	209,336,441
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Pobreg	995,034,550
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Qarr Kaltan	273,892,660
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Radovë	188,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Selishtë	120,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Sllabinjë	1,290,117,487
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Stravaj	503,529,364
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Shutinë	115,000,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Thanë, Mollas	1,042,888,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Ujanik 2	134,550,000
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vërtop	283,950,430
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Vlushë	1,718,835,000
		Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Gur Shpat1, Gur Shpat 2	176,738,773
		Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentraleve Sotirë, Sotirë 2	144,554,509
		Ndërtimi operimi dhe transferimi i hidrocentralit Mollaj	79,700,000
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve Lenie, Shalës, Strelcë	354,282,240
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentraleve të kaskadës së lumit Dardhë.	907,956,000
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Lena 1, Lena 2, Lena 2-A	311,332,059
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Picar 1	35,455,750
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Qafëzezë	51,955,070
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferimi i hidrocentralit Verbë - Selcë.	285,214,050
		Ndërtimi operimi mirëmbajtja dhe transferim të hidrocentraleve Murdhar 1 dhe Murdhar 2	501,411,750
		Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Çarshovë	83,500,000
		Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Dishnicë	15,300,000
		Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Faqekuq 1 dhe 2	587,975,273
		Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Lubonjë	39,000,000
		Ndërtimi, operimi dhe transferitmi i hidrocentralit Tervol	325,800,167
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentraleve Kaskada e Luses	743,776,400
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e hidrocentraleve VRANISHT, STROPAN, GRAPSH-ZICISHT dhe HOCISHT	92,548,781
		Ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Hidrocentralit të ri në Ashta	19,520,000,000
		Për ndërtimin, operim dhe transferim të Hidrocentraleve Veleshica 1, 2, 3, 4, 5, 6 Sillove dhe Bjeshke	3,254,323,134
		Për ndërtimin operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Peshku	188,055,946

Kategoria	Lloji	Objekti i Kontratës	Vlera e investimit (në lekë) sipas Regjistrimit të ATRAKO
Spektori i Energjise			411,499,718,683
		Rehabilitimi, Operimi dhe Transferimi i Hidrocentralit "Labinot-Mal"	12,500,000
		Rehabilitimin, operimin dhe transferimin e hidrocentralit DOMAJ, Has	12,369,610
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Quku 1 dhe Quku 2	150,894,676
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Progonat, Lekdush - Bëncë e Sipërme (Zgjidhur më 02.03.2018).	929,146,830
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentraleve Orgjosi i Ri: Bele 1, 2; Topojan 1,2	3,565,744,707
		Ndërtimi operimi dhe mirëmbajtja e hidrocentralit Liqenet, Maja e Madhe, Zanore, Dragostunjë, Frari, Hotolisht, Ura	424,080,723
		Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Fterre dhe Fterre 1.	650,565,750
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Stavec	870,315,194
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Rapun 1, Rapun 2	749,448,400
		Ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Stojan	124,333,623
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Darsi 1, Darsi 2, Darsi 3, Darsi 4	1,230,440,516
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Valbona	274,205,000
		Projektimi, financimi ndërtimin, operimi, mirëmbajtja dhe transferimi i Hidrocentralit ne Lumin Devoll	130,000,000,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Topcias	128,221,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve në Rrjedhën e lumit Shkumbin, Qukës	6,249,092,892
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gojan, Gjegjan, Peshqesh, Ura e Fanit, Fangu	16,322,955,740
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Përroin Sheja e Librazhdit	492,775,800
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Gjoni, Blishta, Klosi, Domi, Luçi, Shoshaj, Zenishti, Burreli	4,069,596,314
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Truen	192,560,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi përroin Zalli i Lunikut Librazhd	1,702,149,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Zall Xhuxhe 1, Zhall Xhuxhe 2	85,780,000
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Sekë	1,177,887,502
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Malla	176,321,017
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Zalli i Qarishtes	5,273,943,244
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi lumin Valbonë rrethi Tropojë.	7,327,423,467
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi lumin Gostimë, Egnatia Shushicë	7,806,058,026
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Blaç	44,000,032
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Malind	294,085,200
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Selca 2, Mesmal	269,981,177
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Batra 1, Batra 2, Batra 3	369,786,250
		Ndërtimin, operimin, transferimin e Hidrocentralit Guri i Bardhë	800,908,292
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve Shutri 1, Shutri 2	136,783,700
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Bushtrica 1	506,147,190
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Grabovë 2	1,486,571,351
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve mbi lumin Shushicë	2,433,789,054
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve të Lusës	621,368,362
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentralit Lunik	786,900,000
		Për ndërtimin e Hidrocentraleve mbi Lumin Shalë	11,239,204,263
		Për ndërtimin e Hidrocentralit Veleshicë	927,928,003
		Për ndërtimin e Hidrocentralit Kalivaç	16,913,853,000
		Për ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hec Kukur	304,603,895
		Për ndërtimin, operimin dhe transferimin e Hidrocentralit Bushtrica 3	559,309,182
		Ndërtim, operim, transferim e Hidrocentraleve ne Lumin e Shalës	18,915,950,757
		Ndërtim, operim, transferim e 5 Hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Shkumbin	847,000,000
Kontrata mbi Baze Tarifore			1,337,675,200
	Kontrate Sherbimesh		1,337,675,200
		"Dhënie me Koncesion/Partneritet Publik Privat të Shërbimit të Sistemit dhe Menaxhimit të Parkimit në Qytetin e Vlorës	-
		Krijimi dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të pullave fiskale.	1,267,675,200
		Prodhimi dhe shpërndarja e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike.	-
		Kolaudimi i pompave të karburanteve	70,000,000
Spektori Tatimor dhe Doganor			444,939,000
	Kontrate Sherbimesh		444,939,000
		Shërbimi i markimit dhe monitorimit të karburanteve	444,939,000
Zhvillim Ekonomik			1,435,691,880
	Kontrate Sherbimesh		1,435,691,880
		Për dhënie me koncesion të prodhimit të kripës Nartë, Vlorë	1,400,000,000
		Për Dhënie me Koncesion të Rregjistrimit të Barreve Siguruese	35,691,880
		Nëntotal 1	448,854,931,085

Kontratat Koncesione/PPP me mbështetje buxhetore

Kategoria	Lloji	Objekti i Kontratës	Vlera e plote e kontrates (në lekë)
Sektori i Mjedisit			43,243,962,440
Ndertim, Operim, Transferim			43,243,962,440
1		Për ndërtimin e administrimin e Impjantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjise	4,517,000,000
2		Ndërtimi dhe administrimi i impiantit të përpunimit të mbetjeve urbane të qarkut Elbasan	4,632,000,000
3		Per ndertim landfillit inceneratorit dhe rehabilitimin e venddepozimeve ekzistuese Tirane dhe prodhimin e energjise elektrike.	34,094,962,440
Sektori i Transportit			93,293,389,994
Ndertim, Operim, Transferim			93,293,389,994
4		Për përmirësimin, ndertimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Rrugës së Arbrit	40,320,000,000
5		Ndërtimi, përmirësimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e Autostradës Milot-Morinë	9,942,847,200
6		Ndertimi dhe Operimi i Rrugës Oriku - Himare	10,314,151,869
7		Ndertimi dhe Operimi i Rrugës Milot - Balldren	32,716,390,925
Sektori Tatimor dhe Doganor			27,663,364,824
Kontrate Sherbimesh			27,663,364,824
8		Financimi, ngritja dhe operimi i shërbimit të skanimit të konteinerve e automjeteve të tjera në Republikën e Shqipërisë.	27,663,364,824
Sektori i Shendetesise			45,488,156,224
Kontrate Sherbimesh			45,488,156,224
9		Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimesh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale.	16,500,000,000
10		Shërbimi i Hemodializës	7,221,364,000
11		Për paketën e shërbimeve të kontrollit mjekësor bazë për grupmoshat 40-65 vjeç	8,760,826,224
12		Për ofrimin e shërbimit laboratorik të spitaleve universitare, rajonale dhe atyre bashkiake të Sarandës dhe Lushnjës.	13,005,966,000
Sektori i Arsimit			9,597,021,552
Ndertim, Operim, Transferim			9,597,021,552
13		Për përmirësimin e infrastrukturës Arsimore në Bashkinë Tiranë	9,597,021,552
Nëntotal 2			219,285,895,034
Totali			668,140,826,119
<i>PBB Nominale (viti 2020)</i>			1,793,466,324,986
Vlera totale e Kontratave Koncesionare/PPP në përqindje ndaj PBB			37.3%

KËSHILLI I MINISTRAVE